



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr ____prot

Tiranë më _____.____.2024

VENDIM

Nr. 356 datë 11.07.2024

**PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...} PËR
PERIUdhËN 2020 - 2022**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Okti {...}, për periudhën 2020-2022”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit {...}, për periudhën 2020-2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, gjyqtari referuar objektit të mosmarrëveshjes apo natyrës së çështjes (civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale gjatë fazës së ekzekutimit) apo llojit të gjykimit të zhvilluar në çështjet penale (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analizës së fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsytimit të vendimit.

Në pjesën hyrëse të arsytimit të vendimit, në rastin e vendimeve penale themeli, në një nënndarje të titulluar “Procedura”, gjyqtari jep kronologjinë e veprimeve procedurale të bëra në seance paraprake si kërkesën e të pandehurit për procedim me gjykim të shkurtuar;¹ aspektet procedurale të seancës paraprake etj, më pas nënndarja. Ndërsa në vendime civile në pjesën hyrëse të vendimit përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore (nenet 41, 43, 54 dhe nenet 36/1 dhe 59 të K.Pr.C) përbërjen e trupit gjykues i përberë nga një gjyqtar apo tre (neni 35 i K.Pr.C), evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me pakësim apo shtim objekti.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve të themelit (penale, civile ose familjare) përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të

¹ Të gjitha vendimet burim vlerësimi të kategorisë çështje penale themeli

palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë, si: procedura e gjyqimit (*gjykim i shkurtuar apo i zakonshëm në çështjet penale*), zhvillimi i gjyqimit në prezencë ose mungesë të palëve, etj.

Menjëherë pas përshkrimit dhe analizës së rrethanave me karakter procedural, gjyqtari parashtron rrethanat e faktit objekt gjykimi, në një nënndarje përgjithësisht të titulluar “Rrethanat e çështjes”, duke i parashtruar ato në mënyrë të qartë, në një rend kronologjik dhe logjik dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuar në raport me njëra tjetrën, mbi të cilat gjyqtari ka konkluduar lidhur me provueshmërinë e fakteve konkrete. Në secilin vendim burim vlerësimi, faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë tepër të detajuar dhe të plotë, duke u shoqëruar në çdo rast me analizën e provave të administruara në gjykim, në mbështetje të konkluzioneve të gjyqtarit lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes. Ndërsa në vendimet me objekt (*dërgim çështje në gjyq*) rrethanat janë të parashtruara në nënndarjen e titulluar “Rezultatet e hetimit paraprak”.

- *Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes*

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtari krijon idenë e tij rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale (*gjykim themel, hetim paraprak apo seancë paraprake*). Gjyqtari, pas përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike, përcakton drejt edhe institutin juridik përkatës në çështjet civile (*nëse jemi para një mosmarrëveshje juridike civile detyrimi, njohje e vërtetësisë së dokumentit, kundërshtim veprimesh përmbare*), institutin përkatës në çështjet familjare (*instituti i martesës, zgjidhja dhe pasojat që rrjedhin prej saj*), llojin dhe figurën e veprës penale për të cilën procedohet në çështjet penale, apo seancën paraprake nëse jemi para një kërkesë dërgim në gjyq apo kërkesë për pushimin e procedimit penal.

Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, duke u bërë në mënyrë të shprehur, e në disa raste, si pasojë e një analize ligjore të shkakut dhe objektit të padisë, posaçërisht në çështjet civile, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale, në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Gjyqtari {...} identifikon natyrën civile-familjare të çështjes duke e cituar atë në pjesën hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit, si dhe duke analizuar natyrën e mosmarrëveshjes në kuadër të juridiksionit dhe kompetencës së gjykatës².

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përcaktuar ligjin e zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

² *Vendimet nr. 55-2022-1030/153, datë 15.12.2022, nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022, nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021.*

Sa i përket ligjit procedural:

Në çështjet familjare, gjyqtari identifikon dhe referon në pjesën arsyetuese të vendimit, dispozitat procedurale, si më poshtë

- Nenet 35/3, 36/1, 41, 51, 52, 71, 72 të K.Pr.Civile të K.Pr.Civile në lidhje me çështjen e juridiksionit gjyqësor dhe kompetencës lëndore e tokësore të Gjykatës,
- Identifikohen normat juridike procedurale: nenet 6 e 155 të K.Familjes dhe nenet 224/a - 230 të K.Pr.Civile për emërimin e ekspertit psikolog; nenet 35/3, 36/1, 41/1, 51, 52 të K.Pr.Civile lidhur me juridiksionin dhe kompetencën; nenet 71 dhe 72 të K.Pr.Civile lidhur me mungesën e shkaqeve të papajtueshmërisë apo përjashtimit;
- neni 310/III pika 1/1 i K.Pr.Civile lidhur me ekzekutueshmërinë e vendimit gjyqësor nga përmbaruesi gjyqësor.³

Në çështjet me objekt *lëshim urdhër ekzekutimi*, gjyqtari:

- Identifikon natyrën civile të çështjes, duke e cituar në pjesën hyrëse dhe përshkruese arsyetuese të vendimit, si dhe duke zhvilluar analizën e juridiksionit dhe kompetencës së gjykatës citon nenet 36/1, 41, 59/1 dhe 511 të K. Pr. Civile në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën, nenin 510 të K. Pr. Civile në lidhje me titujt ekzekutivë, nenin 511 të K. Pr. Civile në lidhje me urdhrin e ekzekutimit.⁴

Në vendimet civile burim vleresimi:

- nenin 179 të K.Pr.Civile dhe nenin 299 shkronja “ç” të K.Pr.Civile të aplikueshme në rrethanat procedurale të rastit konkret.⁵
- Identifikon normat procedurale të aplikueshme në rrethanat e faktit, konkretisht: nenet 32 të K.Pr.Civile dhe nenin 7 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” në lidhje me kompetencën tokësore të gjykatës; nenin 32, shkronjat “a”, “b”, “c” të K.Pr.Civile në lidhje me rastet kur mund të ngrihet një padi dhe llojet e padive detyrimi, deklarative; nenin 388 të K.Pr.Civile lidhur me institutin e vërtetimit të faktit juridik; nenin 390 të K.Pr.Civile në lidhje me thirrjen e personave të tretë ose prokurorit, në një gjykim pa palë kundërshtarë siç është gjykimi gracioz i vërtetimit të fakteve juridike; nenet 231, 232, 233 shkronja “a”, 235 të K.Pr.Civile në lidhje me provën me dëshmitarë.⁶
- Identifikon normat procedurale të aplikueshme në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën: nenin 32 të K.Pr.Civile, Ligjin nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, dhe nenet 7 dhe 17 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;⁷
- Citon nenin 451 shkronja “ç” të K.Pr.Civile lidhur me marrjen formë të prerë të vendimit të gjykatës; nenin 510 paragrafi i dytë, shkronja “a” të K.pr.Civile lidhur me vendimin gjyqësor të formës së prerë si titull ekzekutiv; nenin 517 të K.pr.Civile lidhur me lajmërimin për ekzekutim vullnetar; nenet 609- 610 të K.Pr.Civile lidhur me dy mjetet të ndryshme për mbrojtje në fazën e ekzekutimit të vendimeve; nenin 494 të K.Pr.Civile lidhur me kërkesën për rishikim; nenin 106 të K.Pr.Civile lidhur me shpenzimet gjyqësore; nenet 444 dhe 609 paragrafi i pestë të K.Pr.Civile, lidhur me të drejtën e ankimit brenda afatit 15 ditë. Identifikon natyrën e mosmarrëveshjes duke cituar nenet 609, 610 të K.Pr.Civile si mjetet e parashikuara për mbrojtjen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, dhe duke përmendur qëndrimin konstat të Gjykatës së

³ vendimet nr. 136-41, datë 01.02.2021, nr. 1436-357, datë 23.12.2020, vendimet nr. 1166-438, datë 31.10.2022, nr. 917-347, datë 19.09.2022, nr. 686-236, datë 21.05.2021, nr. 819-309 datë 13.07.2022, nr. 60-27 datë 18.01.2022

⁴ vendimet nr. 55-2020-1343, datë 18.12.2020 dhe nr. 55-2022-622, datë 30.06.2022

⁵ Vendimin nr.1169-284, datë 09.11.2020

⁶ vendimin nr. 922-205, datë 07.07.2021

⁷ vendimin nr. 193-57, datë 14.02.2020

Lartë, ka vlerësuar se pavlefshmëria e titullit ekzekutiv sjell pavlefshmëri edhe të veprimeve përmbartimore.⁸

- Citon normat procedurale civile, nenin 179 të K.Pr.Civile dhe nenin 299 shkronja “ç” të K.Pr.Civile të aplikueshme në rrethanat procedurale të rastit konkret; nenin 211 paragrafi i parë të K.Pr.Civile për heqjen e masës së sigurimit të padisë; nenin 106 e vijues të K.Pr.Civile, lidhur me shpenzimet gjyqësore.⁹

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtari identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Në vendimet gjyqësore objekt vlerësimi (*me objekt zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj , përmbushje detyrimi; njohje vjetërsie në punë dhe vërtetësisë së dokumentit; pavlefshmëri titulli ekzekutiv, etj.*) gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar dispozitave materiale të Kodit Civil, Kodit të Familjes, ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme apo akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës, kryesisht:

Në vendimet civile familjare gjyqtari citon:

- Identifikohen normat juridike materiale: nenet 74 dhe 77 të Kodit të Familjes për të përshkruar se bashkëshortët nuk kanë fituar pasuri gjatë martesës; nenin 132 të Kodit të Familjes lidhur me shkaqet e zgjidhjes së martesës; nenin 133 të Kodit të Familjes lidhur me fajësinë në zgjidhjen e martesës; nenin 1 të Kodit të Familjes ku përcaktohet martesë si bazë e unitetit të familjes; nenet 145-162 të Kodit të Familjes lidhur me pasojat e zgjidhjes së martesës; neni 143 i Kodit të Familjes lidhur me dërgimin për regjistrim të vendimit gjyqësor pas marrjes formë të prerë në zyrën e gjendjes civile përkatëse.

Në vendimet civile burim vlerësimi, gjyqtari identifikon:

- Identifikon normat materiale të aplikueshme në lidhje me rrethanat e faktit, konkretisht nenin 43 të Ligjit nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile” pikat 2 dhe 3.
- nenin 510 paragrafi i dytë, shkronja “a” të K.Pr.Civile lidhur me vendimin gjyqësor të formës së prerë si titull ekzekutiv; nenin 517 të K.pr.Civile lidhur me lajmërimin për ekzekutim vullnetar; nenet 609- 610 të K.Pr.Civile lidhur me dy mjetet të ndryshme për mbrojtje në fazën e ekzekutimit të vendimeve; nenin 494 të K.Pr.Civile lidhur me kërkesën për rishikim;
- Identifikon natyrën e mosmarrëveshjes duke cituar nenet 609, 610 të K.Pr.Civile si mjetet e parashikuara për mbrojtjen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm,

Në vendimet penale burim vlerësimi sa i përket ligjit procedural dhe material gjyqtari citon:

- Përshkruan ecurinë procedurale në seancë paraprake mbi caktimin e seancës dhe zhvillimin e seancës në përputhje jo vetëm me kërkesat e Kodit të Procedurës Penale, por edhe me ato të Kodit për Drejtësinë Penale për të Mitur, duke vënë theksin tek

⁸vendimin nr 147-42, datë 03.02.2021

⁹vendimin nr. 326-109, datë 11.03.2022

- neni 18 pika 1 e Kodit për Drejtësinë Penale për të Mitur ku përcaktohet se është e detyrueshme në çdo fazë apo veprim procedural që kryhet me të miturin në konflikt me ligjin që të jetë i pranishëm psikologu.
- nenet 332/c pika 3, 332/dh pika 1 shkronja “c”, dhe 332/ë pika 4 të Kodit të Procedurës Penale) lidhur me mungesën e kompetencës së gjyqtarit të seancës paraprake për t’u shprehur për kërkesën për gjykim të shkurtuar, por vetëm si detyrim për t’a përfshirë në fashikullin e gjykimit; nenin 331/4 të K.Pr.Penale lidhur me aktet që i janë bashkëlidhur kërkesë së prokurorit.¹⁰
 - nenit 329 pika 3 të K.Pr.Penale lidhur me shyrtimin e kërkesës në dhomë keshillimi nga gjyqtari i seancës paraprake në rastin e kërkesës penale si ankim ndaj vendimit të pushimit të kundravjatjes,¹¹
 - nenin 393 të K.Pr.Penale lidhur me ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore të pandehurit.
 - nenin 259 të K.Pr.Penale lidhur me seancën për vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit personal; nenin 402 pika 5 të K.Pr.Penale lidhur me pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar; nenin 190 të K.Pr.Penale mbi disponimin e provave materiale; si dhe nenin 393 të K.Pr.Penale lidhur me ngarkimin e shpenzimeve gjyqësore të pandehurit.¹²
 - Identifikon normat procedurale penale të aplikueshme, konkretisht: nenet 328, pika 1 shkronja “b” lidhur me rastin e pushimit të çështjes kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; nenin 190 pika 1 shkronja “b” të K.Pr.Penale lidhur me disponimin për provën materiale të sekuestruar; ndryshimet ligjore lidhur me të drejtën e ankimit; dhe nenet 329/a, 329/b dhe 329/ç, 332/dh të K.Pr.Penale lidhur me vendimarrjen përfundimtare).
 - nenet 406/d -406/f të K.Pr.Penale lidhur gjykimin e posaçëm, miratimin e marrëveshjes.¹³
 - nenin 291 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të konsumuar “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, në lidhje me pikën 1 të nenit 115 të Ligjit nr. 8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me ndalimin e drejtimit të automjeteve dhe motomjeteve pa leje drejtimi;¹⁴
 - nenet 53/a lidhur me nenin 291 paragrafi i dytë të K.Penal, lidhur me zëvendësimin e dënimit me burgim me detyrimin për pagimin e një shume monetare në favor të shtetit; si dhe normat procedurale penale të zbatueshme,¹⁵
 - nenin 137 paragrafi i parë të Kodit Penal lidhur me veprën penale të konsumuar “*Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike*”, nenin 32 paragrafi i parë i Kodit Penal lidhur me minimumin e dënimit me burgim; nenin 59 të K.Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë; nenin 60 pika 9 lidhur me detyrimin që i caktohet të pandehurit gjatë periudhës së provës;¹⁶
 - nenet 66 shkronja “d”, 126 të Kodit Penal dhe normat procedurale penale, nenin 328 pika 1 shkronja “d” të K.Pr.Penale, për t’i dhënë përgjigje ankesës së

¹⁰vendimin nr. nr. 65-16, datë 19.01.2021

¹¹vendimin nr. nr. 1415-491, datë 21.12.2020

¹²vendimin nr. nr. 14-202-16, datë 12.02.2021

¹³ Po aty

¹⁴vendimi 159-25, datë 09.02.2022; vendimi 14-202-16, datë 12.02.2021

¹⁵vendimin nr. nr. 14-202-16, datë 12.02.2021

¹⁶vendimin nr. nr. 1175-151, datë 10.11.2020

ankuesit mbi pabazueshmërinë e vendimit të pushimit të kundërvajtjes penale të Prokurorisë.¹⁷

- nenin 134 paragrafi i parë i Kodit Penal lidhur me vepren penal të “Vjedhjes”¹⁸
- Identifikon normën juridike materiale, nenin 283/1 të Kodit Penal për t’i dhënë përgjigje kërkesës së Prokurorit për pushimin e gjykimit¹⁹
- Identifikon normat materiale penale për t’a aplikuar në rrethanat e rastit konkret, nenet 66 dhe 134 të Kodit Penal²⁰
- Identifikon normën juridike materiale, nenin 151 të Kodit Penal për t’i dhënë përgjigje kërkesës së Prokurorit për pushimin e gjykimit²¹

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLuzioni

Në tërësi, gjyqtari {...} ka aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë”, pikëzohet me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen ose referohen, duke

¹⁷vendimin nr. nr. 1415-491, datë 21.12.2020

¹⁸vendimin nr. 65-16, datë 19.01.2021

¹⁹vendimin nr. nr. 676-202, datë 30.05.2022 vendimin nr. 859-215, datë 25.06.2021

²⁰vendimin nr. nr. 1221-449, datë 17.11.2020

²¹vendimi nr. 966-356, datë 02.10.2020)

u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Gjyqtari {...} i kushton vëmendje interpretimit të normave në mënyrë të abstrakte dhe individuale, para aplikimit mbi faktin konkret. Gjyqtari kryesisht përdor interpretimin duke i dhënë kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, në funksion të konkluzionit në lidhje me zgjidhjen e çështjes.

- *Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:*

Në vendimet civile dhe penale interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen që të gjejë zbatim norma konkrete, por edhe në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari:

Në vendimet me objekt zgjidhjen e martesës²² dhe rregullimin e pasojave të saj:

- Referohet përmbajtja e nenit 132 të Kodit të Familjes lidhur me shkaqet e zgjidhjes së martesës dhe interpretohet se zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort vendoset në rast se provohen dy elementë: 1) shkaku apo shkaqet e zgjidhjes së saj të parashikuara në nenin 132 të Kodit të Familjes dhe 2) pasoja e sjellë nga shkaku.
- Interpreton nenin 133 të Kodit të Familjes lidhur me fajësinë në zgjidhjen e martesës, për të cilën Gjykata shprehet vetëm nëse ka kërkim nga palët, duke treguar kështu se Gjykata nuk merr rol aktiv në këtë aspekt.
- Citon dhe interpreton nenin 146/1 të Kodit të Familjes lidhur me mbiemrin që do të mbajë bashkëshorti pas zgjidhjes së martesës, ku deduktohet se si rregull i përgjithshëm, me zgjidhjen e martesës nuk mund të mbahet mbiemri paramartesor nga bashkëshorti që e ka ndryshuar me anë të martesës.
- Interpreton nenin 133 të Kodit të Familjes lidhur me fajësinë në zgjidhjen e martesës, për të cilën gjykata shprehet vetëm nëse ka kërkim nga palët, duke treguar kështu se Gjykata nuk merr rol aktiv në këtë aspekt.
- Citon dhe analizon parimin e interesit më të lartë të fëmijës, duke mbajtur në konsideratë parashikimet e K. Familjes, si dhe të Konventës “Për të drejtat e fëmijëve”²³.

Në vendimet penale me objekt “*Deklarimi i shuarjes së veprës penale, i vendimit penal dhe i ekzekutimit të vendimit penal*”:

- Interpreton historikisht nenin 96 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “*Mjekimi i pakujdesshëm*”, duke cituar përmbajtjen e tij përpara ndryshimeve me Ligjin nr. 44/2019 me anë të të cilit ndryshimet prekën jo vetëm përmbajtjen, por edhe titullin e tashmë trajtohet si “*Neglizhenca në trajtimin mjekësor*”. Në këtë spektër, Gjyqtari analizon se sipas nenit 96 të Kodit Penal të ndryshuar, nuk ka veprë penale, kur mjekimi i pakujdesshëm, kryhet në

22 vendimet nr. 136-41, datë 01.02.2021; nr. 1436-357, datë 23.12.2020, Vendimet nr. 1166-438, datë 31.10.2022, nr. 917-347, datë 19.09.2022, nr. 686-236, datë 21.05.2021, nr. 819-309 datë 13.07.2022, nr. 60-27 datë 18.01.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

23 vendimi nr. 55-2022-660/88, datë 21.07.2022, nr. 55-2020-17/3, datë 09.01.2020 dhe nr. 55-2021-1354/207, datë 22.11.2021

formën e vetëbesimit të tepruar. Për kryerjen e kësaj analize, përdor metodat e interpretimit gramatikor, historik, qëllimor dhe origjinal, (duke iu referuar edhe relacionit shoqërues të projektligjit), Gjyqtari ka vlerësuar se neni 96 i Kodit Penal, i pandryshuar dënonte pakujdesinë në trajtimin mjekësor, të kryer në të dy format e pakujdesisë; neni 96 i Kodit Penal, i ndryshuar, dënon pakujdesinë në trajtimin mjekësor, të kryer vetëm në formën e neglizhencës, por është ulur masa e dënimit; pakujdesia në trajtimin mjekësor e kryer në formën e vetëbesimit të tepruar është shfuqizuar si veprë penale. Trajton veprimin e ligjit penal në kohë parashikuar nga neni 3 i Kodit Penal, duke interpretuar të tri paragrafët e këtij neni, përmes citimit të përmbajtjes, shoqëruar me terminologjinë përkatëse në latinisht, mbështetur nga praktika unifikuese dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese, sa lidhet me fuqinë prapavepruese të ligjit penal favorizuar në raport me momentin e zbatimit të tij, duke u kushtëzuar jo më tej momentit kur vendimi i dënimit penal ka marrë formë të prerë.²⁴

- Identifikon normën juridike materiale, nenin 248 të Kodit Penal për t'i dhënë përgjigje kërkesës së Prokurorit për pushimin e gjykimit, duke marrë në konsideratë rrethanat e faktit dhe përmes analizimit të provave të lejuara për shqyrtim dhe të administruara në fashikull. Në këtë spektër, interpreton nenin 248 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”²⁵.
- Trajton institutin e gjykimit të shkurtuar, duke interpretuar atë në favor të të pandehurit, ndonëse në kohën kur rigjykohet nuk lejohet aplikimi i këtij instituti, pasi sipas nenit 403/2 të K.Pr.Penale, ndryshuar me Ligjin nr. 35/2017, për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm nuk lejohet pranimi i kërkesës për gjykim të shkurtuar. Gjyqtari analizon se gjykimi i shkurtuar është institut proceduralo- penal, ulja e dënimit me një të tretën, duke qenë mënyrë e posaçme e caktimit të dënimit penal, duhet të vlerësohet si element i të drejtës penale materiale²⁶.
- Interpreton nenin 78 të Kodit Penal, lidhur me figurën e veprës penale “Vrasje me paramendim” duke e cituar përmbajtjen e kësaj dispozite si dhe duke e analizuar figurën e veprës penale në këto aspekte: objekti (mbrojtja e së drejtës së jetës); ana objektive (me veprime e mosveprime të rrezikshme, me mënyra e mjete të ndryshme, ardhja e pasojës –vdekja e viktimës, paramendimi (shkaku provokues, kalimi i një intervali kohe, gjakftohtësia e vendosmëria; subjekti (14 vjeç)dhe i përgjegjshëm; ana subjektive (dashje e drejtëpërdrejtë,e menduar më parë). Interpreton nenin 121/a të Kodit Penal, lidhur me figurën e veprës penale “Përndjekja” duke e cituar përmbajtjen e kësaj dispozite si dhe duke e analizuar figurën e veprës penale në këto aspekte: objekti (papakshmërinë e lirisë së personit); ana objektive (me veprime e mosveprime të përsëritura që shfaqen në kërcënimin ose ngacmimin e personit, të ketë ardhur pasoja kriminale – gjendje e vazhdueshme dhe e rëndë e ankthit ose e frikës për sigurinë e personit, ose detyrimi për të ndryshuar mënyrën e jetesës; subjekti i posaçëm lidhje gjinore ose sentimentale mes autorit dhe viktimës; ana subjektive (dashje direkte lidhru me veprimet dhe qëllimit (pasojes). Interpreton literalisht nenin

24 vendimin nr. 394-122, datë 18.05.2020

25 Në vendimin nr. 297-87, datë 02.03.2021

26 Në vendimin nr. 1618, datë 22.12.2021,

22 të Kodit Penal lidhur me tentativën duke sqaruar se vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse autori ndërmerr veprime të drejtëpërdrejta për t'a kryer atë, vepra ndërpritet dhe nuk përfundohet, për rrethana të pavarura nga vullneti i tij. Interpreton nenin 25 të Kodit Penal lidhur me institutin e bashkëpunimit, duke u mbështetur në Vendimin Unifikues Nr. 4 datë 15.04.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ku citohet se që një fakt penal të konsiderohet se është kryer duhet të bashkëekzistojnë si kushte: i) pluraliteti i personave; ii) realizimi i faktit penal në të gjitha elementet materiale të tij; iii) dhënia e një kontributi sado elementar në kryerjen e veprës penale, nga secili prej bashkëpunëtorëve; iv) dijenia e autorëve (si në rast kur nuk identifikohen edhe kur nuk mbajnë përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë mendore apo moshës).²⁷

- Interpreton nenin 278 të K.Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” kryer në formën e mbajtjes së një arme zjarri në mjedis të hapur për publikun, parashikuar nga neni 278, paragrafi i parë i Kodit Penal, pas ndryshimeve të sjella nga Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.02.2016. Interpreton sistematikisht nenin 278 të Kodit Penal, me nenet 56 pika 2 shkronja “a”, 6 pika 1 të Ligjit nr. 74/2014 “Për armët”, nenin 35 të Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë publike” për të konkluduar se përdorimi i armës së zjarrit nga personi që ka autorizimin për mbajtjen dhe prëdorimin e saj në kundërshtim me këtë autorizim, përbën shkelje ligjore, e cila është vepër penale nëse sjell pasoja penalisht të dënueshme si: vrasje, plagosje etj. Në të kundërt, mbajtja dhe/ose përdorimi i armës së zjarrit nga personi i autorizuar për mbajtjen dhe përdorimin e saj, siç janë edhe punonjësit e shërbimit të sigurisë fizike në shkelje të lejes ose të autorizimit përkatës, sjell përgjegjësi administrative. Interpreton nenin 274 të K.Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Prishja e qetësisë publike”. Në këtë spektër analizohet objekti (marrëdhëniet juridike që garantojnë rendin dhe sigurinë publike); ana objektive (kryhet në forma të ndryshme të cilat tregojnë hapur mospërfillje ndaj rregullave të vendosura nga shteti apo shoqëria. Lidhur me anën subjektive: kryhet me dashje direkte dhe nuk ka rëndësi motivi dhe qëllimi për kualifikimin. Subjekti mund të jetë mbi 16 vjeç dhe të jetë i përgjegjshëm mendërisht.²⁸

- Në interpretim të nenit 66 shkronja “d” të Kodit Penal, duke pasur në konsideratë rrethanat e rastit, interpretohet se duke qenë se i mituri ka mbushur moshën madhore në datën 13.08.2017, kjo është data nga e cila fillon afati i parashkrimit. Interpreton sistematikisht nenet 66 shkronja “d”, 126 të Kodit Penal dhe normat proceduriale penale, dhe nenin 328 pika 1 shkronja “d” të K.Pr.Penale, për të konkluduar se organi procedues (prokuroria dhe gjykata) ndodhen para një shkakut sipas të cilit ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë dhe vendimi i pushimit të çështjes nga Prokurori është i bazuar, ndërsa vendoset për rrëzimin e ankesës si të pabazuar në ligj.²⁹
- Interpreton sistematikisht nenin 32 paragrafi i parë dhe nenin 137 paragrafi i parë i Kodit Penal, për të përcaktuar minimumin e zbatueshëm të dënimit³⁰.
- Citon dhe interpreton nenin 134 të Kodit Penal mbi rrethanat e çështjes për të përcaktuar se vepra duhet të kualifikohet sipas paragrafit të parë ose të dytë, sa kohë nuk ka të dhëna nëse është kryer nga një person i vetëm apo nga disa. Referon shkronjën “ç” të nenit 66 të Kodit Penal, për të përcaktuar se ndjekja penale

27 Në vendimin nr. 777-100, datë 28.06.2022

28 Në vendimin nr. nr. 1339-119, datë 02.12.2022

29 Në vendimin nr. 1415-491, datë 21.12.2020

30 Në vendimin nr. nr. 1175-151, datë 10.11.2020

parashkruhet dhe çështja ose procedimi duhet të pushojë, nëse nga momenti që ka ndodhur një vepër penale, e cila dënohet me burgim gjer në pesë vjet, e deri në momentin që autori merret si i pandehur kanë kaluar pesë vjet. Duke interpretuar këtë parashikim ligjor, aplikohet në rrethanat e rastit konkret dhe konkludohet se plotësohen këto kritere, vepra penale konsiderohet e shuar dhe autori i saj nuk mund të merret si i pandehur³¹.

Interpreton nenin 291 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të konsumuar “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, dhe duke qenë dispozitë blankete, interpretohet sistematikisht me pikën 1 të nenit 115 të Ligjit nr. 8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet shprehimisht se ndalohet drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa leje drejtimi. Interpreton nenin 186 të Kodit Penal, duke zbërthyer përmbajtjen e tij. Konkretisht analizon objektin që mbron neni 186 i Kodit Penal, si mbrojtës të marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të personave juridikë publikë dhe privatë, si dhe të personave fizikë, të mbrojtura posaçërisht nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Në pikëpamje të anës objektive, analizohet se vepra mund të kryhet në dy forma: me falsifikim të dokumentit dhe me përdorim dokumenti të falsifikuar. Sa i takon konceptit të përdorimit, Gjyqtari jep kuptimin se nënkupton paraqitjen e dokumentit të falsifikuar në një procedurë administrative apo gjyqësore, si provë, dokument apo akt, përmes së cilit, autori synon të arrijë një qëllim të caktuar, të cilin mund t’u arrijë vetëm në rast se, dokumenti i falsifikuar trajtohej jo si i falsifikuar, pra si i rregullt. Po ashtu, gjyqtari analizon se falsifikimi mund të kryhet me tri mënyra: I. Duke ndryshuar një dokument origjinal (të rregullt) përmes pasqyrimin të rrethanave të pavërteta; II) Përmes prodhimit nga e para të një dokumenti tërësisht të falsifikuar; III. Përmes prodhimit të një dokumenti që megjithëse formalisht është i rregullt, në përmbajtje përmban të dhëna që dihet se janë të pavërteta. Dy rastet e para, Gjyqtari i kategorizon si falsifikim material, ndërsa të fundit si falsifikim intelektual.³²

- Interpreton nenin 291 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të konsumuar “*Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt*”, dhe duke qenë dispozitë blankete, interpretohet sistematikisht me pikën 1 të nenit 115 të Ligjit nr. 8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet shprehimisht se ndalohet drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa leje drejtimi. Kryen interpretim historik të gjykimit të posaçëm të miratimit të marrëveshjes për pranim fajësie dhe caktim dënimi duke cituar normimin e këtij gjykimi nga nenet 406/d-406/f të K.Pr.Penale, të përfshirë me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 35/2017 datë 30.03.2017 në Kodin e Procedurës Penale. Ndonëse nuk përmendet neni 59 i Kodit Penal në pjesën arsyetuese, në rastin konkret aplikohet instituti i pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë, sikurse është arritur në ujdin midis Prokurorit dhe të pandehurit në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit.³³

- Interpreton nenin 283 të K.Penal, se kur nuk do të zbatohet, pra kur personi nuk do të mbajë përgjegjësi penale për këtë vepër, duke përcaktuar përmbushjen e dy kritereve kumulative: mbajtja për përdorim vetjak dhe mbajtja e lëndës në doza të vogla; dhe e aplikon këtë interpretim në rrethanat e rastit konkret.³⁴

31 Në vendimin nr.1221-449, datë 17.11.2020

32 Në vendimin nr.859-215, datë 25.06.2021

33 Në vendimin nr. 159-25, datë 09.02.2022

34 Në vendimin nr. 676-202, datë 30.05.2022

Përpos interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, sic shihet me lart, evidentohet edhe interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47, 48, 49, 50 të K.Penal*) ose aplikimin apo jo të alternativave të dënimit (*neni 59 dhe 63 të K.Penal*). Në këto raste, gjyqtari ndalet në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri nga një masë dënimi më e ulët apo edhe të një dënimi alternativ të parashikuar në nenin 63 të K.Penal.

Në vendimet civile,

- Citon dhe interpreton nenin 32 të K.Pr.Civile, duke bërë dallimet midis padive të detyrimit të parashikuara nga shkronja “a” e dispozitës, dhe padive të njohjes të parashikuara nga shkronjat “b” dhe “c”, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë bazën për një padi detyrimi në të ardhmen. Në këtë ndarje, lidhur me paditë e detyrimit të parashikuara nga neni 32 shkronja “a” të K.Pr.Civile analizohet se ngrihen për të kërkuar rivendosjen e një të drejte apo interesi të ligjshëm të cenuar, që kanë për qëllim të provokojnë nxjerrjen e një vendimi gjyqësor detyrues në përfundim. Në këtë kuptim interpreton në mënyrë sistematike nenin 511 shkronja “a” të K.Pr.Civile. Interpreton shkronjën “c” të nenit 32 të K.Pr.Civile, duke e konsideruar si një instrument që kontrollon vërtetësinë e një dokumenti. Në këtë spektër analizohet se, një pretendim i tillë mund të realizohet nëpërmjet një gjykimi themeli, sipas kësaj dispozite, ose nëpërmjet gjykimit incidental, të nisur nga një padi detyrimi, sipas nenit 32 shkronja “a” të K.Pr.Civile, apo një padi njohjeje sipas nenit 32 shkronja “b” të K.Pr.Civile, ku çështja e origjinalitetit, falsitetit apo vërtetësisë së dokumentit shtrohet për zgjidhje, si mjet për të arritur zgjidhjen e çështjes kryesore. Interpreton sistematikisht nenin 32 të K.Pr.Civile me nenin 7 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, dhe në referencë të praktikës unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (Vendim nr. 2, datë 10.03.2014) përcakton natyrën e mosmarrëveshjes dhe përcakton kompetencën lëndore të gjykatës. Interpreton në mënyrë gramatike, teleologjike dhe sistematike nenet 32 dhe 388 të K.Pr.Civile, duke pasyruar dallimet midis padisë sipas nenit 32 të K.Pr.Civile dhe kërkesës sipas nenit 388 të këtij Kodi. Për të shpjeguar qartë ndryshimet midis tyre, fillimisht jepet qëllimi i nenit 388 të K.Pr.Civile (të garantojë ekzistencën e një fakti juridik, i cili nuk mund të provohet drejtëpërdrejtë nga përmbajtja e një akti); kushtet e domosdoshme që duhet të provojë kërkuesi (personi të ketë interes të ligjshëm, akti të jetë zhdukur, akti që ka humbur nuk mund të bëhet, akti nuk mund të merret me rrugë tjetër). Më tej jepet dallimi se neni 388 i K.Pr.Civile përbën një gjykim gracioz pa palë kundërshtare, ndërsa neni 32 i K.Pr.Civile paraqet natyrën e një gjykimi kontencioz, kontradiktor. Po ashtu, analizohet se vendimi gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik ka natyrë deklarative, pra prej personave të tretë nuk i kërkohet asgjë.³⁵
- Interpreton nenet 609, 610 të K.Pr.Civile si mjetet e parashikuara për mbrojtjen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, dhe analizon se pala mund t’i kërkojë të dyja në një padi (pavlefshmëri tituli dhe kundërshtim veprimesh përmbarrimore), por gjykata

35 Në vendimin nr. 922-205, datë 07.07.2021

merr në shqyrtim vetëm pretendimin për pavlefshmëri tituli ekzekutiv, sepse veprimet përmbartimore janë pasojë e titullit ekzekutiv. Në të kundërt, nëse pretendimet për kundërshtimin e veprimeve përmbartimore nuk lidhen dhe nuk burojnë nga pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, gjykata i merr në shqyrtim veçmas. Citon dhe interpreton paragrafin e dytë të nenit 609 të K.Pr.Civile në rrethanat e rastit konkret për të pohuar se megjithëse është respektuar afati 30 ditor për ngritjen e padisë, pavlefshmëria e titullit nuk i referohet rrethanave dhe fakteve që kanë ndodhur pas dhënies së vendimit, dhe në këtë rast, përmes interpretimit qëllimor të nenit 494 të K.Pr.Civile orienton palën që mjeti juridik që duhet të përdori është kërkesa për rishikim. Interpreton nenin 451/a paragrafi i parë i K.Pr.Civile, për të sqaruar se vendimi i kundërshtuar (tituli ekzekutiv) ka marrë formë të prerë, ka efekte konstituive (ka zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen mes palëve) si dhe efekte prekluzive (ndalon ndryshimin e zgjidhjes në fjalë), përbën gjë të gjykuar, nuk mund të vihet në diskutim.³⁶

Përsa i përket interpretimit të dispozitave *procedurale civile dhe penale*, gjyqtari përgjithësisht i jep rëndësi interpretimit të normës, si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtari:

Në vendimet civile me objekt *“1. Detyrimi i palës së paditur, të paguajë në favor të palës paditëse, shpërblimin e plotë të dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga aksidenti i ndodhur në datë 25.12.2017; Vërtetimin e faktit juridik se kërkuesi ka qenë në marrëdhënie pune; Kundërshtim i veprimeve përmbartimore; 2. Deklarim se titulli vendim gjyqësor është i pavlefshëm dhe se është shuar më pas, me deklaram të vetë kreditores para gjykatës; Konstatim i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes...Çregjistrim i pasurive të paluajtshme....Sigurim padie, Gjyqtari:*

- Interpreton sistematikisht nenin 299 shkronja “ç” të K.Pr.Civile, ku përcaktohet se pushimi i gjykimit vendoset dhe në situatën që parashikohet shprehimisht në ligj, duke marrë parasysh përcaktimin në nenin 179 pika 2 të K.Pr.Civile, konkludohet se është rasti kur pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj.³⁷
- Citon dhe interpreton nenin 32 të K.Pr.Civile, duke bërë dallimet midis padive të detyrimit të parashikuara nga shkronja “a” e dispozitës, dhe padive të njohjes të parashikuara nga shkronjat “b” dhe “c”, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë bazën për një padi detyrimi në të ardhmen. Në këtë ndarje, lidhur me paditë e detyrimit të parashikuara nga neni 32 shkronja “a” të K.Pr.Civile analizohet se ngrihen për të kërkuar rivendosjen e një të drejte apo interesi të ligjshëm të cenuar, që kanë për qëllim të provokojnë nxjerrjen e një vendimi gjyqësor detyruës në përfundim. Në këtë kuptim interpreton në mënyrë sistematike nenin 511 shkronja “a” të K.Pr.Civile³⁸.
- Interpreton shkronjën “c” të nenit 32 të K.Pr.Civile, duke e konsideruar si një instrument që kontrollon vërtetësinë e një dokumenti. Në këtë spektër analizohet

36 Në vendimin nr. 147-42, datë 03.02.2021

37 Vendimin nr.1169-284, datë 09.11.2020

38 Vendimin nr. 922-205, datë 07.07.2021

se, një pretendim i tillë mund të realizohet nëpërmjet një gjykimi themeli, sipas kësaj dispozite, ose nëpërmjet gjykimit incidental, të nisur nga një padi detyrimi, sipas nenit 32 shkronja “a” të K.Pr.Civile, apo një padi njohjeje sipas nenit 32 shkronja “b” të K.Pr.Civile, ku çështja e origjinalitetit, falsitetit apo vërtetësisë së dokumentit shtrohet për zgjidhje, si mjet për të arritur zgjidhjen e çështjes kryesore.³⁹

- Interpreton sistematikisht nenin 32 të K.Pr.Civile me nenin 7 të Ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, dhe në referencë të praktikës unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (Vendim nr. 2, datë 10.03.2014) përcakton natyrën e mosmarrëveshjes dhe përcakton kompetencën lëndore të gjykatës.⁴⁰
- Interpreton në mënyrë gramatike, teleologjike dhe sistematike nenet 32 dhe 388 të K.Pr.Civile, duke pasyruar dallimet midis padisë sipas nenit 32 të K.Pr.Civile dhe kërkesës sipas nenit 388 të këtij Kodi. Për të shpjeguar qartë ndryshimet midis tyre, fillimisht jepet qëllimi i nenit 388 të K.Pr.Civile (të garantojë ekzistencën e një fakti juridik, i cili nuk mund të provohet drejtëpërdrejtë nga përmbajtja e një akti); kushtet e domosdoshme që duhet të provojë kërkuesi (personi të ketë interes të ligjshëm, akti të jetë zhdukur, akti që ka humbur nuk mund të bëhet, akti nuk mund të merret me rrugë tjetër). Më tej jepet dallimi se neni 388 i K.Pr.Civile përbën një gjykim gracioz pa palë kundërshtare, ndërsa neni 32 i K.Pr.Civile paraqet natyrën e një gjykimi kontencioz, kontradiktor. Po ashtu, analizohet se vendimi gjyqësor për vërtetimin e faktit juridik ka natyrë deklarative, pra prej personave të tretë nuk i kërkohet asgjë.⁴¹
- Interpreton nenet 609, 610 të K.Pr.Civile si mjetet e parashikuara për mbrojtjen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, dhe analizon se pala mund t’i kërkojë të dyja në një padi (pavlefshmëri tituli dhe kundërshtim veprimesh përmbaremore), por gjykata merr në shqyrtim vetëm pretendimin për pavlefshmëri tituli ekzekutiv, sepse veprimet përmbaremore janë pasojë e titullit ekzekutiv. Në të kundërt, nëse pretendimet për kundërshtimin e veprimeve përmbaremore nuk lidhen dhe nuk burojnë nga pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, gjykata i merr në shqyrtim veçmas.⁴²
- Citon dhe interpreton paragrafin e dytë të nenit 609 të K.Pr.Civile në rrethanat e rastit konkret për të pohuar se megjithëse është respektuar afati 30 ditor për ngritjen e padisë, pavlefshmëria e titullit nuk i referohet rrethanave dhe fakteve që kanë ndodhur pas dhënies së vendimit, dhe në këtë rast, përmes interpretimit qëllimor të nenit 494 të K.Pr.Civile *orienton palën që mjeti juridik që duhet të përdori është kërkesa për rishikim.*⁴³
- Interpreton nenin 451/a paragrafi i parë i K.Pr.Civile, për të sqaruar se vendimi i kundërshtuar (tituli ekzekutiv) ka marrë formë të prerë, ka efekte konstituive (ka zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen mes palëve) si dhe efekte prekluzive (ndalon ndryshimin e zgjidhjes në fjalë), përbën gjë të gjykuar, nuk mund të vihet në diskutim.⁴⁴
- Interpreton sistematikisht nenin 299 shkronja “ç” të K.Pr.Civile, ku përcaktohet se pushimi i gjykimit vendoset dhe në situatën që parashikohet shprehimisht në ligj,

39 Vendimin nr. 922-205, datë 07.07.2021

40 Vendimin nr. 922-205, datë 07.07.2021

41 Vendimin nr. 922-205, datë 07.07.2021

42 Vendimin nr. 147-42, datë 03.02.2021

43 Vendimin nr. 147-42, datë 03.02.2021

44 Vendimin nr. 147-42, datë 03.02.2021

duke marrë parasysh përcaktimin në nenin 179 pika 2 të K.Pr.Civile, konkludohet se është rasti kur pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj.⁴⁵

Në vendimet penale interpretohen dispozitat procedurale si mëposhtë :

- Interpreton sistematikisht nenet 212 dhe 415 pika 1 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me afatin e ankimit ndaj vendimit të sekuestrimit të sendeve në hetime paraprake, duke qenë se neni 212 i Kodit nuk parashikon afat ankimi, atëherë Gjyqtari konkludon se duhet të respektohet afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditor i përgjithshëm.
- Interpreton nenin 208/a të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me Konventën “Për krimin në fushën e kibernetikës”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 8888, datë 25.04.2002, nga ku Gjyqtari arsyeton se sekuestrimi i të dhënave dhe/ose sistemeve ku përfshihen kompjuterat, printerat, sidomos serverat mund të sekuestrohen vetëm me vendim të gjykatës, jo me vendim të prokurorit. Në këtë kuadër, duke referuar në kuptimin që jep konventa për “sistem kompjuterik” dhe “të dhëna kompjuterike” konkludon se printerat dhe njësitë qendrore të kompjuterave të Gjykatës së Rrrethit Gjyqësor Lezhë janë sistem kompjuterik dhe të dhënat që përmbajnë kompjuterat janë “të dhëna kompjuterike”. Gjyqtari arsyeton se vendimi është i paligjshëm dhe duhet të shfuqizohet, duke qenë se është marrë nga prokurori, në një kohë që duhet të ishte marrë nga gjykata, nuk është i arsyetuar, nuk është proporcional, cenon të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshme të subjekteve të tjera, si dhe mund të cenojë të drejta konfidencialiteti ose të dhëna sekrete.⁴⁶
- Interpreton nenin 228 pika 1 të K.Pr.Penale ku analizon se tregon dallimin e natyrës së veçantë të gjykimit dhe mënyrën e kriteret mbi të cilat krijohet bindja e gjykatës, për caktimin ose jo të masës së sigurimit, krahasuar me atë të dhënies ose jo të vendimit të dënimit. Po ashtu, në interpretim të kësaj dispozite analizohen kuptimi i termit “*rrezik*”, “*ikja ose largimi*”. Interpreton nenin 229 të K.Pr.Penale në lidhje me nenet 48-50 të K.Penal, sipas të cilit gjykata duhet të hetojë në gjendjen që është procedimi në drejtim të personalitetit të të pandehurit, nëse ka precedentë penale, mënyrën e jetesës së tij, vendin dhe rrethanat të cilat e kanë sjellje në kryerjen e veprës, rrethanat lidhur me natyrën, llojin, mjetet, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së veprës penale, llojin dhe shkallën e pasojave të ardhura nga kryerja e veprës, llojin e shkallën e fajësisë dhe motivet për kryerjen e veprës, sjelljen e autorit si para ashtu edhe pas kryerjes së veprës, si dhe rrethanat e tjera të jetës individuale, familjare, sociale të tij. Në rastin e procedimeve penale për kryerjen e krimeve të rënda apo që kanë sjellë pasojë të rënda, për vetë natyrën e këtyre veprave penale, të mënyrës së kryerjes së pasojës së ardhur, është i pranishëm elementi i shkallës së lartë apo të rëndësishme, të rrezikshmërisë së autorit të tyre, sipas nenit 228 të K.Pr.Penale. masa e sigurimit “Arresti në burg” e kërkuar nga prokurori ndaj të gjykuarit, mund të çmohet nga gjykata si e papërshtatshme, vetëm nëse ai ose mbrojtësi i tij i paraqesin gjykatës, prova pozitive që tregojnë se, kjo gjendje rreziku nuk është e pranishme apo që nuk është e pranishme në atë shkallë e

45 Vendimin nr.326-109, datë 11.03.2022

46 Vendimin nr. 967-355, datë 02.10.2020

rëndësi që të bëjë të zbatueshme masën e sigurimit “Arresti në burg”. Interpreton nenin 251 të K.Pr.Penale lidhur me arrestimin në flagrancë, duke cituar përmbajtjen e dispozitës; duke bërë dallimin midis pikës 1, pikës 2 dhe pikës 3 të saj, ku sipas rastit përcaktohet edhe kontrolli i gjykatës. Në pikën 1, gjykata nuk vlerëson dot diskrecionin e policisë gjyqësore, por kontrollojnë përmbushjen e detyrimeve formale. Interpreton pikën 3 të nenit 251 të K.Pr.Penale sa i përket aktit të veçantë që duhet hartuar dhe nënshkruar rregullisht nga agjenti/oficeri i policisë gjyqësore. Diskrecioni që parashikohet në pikat 2 dhe 3 nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive apo të tejkalohet. Ai mund dhe duhet të kryhet vetëm nëse argumentohet qartësisht me shkrim, por jo domosdoshmërisht me akt të veçantë.⁴⁷

- Interpreton sistematikisht nenet 332/c pika 3, 332/dh pika 1 shkronja “c”, dhe 332/ë pika 4 të Kodit të Procedurës Penale) lidhur me mungesën e kompetencës së gjyqtarit të seancës paraprake për t’u shprehur për kërkesën për gjykim të shkurtuar, por vetëm si detyrim për t’a përfshirë këtë kërkesë në fashikullin e gjykimit.⁴⁸
- Në interpretim të nenit 66 shkronja “d” të Kodit Penal, duke pasur në konsideratë rrethanat . Interpreton sistematikisht normat procedurale penale, dhe nenin 328 pika 1 shkronja “d” të K.Pr.Penale, për të konkluduar se organi procedues (prokuroria dhe gjykata) ndodhen para një shkakui sipas të cilit ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë dhe vendimi i pushimit të çështjes nga Prokurori është i bazuar, ndërsa vendoset për rrëzimin e ankesës si të pabazuar në ligj.⁴⁹

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet Unifikues të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e Kolegjit Civil, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Konkretisht, identifikohet:

- Vendimin unifikues nr. 1 datë 27.03.2008 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku është mbajtur qëndrimi se mbajtja e narkotikëve për përdorim vetjak është rrethanë fakti, si rezultat i procesit të të provuarit. Po në zbatim të këtij vendimi, unifikues, trajton konceptin e dozës së vogël, e cila nuk nënkupton ndarjen fizike në disa doza, por sasia e lëndës që ajo përmban si e tërë dhe që sipas ekspertëve, vlerësohet si e vogël.
- Referon jurisprudencë të Gjykatës Kushtetuese lidhur me efektet prapavepruese të ligjit penal favorizues (Vendimet nr. 27, datë 27.06.1996, nr. 35 datë 20.12.2005, nr. 41 datë 29.12.2005; nr. 1, datë 20.01.2014) si dhe praktikën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë Vendim nr. 4 datë 27.03.2003 lidhur me ligjin penal favorizues, lidhur me efektet e gjësë së gjykuar (Vendim unifikues nr. 2 datë 03.11.2014).

47 *Vendimin nr. 1339-119*, datë 02.12.2022

48 *Vendimin nr. 65-16*, datë 19.01.2021

49 *Vendimin nr. 1415-491*, datë 21.12.2020

- Referon jurisprudencë të GJEDNJ lidhur me statusin e gjësë së gjykuar, konkretisht Nikitin kundër Ruisë, datë 20.07.2004; Lucky Dev kundër Suedisë datë 27.11.2004, Xheraj kundër Shqipërisë datë 29.07.2008; Sergey Zolotukhin kundër Ruisë datë 10.02.2009.
- Citon parimin kushtetues të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre, si pjesë e procesit të rregullt ligjor.
- Vendimet nr. 206, datë 11.07.2012; nr. 194 datë 04.07.2012; Nr. 883 datë 20.10.2020 të Gjykatës së Lartë
- Referon Vendimin Unifikues nr. 3 datë 02.11.2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me subjektin e posaçëm, duke sqaruar dhe plotësuar Vendimin unifikues nr. 1 datë 12.03.2002 (26.03.2002), si dhe Vendimin Unifikues nr. 2 datë 30.06.2004 lidhur me përcaktimin e përgjegjësisë penale kurdoherë të shprehur në dispozita të veçanta, dhe nuk mund të nxirret kurrë me analogji apo e nënkuptuar.
- Analizon nenet 263, 264, 265 të K.Pr.Penale referuar vendimit unifikues nr. 6, datë 11.11.2003 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me afatet e paraburgimit.
- Trajton kuptimin e gjykatës së caktuar me ligj sipas neneve 6 të KEDNJ dhe 42 të Kushtetutës, ku argumenton se në këtë koncept përfshihen disa aspekte: i) gjykata duhet të jetë e krijuar nga ligji; ii) ky i fundit duhet të ketë caktuar mënyrën dhe momentin se si gjykata fiton juridiksion dhe kompetencë; iii) të ketë përcaktuar mënyrën sesi kryhet caktimi dhe përbërja e trupit gjykues konkret. Po ashtu, Gjyqtari thekson se këto koncepte nuk i referohen vetëm organit gjyqësor kompetent në lëndë dhe territor, por edhe gjyqtarit ose trupës gjykues (gjyqtarit natyral të çështjes). *Vendimin Njehsues të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë Nr. 13 datë 04.04.2018.*
- *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 8, datë 21.05.1993; nr. 10 datë 10.08.1993; nr. 4 datë 07.02.2001; nr. 18, datë 14.05.2003; nr. 4 datë 27.02.2004; nr. 26 datë 04.12.2006; nr. 21 datë 01.10.2008; nr. 15 datë 08.06.2009; nr. 9, datë 23.03.2010; nr. 32, datë 10.07.2013; nr. 20 datë 16.05.2014; nr. 57, datë 23.07.2015; nr. 20 datë 04.04.2016.* i referon kur trajton parimin e prezumimit të pafajësisë, sipas të cilit gjykatat nuk duhet të fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet (si parim përbërës i rregullsisë së procesit gjyqësor).
- Lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë referohet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar datë 08.02.1996; Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar datë 17.12.1996; Telfner kundër Austrisë datë 20.06.2001; Gafgen kundër Gjermanisë datë 01.06.2010; Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar datë 12.07.2013; Karaman kundër Gjermanisë datë 27.02.2014; Jannatov kundër Azerbajxhanit datë 31.10.2014.*) Po ashtu lidhur me parimin e prezumimit të pafajësisë citon *Vendimet Unifikuese nr. 2 datë 06.02.2009, nr. 1 datë 08.01.2009, nr. 7 datë 14.10.2011 dhe nr. 1 datë 10.03.2014 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*
- *Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 29.01.2003; Vendimet nr. 4 datë 10.02.2012, nr. 23 datë 23.04.2012, nr. 24, datë 30.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese; Vendimet e Kolegjit Penal të*

Gjykatës së Lartë Trajton institutin e gjykimit të shkurtuar duke iu referuar praktikës gjyqësore, unifikuese dhe jurisprudencës kushtetuese *vendimi Nr. 514 (12) datë 12.07.2021, nr. 739 datë 04.11.2021*

- *Vendimit Unifikues nr. 1 datë 08.01.2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë*, ku përcaktohet se gjykata ka detyrimin të sigurojë zbatimin efektiv të garancive kushtetuese, të lidhura me respektimin e të drejtës themelore të lirisë së personit, që të mos tejkalojë kohën e arsyeshme;
- *Vendimit Unifikues nr. 3 datë 27.09.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ne lidhje me kuptimin e dyshimit të arsyeshëm* ku përcaktohet se nënkupton bindjen që krijohet nga provat e marra e të shqyrtuara në përputhje me kërkesat e ligjit, se vepra penale ka ndodhur dhe është kryer nga ai që akuzohet; *Vendimit Unifikues nr. 7 datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me dyshimin e arsyeshëm në rastin e caktimit të masës së sigurimit*, ku mbahet qëndrimi se është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e të hetuarit/gjykuarit, në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij.
- *Vendimet e GJEDNJ, të tillë si: Belchev kundër Bullgarisë, 2004* ku përcaktohet se për çdo periudhë paraburgimi, pavarësisht sa e shkurtër, autoritetet duhet të parashtrajnë përpara gjykatës, motive të besueshme që t'a justifikojnë atë periudhë; *Sarban kundër Moldavisë 2005*, ku përcaktohet se gjykata duhet të referohet mbi dispozita të K.Pr.Penale që parashikojnë kushtet e kriteret për caktimin e masave të sigurimit, sesi e përse gjejnë zbatim në çështjen konkrete; *Mansur kundër Turqisë, 1995 dhe Smirnova kundër Rusisë 2003*, ku përcaktohet se në arsyetimin e vendimit të gjykatës duhet të analizohen në mënyrë ezauruese e reale, motivet konkrete të pranimit ose jo të kërkesës për caktimin e masës së sigurimit, dhe jo të bëhet një përshkrim ritual e formal i shkaqeve e kriterëve të parashikuara nga ligji; *Garcia Alva kundër Gjermanisë 2001*, ku citohet se gjykata duhet të mbajë parasysh rrethanat e çështjes konkrete.
- *Vendimin nr. 155 datë 28.03.2019 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë lidhur me pamundësinë për të shpallur moskompetencën tokësore kryesisht nëse ajo nuk është ekskluzive. (Vendim nr. 1436-357 datë 23.12.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor).*
- *Vendimit nr. 556 datë 07.05.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në lidhje me rastet: i) kur kundërshtohet akti administrativ i organit publik, me padi për njohjen e pensionit; ii) kur kundërshtohen përmes padisë veprimet ose mosveprimet e organit publik që kanë ndikuar në njohjen e së drejtës së pensionit; iii) kur kërkohet njohja e vjetërsisë në punë, e vërtetësisë ose pavërtetësisë së një dokumenti, ose saktësia apo pasaktësia e tij; dhe iv) kur kërkohet gjyqësisht vërtetimi i faktit juridik që ndikon në lindjen e të drejtës për pension, për shkak se, dokumentacioni që provon faktet e pretenduara nga kërkuesi ka humbur është zhdukur dhe nuk mund të bëhet përsëri në rrugë tjetër, përveç rrugës gjyqësore.*
- *Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 464 datë 22.07.1998 “Për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të sigurimit të punonjësve të ish kooperative bujqësore, ndërmarrjeve dhe institucioneve që kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre ose janë në procesin e mbylljes”*

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarit që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit të vendimit. Gjyqtari njuh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- *Parimin e mos apliimit me analogji te ligjit penale (vendimi nr.297-87 dt 02.03.2021*
- *Parimin e barazize se armeve dhe formimit t eproves ne kontraktiktoritet*
- *Parimin e ekonomise gjyqesore*
- *Parimin e ligjshmërisë në kuadër të rëndësisë që kanë konstatimi i elementeve të figurës së veprës penale ;*
- *Parimet e ligjshmërisë dhe disponibilitetit si dhe parimin e ndalimit të gjykimit më shumë se një herë të së njëjtës çështje*
- *Parimin e interesit më të lartë të të miturit në kuadër të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore pas zgjidhjes së martesës;*
- *Parimin e procesit të rregullt ligjor nëpërmjet zhvillimit të një hetimi gjyqësor të plotë dhe të gjithanshëm në çështjet civile (nenet 14 dhe 16 të K.Pr.Civile)*
- *Parimin procedural të barrës së provës, në funksion të vlerësimit të fakteve që shërbejnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.*
- *Parimin e disponibilitetit maksimal të padisë dhe të drejtave subjektive për të pohuar të drejtën që ka pala e interesuar për të ngritur padinë sipas nenit 32 të K.Pr.Civile.*
- *Parimin e prezumimit të pafajësië*

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo kur ato shërbejnë për zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Ndërkohë dispozitat e ligjit material rezultojnë të jenë referuar dhe interpretuar plotësisht dhe duke zbërthyer në elementët përbërës të tyre, duke identifikuar qëllimin dhe funksionin e dispozitës, para aplikimit të tyre mbi faktet e çështjes konkrete. Po ashtu gjyqtari, tregon një kujdes të veçantë për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore Unifikues, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parime vetë përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine,⁵⁰ përgjithësisht të etiketuar (në kllapa), duke u shoqëruar gjithnjë me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe. Po ashtu, në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit, përdorimi i termave teknike është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose rezulton i qartë nga konteksti i arsyetimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore për çështjet familjare me objekt zgjidhje martesë, evidentohet që gjyqtari pasqyron në mënyrë të përmbledhur duke treguar kujdes për zgjedhjen e gjuhës së përdorur, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët në lidhje me shkaqe që çojnë drejt zgjidhjes së martesës, kjo pasi i jep rendësi respektimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe respektimit të drejtës për jetë private dhe familjare të subjekteve të procedimit⁵¹.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezulton në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*ë dhe ç*). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, gjithsesi kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të

⁵⁰ Për shembull: Përdor terminologji latinisht, konkretisht parimet “*nullum crimen sine lege, nulla poena sine crimen, nulla poena sine lege*” (Askush nuk mund të dënohet për një veprë që sipas ligjit të kohës kur është kryer nuk përbënte veprë penale); “*Nullum crimen sine lege praevia, nulla poena sine lege praevia, lex retro agit in mitius (lex mitior retro agit)*”; “*res iudicata*” (gjë e gjykuar) “*intraneus*” që do të thotë “i posaçëm”, “*perpetuatio jurisdictionis*” “*perpetuatio competentia*”; *ubi semel acceptum iudicium, ibi finem accipere debet*”, “*apriori*”, “*inter alia*”, “*sine qua non*”, “*in dubio pro reo*”, “*actore non probante reus absolvitur*”, “*fumus commissi delicti*”, “*id quod plerumque accidit*”, “*post delictum*”; etj

⁵¹ vendimet nr. 136-41, datë 01.02.2021; nr. 1436-357, datë 23.12.2020, Vendimet nr. 1166-438, datë 31.10.2022, nr. 917-347, datë 19.09.2022, nr. 686-236, datë 21.05.2021, nr. 819-309 datë 13.07.2022, nr. 60-27 datë 18.01.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin

kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsytimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimet në përgjithësi janë të organizuar në nënndarje, të identifikuara me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimit.

Në vendimet përfundimtare të vëzhguara, evidentohet se gjyqtari pasqyron dhe merr në analizë elementët proceduralë, si: kompetenca, juridiksioni, të drejtat e palëve, njoftimi i tyre, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet respektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit. Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtari. Pothuajse në të vendimet e analizuara evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, por duke vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës, me analizën dhe zbërthimin e dispozitave të cituara (*Vlerësimi i gjykatës*). Kjo e bën vendimin me te qartë, të plotë dhe gjithëpërfshirës.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i kushtuar rëndësi dhe peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit “është “Shumë e lartë”, pikëzohet me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar të cilës i përmbahet, në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale dhe fakteve thelbësore të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, por edhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura, të cilat vijnë gjithnjë në përmblyllje procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtari ndjek metodologji përgjithësisht të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuara me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse të dhënat e regjistrimit dhe gjykata që ka gjykuar çështjen; trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore; data e shqyrtimit; palët dhe përfaqësuesit e tyre;

objekti i shqyrtimit dhe baza ligjore; kërkimet përfundimtare të palëve të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkuese-arsyetuese gjejnë pasqyrim në mënyrë të strukturuar dhe të emërtuar: “*Procedura*” në të cilën pasqyrohet ecuria procedurale e çështjes penale; “*Rrethanat e faktit*”, ku fillimisht pasqyrohen rrethanat e faktit që kanë rezultuar nga veprimet hetimore të kryera; e më pas, “*Vlerësimi i gjykatës*” në të cilën merret në analizë ligji zbatueshëm i cili aplikohet mbi rrethanat e faktit të rezultuara. vlerësimi i gjykatës, në të cilin merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke u ndalur jo vetëm tek dispozitat materiale, por edhe ato të ligjit të posaçëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje dhe (iv) konkluzion mbi çështjen,

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi : (i) çdo kërkim të objektit të padisë apo kërkesës (pranimin /rrezimin e kërkesë padisë apo pushimin), (ii) përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet, apo mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (dërgimin në gjyq, deklarin e moskompetencës apo pushimin e procedimit penal), (iii) dënimin dhe masën e dënimit, (iv) llogaritjen e dënimit, (v) mënyrën e ekzekutimit të tij, (vi) disponimi mbi provat materiale dhe (vii) shpenzimet gjyqësore, në çështjet civile/penale.

Përgjithësisht vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal ose civil, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në: nenin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal, nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale themelit, etj.

Në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, gjithmonë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, ligji i zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese, përfundimet e arritura nga gjyqtari. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, rezultojnë një nivel shumë i mirë arsytimi, i detajuar dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore,⁵² përcaktimit të barrës së provës, rolit të gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë, etj.

Arsyetimi i vendimeve burim vlerësimi ka zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material (civil apo penal), duke bërë një analizë tërësore të provave të administruara në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim, për të vijuar më pas me aplikimin e ligjit mbi faktet e çështjes konkrete, në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari tregon kujdes në arsyetim dhe mënyrën e organizimit të tij, për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me natyrën e mosmarrëveshjes/çështjes dhe zgjidhjen e saj në themel.

Ne vendimet civile burim vlerësimi :

Në secilin vendim civil burim vlerësimi siç rezulton bëhet fillimisht një përshkrim i ecurisë procedurale të çështjes duke nisur nga veprimet paraprake dhe pastaj gjatë seancës gjyqësore.

-Vendimi nr.1169-284, datë 09.11.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (vendim jopërfundimtar), me objekt “1. Detyrimi i palës së paditur, të paguajë në favor të palës paditëse, shpërblimin e plotë të dëmit pasuror dhe jopasuror të shkaktuar nga aksidenti i ndodhur në datë 25.12.2017, si pasojë e të cilit ka pësuar dëmtime B.R në vlerën paraprake 1,000,000 lekë.2. Detyrimi i palës së paditur, të paguajë të gjitha shpenzimet gjyqësore dhe avokatore” në këtë vendim fillimisht përshkruhet ecurinë procedurale të çështjes civile në veprime paraprake dhe në seancë gjyqësore, duke sqaruar në vendim se pasi është regjistruar kërkesëpadija dhe i është caktuar përmes shortit gjyqtarit të çështjes, i është kërkuar palës së paditur e drejta për të lëshuar deklaratë mbrojtje; i është dhënë mundësia palës paditëse për prapësime; janë kryer seancat përgatitore dhe ato gjyqësore ku janë administruara prova shkresore dhe janë caktuar ekspertë (mjekoligjor dhe vlerësues dëmsh), të cilët kanë përpiluar aktet përkatëse. Më tej sqarohet se në seancën e datës 09.11.2020 pala paditëse nuk ka marrë pjesë në seancë

⁵²Te gjitha vendimet vendimet civile burim vlerësimi.

dhe nuk ka rezultuar të ketë paraqitur kërkesë për shtyrje seance apo arsye për mosparaqitjen e saj. Më pas përmendet përmbajtja e nenit 179 të K.Pr.Civile, ku parashikohet se nëse paditësi pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes. Nga ana tjetër, nënvizohet përcaktimi ligjor se kur i padituri e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, mund të kërkojë vijimin e gjykimit në mungesë të paditësit dhe gjykata kur e vlerëson se qëndrimi i të paditurit ka shkak të ligjshëm, vijon gjykimin në mungesë. Në këto kushte, duke qenë se i padituri kishte paraqitur deklaratë mbrojtje në vendim sqarohet se i është kërkuar mendim palës së paditur, lidhur me vijimin e gjykimit, e cila ka kërkuar pushimin e gjykimit. Më tej, interpretohet sistematikisht neni 299 shkronja “ç” të K.Pr.Civile, ku përcaktohet se pushimi i gjykimit vendoset dhe në situatën që parashikohet shprehimisht në ligj. Sakaq, duke marrë parasysh përcaktimin në nenin 179 pika 2 të K.Pr.Civile, në vendim konkludohet se është rasti kur pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj.

-Vendimi nr.326-109, datë 11.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (vendim jopërfundimtar), me objekt *“1. Konstatim i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes...Çregjistrim i pasurive të paluajtshme....Sigurim padie...”*:Vendimi gjyqësor fillimisht përshkruan ecurinë procedurale të çështjes civile në veprime paraprake, ndryshimet e trupave gjyqësore dhe vendimarrjet përkatëse; veprimet paraprake të kryera nga Gjyqtari subjekt vlerësimi si dhe caktimi i seancës përgatitore. Më tej sqarohet se pala paditëse nuk ka marrë pjesë në seancë përgatitore dhe nuk ka rezultuar të ketë paraqitur kërkesë për shtyrje seance apo arsye për mosparaqitjen e saj. Më tej, përmendet përmbajtja e nenit 179 të K.Pr.Civile, ku parashikohet se nëse paditësi pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk paraqitet në seancë përgatitore ose në seancë gjyqësore dhe rezulton se ka dijeni rregullisht, gjykata vendos pushimin e gjykimit, kur i padituri nuk ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes. Nga ana tjetër, nënvizohet përcaktimi ligjor se kur i padituri e ka dorëzuar deklaratën e mbrojtjes, mund të kërkojë vijimin e gjykimit në mungesë të paditësit dhe gjykata kur e vlerëson se qëndrimi i të paditurit ka shkak të ligjshëm, vijon gjykimin në mungesë. Në këto kushte, duke qenë se i padituri kishte paraqitur deklaratë mbrojtje në vendim sqarohet se i është kërkuar mendim palës së paditur, lidhur me vijimin e gjykimit, e cila ka kërkuar pushimin e gjykimit. Në vijim, në vendim interpretohet sistematikisht neni 299 shkronja “ç” të K.Pr.Civile, ku përcaktohet se pushimi i gjykimit vendoset dhe në situatën që parashikohet shprehimisht në ligj. Sakaq, duke marrë parasysh përcaktimin në nenin 179 pika 2 të K.Pr.Civile, në vendim konkludohet se është rasti kur pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj. Vendimi mbyllet me heqjen e masës së sigurimit, padisë së sekuestros konservative mbi sendet objekt gjykimi, të vendosur me vendimarrje të ndërmjetme dhe disponimin mbi shpensimet gjyqësore.

-Vendimi nr. 147-42, datë 03.02.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*me objekt: 1. Kundërshtim i veprimeve përmbartimore; 2. Deklarim se titulli vendim gjyqësor është i pavlefshëm dhe se është shuar më pas, me deklaram të vetë kreditores para gjykatës.*) Gjyqtari merr në analizë ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuadër, pasi interpreton nenet 609, 610 të K.Pr.Civile si mjetet e parashikuara për mbrojtjen në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm, dhe analizon se pala mund t’i kërkojë të dyja në një padi (pavlefshmëri titulli dhe kundërshtim veprimesh përmbartimore), por gjykata merr në

shqyrtim vetëm pretendimin për pavlefshmëri tituli ekzekutiv, sepse veprimet përbarimore janë pasojë e titullit ekzekutiv, citon dhe interpreton paragrafin e dytë të nenit 609 të K.Pr.Civile në rrethanat e rastit konkret për të pohuar se megjithëse është respektuar afati 30 ditor për ngritjen e padisë, pavlefshmëria e titullit nuk i referohet rrethanave dhe fakteve që kanë ndodhur pas dhënies së vendimit, dhe në këtë rast, përmes interpretimit qëllimor të nenit 494 të K.Pr.Civile orienton palën që mjeti juridik që duhet të përdori është kërkesa për rishikim. Në vendim i jepet përgjigje pretendimeve të palëve duke argumentuar secilin prej pretendimeve të saj, përmes shqyrtimit dhe analizimit të provave në tërësinë e tyre. Më tej, në vendim theksohet se vendimi i kundërshtuar (tituli ekzekutiv) ka marrë formë të prerë, ka efekte konstituive (ka zgjidhur përfundimisht mosmarrëveshjen mes palëve) si dhe efekte prekluzive (ndalon ndryshimin e zgjidhjes në fjalë), përbën gjë të gjykuar, e si i tillë nuk mund të vihet në diskutim. Vendimi mbyllet duke zbatuar nenin 106 të K.Pr.Civile përmes ngarkimit të shpenzimeve gjyqësore palës gjyqëmbësore dhe sqarohen palët qartazi në lidhje me afatin e ankimit ndaj vendimit.

-Vendimi nr. 922-205, datë 07.07.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*me objekt "Vërtetimin e faktit juridik se kërkuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë ish Ndërmarrjes së Përpunimit të Drurit Tropojë për periudhën 06.07.1976-01.10.1991."*) Vendimi gjyqësor fillimisht identifikon ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuadër, citon dhe interpreton nenin 32 të K.Pr.Civile, duke bërë dallimet midis padive të detyrimit të parashikuara nga shkronja "a" e dispozitës, dhe padive të njohjes të parashikuara nga shkronjat "b" dhe "c", të cilat kanë për qëllim të sigurojnë bazën për një padi detyrimi në të ardhmen. Në vijim në vendim trajtohet lidhja ndërmjet nenit 32 të K.Pr.Civile dhe nenit 7 të Ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; bëhet dallimi midis mjeteve procedurale të parashikuara respektivisht në nenet 32 dhe 388 të K.Pr.Civile; analizohet veprimtaria e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në rastin e kërkesave për caktim pensioni; referuar praktikës gjyqësore, shpjegohet rolin i gjyqtarit administrativ apo civil në mosmarrëveshjet me objekt që lidhen me të drejtën për pension. Si rrjedhojë e të gjithë kësaj analize, arrihet në përfundimin se natyra e çështjes objekt gjykimi është civile, gjykim gracioz pa palë kundërshtare. Më pas, bëhet vlerësimi i rrethanave të faktit duke pasqyruar në vendim arsyen pse i është drejtuar gjykatës kërkuesi, Pas pasqyrimin të të drejtës së cenuar, citohet përmbajtja e neneve 388 dhe 389 të K.Pr.Civile dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 464 datë 22.07.1998 "Për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të sigurimit të punonjësve të ish kooperative bujqësore, ndërmarrjeve dhe institucioneve që kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre ose janë në procesin e mbylljes" për të pohuar se ka qenë Instituti i Sigurimeve Shoqërore përgjegjës të mblidhte brenda datës 30.10.1998 dokumentacionin e sigurimit për ish kooperativat bujqësore, ndërmarrjet dhe institucionet buxhetore dhe jobuxhetore, të cilat kanë ndërprerë veprimtarinë e tyre dhe se ky subjekt ka detyrimin të administrojë të dhënat lidhur me sigurimet shoqërore të subjekteve private. Pasur në konsideratë këtë detyrim ligjor dhe të dhënat e marra nga prova me dëshmitarë, e përfituar sipas neneve 231, 232, 233 shkronja "a", 235 e vijues të K.Pr.Civile, në vendim konkludohet se në rrethanat kur pala kërkuese është vënë padrejtësisht, pa faj të saj, në pamundësi për t'iu pasqyruar në mënyrë të saktë, vitet e punës, pretendimet e kërkuarit rezultojnë të bazuara dhe të provuara sipas ligjit.

-Vendimi nr. 193-57, datë 14.02.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*me objekt "1. Konstatimi i pavërtetësisë së amësisë së paditësit G.N në lidhje me pasqyrimin e pasaktë të të dhënave të emrit të nënës R...2. Detyrimin e palës së padituri Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Mamurras për të bërë korrigjimin e të dhënave në regjistrat e gjendjes civile të paditësit, konkretisht nga amësia e gabuar në emrin e saktë të amësisë"*):Vendimi gjyqësor fillimisht identifikon ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuadër, identifikon normat procedurale të aplikueshme në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën, si dhe në referim të praktikës së gjykatës së lartë, mbahet qëndrimi se padia objekt gjykimi, e regjistruar fillimisht pranë gjykatës administrative, e cila ka shpallur moskompetencën, është e natyrës civile, ndonëse zyra e gjendjes civile ka statusin e një organi shtetëror publik dhe thirret si palë e paditur. Më tej, në vendim shpjegohet e drejta e cenuar e paditësit, që në të dhënat në regjistrat e gjendjes civile të tij, ka një pasaktësi në zërin "amësia". Pasi identifikohet norma materiale të aplikueshme mbi rrethanat e faktit, që përcaktojnë legjitimitimin dhe të drejtën e paditësit, konkludohet se në të dhënat e gjendjes civile të paditësit ka një pasaktësi sikurse pretendohet në padi dhe pasaktësia duhet të korrigjohet.

-Në vndimet nr. 136-41, datë 01.02.2021, nr. 1436-357, datë 23.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*me objekt: "Zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj (rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë)*), fillimisht gjyqtari merr në analizë ligjin e zbatueshëm. Konkretisht, secili prej tyre analizon institutin e martesës si një marrëdhënie juridike civile e posaçme, e cila e ka të domosdoshme mirëkuptimin përgjatë gjithë ekzistencës së saj dhe se në rastet kur martesë e ka humbur funksionin e saj dhe bashkëshortët nuk mund dhe nuk dëshirojnë të vazhdojnë më martesën mes tyre, parashikon zgjidhjen e saj, me padi nga njëri prej bashkëshortëve, ose me kërkesë nga të dy bashkëshortët bashkërisht. Vendimi trajton nenin 132 të Kodit të Familjes lidhur me shkaqet e zgjidhjes së martesës dhe interpreton se zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort vendoset në rast se provohen dy elementë: 1) shkak apo shkaqet e zgjidhjes së saj të parashikuara në nenin 132 të Kodit të Familjes dhe pasoja e sjellë nga shkak. Në këtë aspekt, në vendim aplikohen rrethanat e rastit konkret prej të cilave rezulton se konfliktet dhe grindjet e vazhdueshme kanë çuar bashkëshortët në ndërprerje të jetesës së përbashkët dhe për rrjedhojë, duke qenë se ka mbetur formale, pasi martesë e ka humbur qëllimin e saj dhe jetesa e përbashkët është bërë e pamundur kërkitimi për zgjidhjen e martesës është gjetur si i bazuar në ligj dhe prova, e si i tillë duhet të pranohet. Më tej, interpretohet neni 146 i Kodit të Familjes dhe aplikohet në rrethanat e rastit, ku disponohet me kthimin e mbiemrit që ka patur para martesë, bashkëshortit që e ka ndryshuar mbiemrin. Në vendim, mbahet në konsideratë parimi i interesit më të lartë të fëmijës, i përcaktuar në akte ligjore, konventore e ndërkombëtare, për të rregulluar marrëdhëniet prind – fëmijë, të cilat mbështeten gjithashtu në mendimin e psikologut, duke ia lënë për rritje dhe edukim njërit prind, e duke caktuar një kalendar takimi për prindin tjetër. Më tej, në vendim referohet në nenin 210/1 të Kodit të Familjes lidhur me detyrimin për ushqim për prindin që nuk i lihet fëmija për rritje dhe edukim, si një kontribut jo vetëm për të lehtësuar barrën financiare të nënës së fëmijës, por edhe si mjet për babain, për të mos u shkëputur nga përgjegjësitë e tij, karshi fëmijës. Në interpretim të kësaj dispozite konkludohet se detyrimi fillon nga dita e ngritjes së padisë. Ndersa nëvndimet nr. 1166-438, datë 31.10.2022, nr. 917-347, datë 19.09.2022, nr. 686-236, datë 21.05.2021, nr. 819-309 datë 13.07.2022, nr. 60-27 datë 18.01.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*me objekt: "Zgjidhjen e martesës*

dhe rregullimin e pasojave që vijnë prej saj (rastet kur bashkëshortët nuk kanë fëmijë”) behet po e njejta analizë si me sipër sa i perket institutin e martesës si një marrëdhënie juridike civile e posaçme, e cila e ka të domosdoshme mirëkuptimin përgjatë gjithë ekzistencës së saj dhe se në rastet kur martesë e ka humbur funksionin e saj dhe bashkëshortët nuk mund dhe nuk dëshirojnë të vazhdojnë më martesën mes tyre, parashikon zgjidhjen e saj, me padi nga njëri prej bashkëshortëve, ose me kërkesë nga të dy bashkëshortët bashkërisht. Trajton nenin 132 të Kodit të Familjes lidhur me shkaqet e zgjidhjes së martesës dhe interpreton se zgjidhja e martesës me kërkesë të njërit bashkëshort vendoset në rast se provohen dy elementë: 1) shkak apo shkaqet e zgjidhjes së saj të parashikuara në nenin 132 të Kodit të Familjes dhe pasoja e sjellë nga shkak. Në këtë aspekt, në vendim aplikohen rrethanat e rastit konkret prej të cilave rezulton se konfliktet dhe grindjet e vazhdueshme kanë çuar bashkëshortët në ndërprerje të jetesës së përbashkët dhe për rrjedhojë, duke qenë se ka mbetur formale, pasi martesë e ka humbur qëllimin e saj dhe jetesa e përbashkët është bërë e pamundur kërkimi për zgjidhjen e martesës është gjetur si i bazuar në ligj dhe prova, e si i tillë duhet të pranohet.

***Ne vendimet penale burim vlerësimi,** gjyqtari fillimisht merr në analizë ligjin e zbatueshme dhe konkretisht interpreton dispozitën materiale që lidhet me figuren e veprës penale për të cilin gjykohej i pandehuri në rastin vendimeve penale kjo. Kur është rasti gjyqtari ben edhe interpretim historik të normes penale duke cituar përmbajtjen e dispozites duke argumentuar gjithashtu dhe kur kemi të bëjmë me veper penale ose jo. Ne vendimin nr. 394-122, datë 18.05.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt “Deklarimi i shuarjes së veprës penale dhe i ekzekutimit të vendimit penal”, për kryerjen e kësaj analize, në vendim përdoren metodat e interpretimit gramatikor, historik, qëllimor dhe origjinal, përmes të cilëve konkludohet se neni 96 i Kodit Penal, i pandryshuar dënonte pakujdesinë në trajtimin mjekësor, të kryer në të dy format e pakujdesisë; neni 96 i Kodit Penal, i ndryshuar, dënon pakujdesinë në trajtimin mjekësor, të kryer vetëm në formën e neglizhencës, por është ulur masa e dënimit; pakujdesia në trajtimin mjekësor e kryer në formën e vetëbesimit të tepruar është shfuqizuar si veprë penale. Në këtë kuadër, vendimi trajton veprimin e ligjit penal në kohë parashikuar nga neni 3 i Kodit Penal, kuptimin e vendimit që merr formë të prerë dhe që nënkupton: vendimin që është i ekzekutueshëm ose vendimin që është i pandryshueshëm, me mjetet e zakonshme të ankimit, pra që ka fituar efektet e gjësë së gjykuar, duke u udhëhequr nga parimi kushtetues se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Pas analizës juridike, përqasen në vendim rrethanat e çështjes dhe konkludohet se vendimi me anë të të cilit është dënuar kërkuesi nuk ka marrë formë të prerë megjithëse është i ekzekutueshëm dhe se ai është dënuar për një veprë penale që nuk është dekriminalizuar, por është riformuluar në një mënyrë më të favorshme.*

-Vendimi nr. 65-16, datë 19.01.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (me objekt: Dërgimin në gjyq i çështjes, për procedimin penal nr. 337 viti 2020 në ngarkim të të miturit në konflikt me ligjin S.R, akuzuar për kryerjen e veprës penale “Vjedhja” parashikuar nga neni 134 i K.Penal, gjyqtari përshkruan ecurinë procedurale në seancë paraprake, si aspekte të rëndësishme mbi procesin e rregullt veçanërisht të drejtësisë miqësore për të miturit, duke referuar nenin 18 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur mbi prezencën e psikologut si e detyrueshme në çdo fazë dhe procedurë që kryhet me të mitur në konflikt me ligjin. Më tej, në vendim citohen qëndrimet që ka mbajtur secili

pjesëmarrës lidhur me kërkesën për dërgim në gjyq dhe dokumentohet se i mituri në konflikt me ligjin, ndonëse nuk e pranon veprën, ai paraqiti kërkesë për gjykim të shkurtuar. Në vendim arsyetohet mungesa e kompetencës së gjyqtarit të seancës paraprake për të disponuar lidhur me bazueshmërinë e kërkesës përmes interpretimit sistematik të neneve 332/c pika 3, 332/dh pika 1 shkronja “c”, dhe 332/ë pika 4 të Kodit të Procedurës Penale, por vetëm si detyrim për t’u përfshirë këtë kërkesë në fashikullin e gjykimit. Pas kësaj, vendimi përshkruan të gjitha veprimet hetimore të kryera Pas përshkrimin të detajuar të veprimeve hetimore, në vendim sintetizohet fakti penal dhe në aplikim të nenit 134 të Kodit Penal, konkludohet se i mituri në konflikt me ligjin e ka konsumuar këtë veprë penale dhe ai është i përgjegjshëm penalisht në aspektin e moshës dhe përgjegjshmërisë penale. Për rrjedhojë, çështja duhet të dërgohet për gjykim. Pasi arrihet në përfundimin se çështja duhet të dërgohet për gjykim sepse ka prova të mjaftueshme që krijojnë dyshim të arsyeshëm se i mituri në konflikt me ligjin ka konsumuar figurën e veprës penale për të cilën akuzohet, përcaktohet përmbajtja e fashikullit të gjykimit (aktet e kryera gjatë hetimeve paraprake, aktet e seancës paraprake, kërkesa për gjykim të shkurtuar).

-Vendimi nr. 1415-491, datë 21.12.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt “Kundërshtimi i vendimit datë 27.09.2020 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin “Për pushimin e çështjes për procedimin penal nr. 54 të vitit 2018”. Vendimi trajton normat procedurale penale të zbatueshme dhe konkludon se ankimi është bërë ndaj një vendimi pushimi të Prokurorit dhe si i tillë duhet të shqyrtohet në dhomë këshillimi. Më tej, vendimi përshkruan veprimet hetimore të kryera, provat e grumbulluara, qëndrimin e organit të akuzës në përfundim të hetimeve për pushimin e çështjes për shkak se është parashkruar ndjekja penale e kundërvajtjes penale të parashikuar nga neni 126 i Kodit Penal “Mosnjoftimi i ndryshmit të vendbanimit”. Më tej, në vendim kundëranalizohet qëndrimi i Prokurorit, duke u arsyetuar se vepra penale e parashikuar nga neni 126 i Kodit Penal është veprë penale e qëndrueshme, pra që konsiderohet se vazhdon të konsumohet derisa autori nuk bën njoftimin e ndryshimit të vendbanimit dhe në këtë kuptim ndjekja penale për këtë veprë penale nuk parashkruhet. Megjithatë analizë, në interpretim të rrethanat të rastit konkret, përcaktohet data e fillimit të afatit të parashkrimit, ku konkludohet se në zbatim të nenit 66 shkronja “d” të Kodit Penal, duke qenë se i mituri ka mbushur moshën madhore në datën 13.08.2017, kjo është data nga e cila fillon afati i parashkrimit. Sakaq, në aplikim sistematik të neneve 66 shkronja “d”, 126 të Kodit Penal dhe nenit 328 pika 1 shkronja “d” të K.Pr.Penale, është konkluduar se organi procedues (prokuroria dhe gjykata) ndodhen para një shkakut sipas të cilit ndjekja penale nuk duhet të vazhdojë dhe vendimi i pushimit të çështjes nga Prokurori është i bazuar. Për rrjedhojë, vendimi mbyllet me përfundimin se ankesa duhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj.

-Në vendimi me objekt “Kundërshtim i vendimit “Për sekuestrimin e dokumenteve” datë 15.09.2020”, merr në analizë ligjin e zbatueshëm, konkretisht interpreton nenin 208/a të Kodit të Procedurës Penale, në lidhje me Konventën “Për krimin në fushën e kibernetikës”, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr. 8888, datë 25.04.2002, nga ku arsyetohet se sekuestrimi i të dhënave dhe/ose sistemeve ku përfshihen kompjuterat, printerat, sidomos serverat mund të sekuestrohen vetëm me vendim të gjykatës, jo me vendim të prokurorit. Në këtë kuadër, duke referuar në kuptimin që jep konventa për “sistem kompjuterik” dhe “të dhëna kompjuterike”

konkludohet në vendim se printerat dhe njësitë qendrore të kompjuterave të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë janë sistem kompjuterik dhe të dhënat që përmbajnë kompjuterat janë “të dhëna kompjuterike”. Pas këtij arsytimi, përqasen rrethanat e procedimit penal dhe vendimi konkludon se vendimi i prokurorit objekt shqyrtimi është i paligjshëm dhe duhet të shfuqizohet, duke qenë se është marrë nga prokurori, në një kohë që duhet të ishte marrë nga gjykata, nuk është i arsyetuar, nuk është proporcional, cenon të drejtat subjektive dhe interesat e ligjshme të subjekteve të tjera, si dhe mund të cenojë të drejta konfidencialiteti ose të dhëna sekrete.

Vendimin nr. 297-87, datë 02.03.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt *“Pushim i çështjes për procedimin penal nr. 168 të vitit 2019 regjistruar për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”* merr në analizë ligjin e zbatueshëm, konkretisht interpreton nenin 248 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” dhe konkretisht analizon se që të jemi përpara figurës së veprës penale “Shpërdorimi i detyrës” duhet që të plotësohen katër elementet vijuese: të ekzistojë objekti i veprës penale (të vërtetohet thyerja e rregullave të vendosura nga aktet ligjore e nënligjore, që normojnë detyrat e “personit që ushtron funksione publike”); me veprime e mosveprime të kundërligjshme të ketë sjellë përfitim për vete dhe/ose dëmtrim të interesave të ligjshme të shtetit, personave fizikë ose juridikë, pra të ekzistojë lidhja shkakësore mes veprimit apo mosveprimit të autorit dhe pasojës; subjekti të jetë i përgjegjshëm, mbi 14 vjeç dhe i posaçëm, që nënkupton se duhet të ketë të paktën një ligj, apo akt nënligjor që i jep zyrtarisht dhe shprehimisht statusin e funksionarit publik, autorit të mundshëm të veprës penale. Në anën subjektive, vepra duhet të kryhet gjithmonë me dashje direkte, sepse në rast se kryhet me pakujdesi apo dashje indirekte, atëherë nuk kemi konsumim të nenit 248 të Kodit Penal. Më tej, vendimi përqas rrethanat e faktit dhe konkludohet se nga hetimet paraprake dhe shqyrtimi gjyqësor nuk kanë rezultuar veprime që vënë në dyshim veprimtarinë administrative lidhur me regjistrimin e tokës në pronësi të Rr.H. Vendimi mbyllet me vënien në dijeni të Prokurorisë nga Gjykata, se kallëzuesi mund të ketë konsumuar figurat e veprave penale të parashikuara nga nenet 305, 305/a, dhe 305/b të Kodit Penal.

-Vendimi nr. 1618, datë 22.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*me objekt: Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M.T, i akuzuar për kryerjen e figurave të veprave penale të parashikuara nga nenet 79/ë e 22, 278/1 i Kodit Penal.*) Gjyqtari pasi ben analizen sa i perket ligjit të zbatueshëm, interpreton nenet 79/ë e 22, si dhe 278 të K.Penal duke bërë kualifikimin ligjor të fakteve, për secilën prej figurave të veprave penale objekt akuze dhe paralelisht me interpretimin e këtyre dispozitave materiale, përqas rrethanat e faktit. Kështu, vendimi analizon lidhur me akuzën e parë se është cenuar jeta e një personi dhe është vënë në rrezik jeta e shumë personave. Vepra është realizuar me veprime nga i pandehuri duke goditur me armë zjarri në drejtim të personit, me të cilin ka pasur konfliktin, por në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave. I pandehuri është i përgjegjshëm penalisht dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, vepra është kryer me dashje të tërthortë. Lidhur me akuzën e dytë, në vendim analizohet se i pandehuri ka mbajtur një armë zjarri pa lejen e organeve kompetente, jo vetëm që e ka mbajtur por edhe e ka përdorur, i pandehuri ka përgjegjësi penale dhe veprën e ka kryer me dashje të drejtëpërdrejtë.

-Vendimi nr. 777-100, datë 28.06.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*me objekt: Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit E.R, i akuzuar për kryerjen e figurave të veprave penale të “Vrasjes me paramendim” kryer në bashkëpunim mbetur në tentativë dhe “Përndjekja” parashikuar nga nenet 78/1, 25 e 22, 121/a22 i Kodit Penal.*) merr në analizë ligjin e zbatueshëm, konkretisht interpretohen literalisht instituti i tentativës dhe jepet kuptimi i bashkëpunimit sipas praktikës unifikuese, ku citohet se që një fakt penal të konsiderohet se është kryer duhet të bashkëekzistojnë si kushte: i) pluraliteti i personave; ii) realizimi i faktit penal në të gjitha elementet materiale të tij; iii) dhënia e një kontributi sado elementar në kryerjen e veprës penale, nga secili prej bashkëpunëtorëve; iv) dijenia e autorëve (si në rast kur nuk identifikohen edhe kur nuk mbajnë përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë mendore apo moshës). Më pas, interpretohet neni 78 të Kodit Penal, lidhur me figurën e veprës penale “Vrasje me paramendim” duke e cituar përmbajtjen e kësaj dispozite si dhe duke e analizuar figurën e veprës penale në këto aspekte: objekti (mbrojtja e së drejtës së jetës); ana objektive (me veprime e mosveprime të rrezikshme, me mënyra e mjete të ndryshme, ardhja e pasojës –vdekja e viktimës, paramendimi (shkaku provokues, kalimi i një intervali kohe, gjakftohtësia e vendosmëria; subjekti (14 vjeç)dhe i përgjegjshëm; ana subjektive (dashje e drejtëpërdrejtë,e menduar më parë). Në vijim, vendimi trajton gjerësisht parimin e prezumimit të pafajësië, duke referuar jurisprudencën unifikuese, kushtetuese dhe të GJEDNJ. Pas kësaj analizohet se: që të jepet një vendim fajësie penale, duhet që nga ana e prokurorisë (ose viktimës akuzuese) subjekti akuzues duhet të provojë para gjykatës, në mënyrë të plotë dhe pa asnjë dyshimi: *që fakti penal ka ndodhur; që fakti penal ka ndodhur në një mënyrë të caktuar (pra, jo duke e lënë ngjarjen të paqartë); që vepra është kryer nga i pandehuri/të pandehurit; që vepra është kryer sipas elementeve të anës subjektive të përcaktuara qartë dhe saktë; rolin e secilit prej autorëve në kryerjen e veprës penale, duke individualizuar secilin prej tyre, sa i takon veprimeve/mosveprimeve kriminale.* Pas kësaj analize teorike, përqasen rrethanat e çështjes dhe argumentohen faktet e provuara duke konkluduar se nuk ka asnjë provë direkte ose indirekte që të përcaktojë se sa kanë qenë autorët e ngjarjes, si dhe se kush janë ata; edhe pse i pandehuri i ka kërkuar disa herë viktimës që të ikte me të, nuk rezultojnë kush është bashkëpunëtori; nuk është rrëzuar mundësia që sulmi të ketë ndodhur për shkaqe të tjera; nuk rezulton se shkaku i paraqitur nga akuza të jetë aq i fortë sa të justifikojë ngjarjen; nuk është kryer asnjë veprim i papërsëritshëm gjatë hetimeve paraprake; dëshmitari nuk ishte i besueshëm. Sakaq, në vendim konkludohet se jo vetëm që akuza nuk u provua tej çdo dyshimi të arsyeshëm, por nuk u paraqit asnjë e dhënë që të lidhte të pandehurit me ngjarjen, ndaj në bazë të nenit 388 shkronja “d” të K.Pr.Penale, i pandehuri është shpallur i pafajshëm për akuzën e parë. Në vijim, vendimi merr në analizë akuzën e dytë të ngritur ndaj të pandehurit. Në këtë spektër, vendimi interpreton nenin 121/a të Kodit Penal, lidhur me figurën e veprës penale “Përndjekja” duke e cituar përmbajtjen e kësaj dispozite si dhe duke e analizuar figurën e veprës penale në këto aspekte: objekti (paprekshmërinë e lirisë së personit); ana objektive (me veprime e mosveprime të përsëritura që shfaqen në kërcënimin ose ngacmimin e personit, të ketë ardhur pasoja kriminale – gjendje e vazhdueshme dhe e rëndë e ankthit ose e frikës për sigurinë e personit, ose detyrimi për të ndryshuar mënyrën e jetesës; subjekti i posaçëm lidhje gjinore ose sentimentale mes autorit dhe viktimës; ana subjektive (dashje direkte lidhru me veprimet dhe qëllimit

(pasojë). Pas trajtimit teorik, aplikohen rrethanat e rastit konkret dhe konkludohet se i pandehuri duhet të deklarohet fajtor për këtë akuzë, duke iu referuar rrethanave lehtësuese dhe rënduese, ka caktuar llojin dhe masën e dënimit me burgim. Vendimi mbyllet me disponimin mbi provat materiale, shpenzimet gjyqësore dhe përcaktimin e fillimit të afatit të së drejtës së ankimit, referuar ndryshimeve procedurale.

-Vendimi nr. 1339-119, datë 02.12.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt *“Vleftësim i ligjshëm i arrestimit në flagrancë. Caktim i masës së sigurimit personal”*. merr në analizë ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuadër, sqaron kuptimin e “arrestimit në flagrancë” dhe “arrestit në burg” sipas *praktikës unifikuese e jurisprudencës kushtetuese, standartet kryesore të përcaktuara nga Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese dhe GJEDNJ, sa lidhet me caktimin e masave të sigurimit personal. Po ashtu, vendimi interpreton nenin 228 e 229 të K.Pr.Penale ku përcaktohen kushtet e kriteret që mbahen në konsideratë. Më tej, duke iu kthyer pretendimeve të ngritura nga pala kërkuese, vendimi interpreton nenin 251 të K.Pr.Penale lidhur me arrestimin në flagrancë, duke cituar përmbajtjen e dispozitës; duke bërë dallimin midis pikës 1, pikës 2 dhe pikës 3 të saj, ku sipas rastit përcaktohet edhe kontrolli i gjykatës. Në vendim theksohet se në pikën 1, gjykata nuk vlerëson dot diskrecionin e policisë gjyqësore, por kontrollon përmbushjen e detyrimeve formale; diskrecioni që parashikohet në pikat 2 dhe 3 nuk mund të përdoret në mënyrë abuzive apo të tejkalohet. Ai mund dhe duhet të kryhet vetëm nëse argumentohet qartësisht me shkrim, por jo domosdoshmërisht me akt të veçantë. Pas analizës teorike, aplikohen rrethanat e rastit konkret dhe konkludohet se arrestimi në flagrancë duhet të vleftësohet i ligjshëm, pasi personi nën hetim ka qenë në ndjekje nga policia gjyqësore, ndonëse është dorëzuar vullnetarisht në komisariatit e policisë. Nga ana tjetër, në vendim merret në analizë neni 278 i K.Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyes dhe i municionit” kryer në formën e mbajtjes së një arme zjarri në mjedis të hapur për publikun, dhe analizohen të katër elementët (objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive). Në këtë spektër, vendimi interpreton sistematikisht nenin 278 të Kodit Penal, me nenet 56 pika 2 shkronja “a”, 6 pika 1 të Ligjit nr. 74/2014 “Për armët”, nenin 35 të Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë publike” për të konkluduar se përdorimi i armës së zjarrit nga personi që ka autorizimin për mbajtjen dhe përdorimin e saj në kundërshtim me këtë autorizim (sikurse në rrethanat e rastit konkret), përbën shkelje ligjore, e cila është vepër penale nëse sjell pasoja penalisht të dënueshme si: vrasje, plagosje etj. Në të kundërt, mbajtja dhe/ose përdorimi i armës së zjarrit nga personi i autorizuar për mbajtjen dhe përdorimin e saj, siç janë edhe punonjësit e shërbimit të sigurisë fizike në shkelje të lejes ose të autorizimit përkatës, sjell përgjegjësi administrative. Më tej, vendimi interpreton nenin 274 të K.Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Prishja e qetësisë publike”. Në këtë spektër analizohet objekti (marrëdhëniet juridike që garantojnë rendin dhe sigurinë publike); ana objektive (kryhet në forma të ndryshme të cilat tregojnë hapur mospërfillje ndaj rregullave të vendosura nga shteti apo shoqëria. Pas kësaj, analize, aplikohen rrethanat e rastit dhe konkludohet se për këtë figurë të veprës penale, personi nën hetim duke qenë i padënuar më parë, kryefamiljar, është vetëdorëzuar, ndaj tij duhet të caktohet masa e sigurimit *“Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”* parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale. Vendimi mbyllet me orientimin mbi momentin se kur fillon e drejta e ankimit për palët.*

-Vendimi nr. 966-356, datë 02.10.2020 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt *“Pushim i çështjes për procedimin penal nr. 487 të vitit 2019 regjistruar për veprën penale “Shkatërrim i pronës me zjarr” parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal”*:Vendimi gjyqësor fillimisht merr në analizë provat që kanë rezultuar nga veprimet hetimore të kryera, duke vënë theksin tek një nga provat shkencore, akti i ekspertimit piroteknik sipas të cilit shkëndijat elektrike të krijuara nga luhatjet e tensionit elektrik nuk përjashtohen si shkak për rënien e zjarrit. Mbi këtë bazë, vendimi trajton se nga të dhënat e hetimit dhe provat e administruara në fashikull, rezulton se nuk kemi elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal, për të cilën është regjistruar procedimi penal dhe as të ndonjë vepre tjetër penale, pasi nuk ekzistojnë elementët e anës objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale. Në vendim sqarohet se rënia e zjarrit mund të ketë ardhur për shkaqe aksidentale, dhe zjarri nuk është shkaktuar nga veprime apo mosveprime me dashje. Si rrjedhojë e kësaj analize të fakteve, pasi është identifikuar norma juridike penale (neni 151 i K.Penal) është konkluduar se nuk ndodhemi para veprës penale “Shkatërrimi i pronës me zjarr” parashikuar nga neni 151 i Kodit Penal.

-Vendimi nr. 1175-151, datë 10.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (me objekt: *Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit M.SH, i akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal.*):Vendimi gjyqësor fillimisht merr në analizë ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuadër, vendimi trajton kualifikimin ligjor të fakteve, duke cituar dhe analizuar në të katër elementët e tij (objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive) figurën e veprës penale të “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” parashikuar në nenin 137 të Kodit Penal. Interpretimi bëhet nga pikëpamja teorike e kësaj figure të veprës penale, por dhe në harmoni me rrethanat e rastit në shqyrtim nga Gjyqtari. Duke analizuar rrethanat e rastit konkret, në vendim theksohet se i pandehuri furnizohej me energji elektrike përmes një lidhje të dyfishtë që mundësonte mosmatjen dhe mosfaturimin plotësisht të vlerës, për rrjedhojë rezultoi e vërtetuar gjyqësisht se i pandehuri ka konsumuar veprën penale për të cilën akuzohet, “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” në formën e “vjedhjes së energjisë elektrike”. Më pas, analizohet se i pandehuri ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, si dhe nga ana subjektive vepra është kryer me dashje direkte. Pasi në vendim konkludohet mbi fajësinë, zbatohet neni 137/1 dhe 32/1 i Kodit Penal, për të përcaktuar masën e dënimit prej 3 (tre) muaj burgim, por si rrjedhojë e aplikimit të institutit të gjykimit të shkurtuar, dënimi ulet me 1/3. Në vijim, analizohen rrethanat për aplikimin e nenit 59 të Kodit Penal, të tilla si: i padënuar më parë, qëndrimi gjatë hetimeve paraprake dhe gjatë gjykimit, faktin se u gjykua me gjykim të shkurtuar, rrezikshmërinë e paktë të veprës penale, faktin se është kryefamiljar, faktin se ka shlyer detyrimet ndaj viktimës.

-Vendimi nr. 1221-449, datë 17.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (me objekt: *Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr. 304 viti 2014 për veprën penale të “Vjedhjes” parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal*)Vendimi gjyqësor fillimisht merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke interpretuar nenin 134 të Kodit Penal mbi rrethanat e çështjes për të përcaktuar se vepra duhet të kualifikohet sipas paragrafit të parë ose të dytë, sa kohë nuk ka të dhëna nëse është kryer nga një person i vetëm apo nga disa. Më

tej, referohet në shkronjën “ç” të nenit 66 të Kodit Penal, për të përcaktuar se ndjekja penale parashkruhet dhe çështja ose procedimi duhet të pushojë, nëse nga momenti që ka ndodhur një veprë penale, e cila dënohet me burgim gjer në pesë vjet, e deri në momentin që autori merret si i pandehur kanë kaluar pesë vjet. Duke interpretuar këtë parashikim ligjor, aplikohet në rrethanat e rastit konkret dhe konkludohet se plotësohen këto kritere, vepra penale konsiderohet e shuar dhe autori i saj nuk mund të merret si i pandehur. Më pas, vendimi mbyllet duke referuar nenet 329/a pika 1 dhe 328 pika 1 të K.Pr.Penale, për të përlegjur kërkesën e prokurorit pranë gjyqtarit të seancës paraprake për pushimin e akuzës ose të çështjes.

-Vendimi nr. 14-202-16, datë 12.02.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*me objekt: Gjykimin e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit E.P, i akuzuar për kryerjen e figurës së veprës penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.*):Vendimi gjyqësor fillimisht merr në analizë ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuadër, vendimi trajton kualifikimin ligjor të fakteve, duke cituar dhe analizuar në të katër elementët e tij (objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive) figurën e veprës penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar në nenin 291 të Kodit Penal. Interpretimi bëhet nga pikëpamja teorike e kësaj figure të veprës penale, por dhe në harmoni me rrethanat e rastit në shqyrtim nga Gjyqtari. Duke analizuar rrethanat e rastit konkret, në vendim theksohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale në formën e drejtimit të motomjeteve pa leje drejtimi përkatëse, duke cenuar kështu marrëdhëniet juridike të vendosura për mbrojtjen e rendit publik në fushën e qarkullimit rrugor, të lidhura me sigurinë e jetës, shëndetit dhe pronës; ka vepruar me dashje direkte dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale e nuk ka dyshime mbi papërgjegjshmërinë e tij. Më pas, analizohet se i pandehuri ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, si dhe nga ana subjektive vepra është kryer me dashje direkte. Pasi në vendim konkludohet mbi fajësinë, individualizohet lloji dhe masa e dënimit duke marrë parasysh personalitetin e të pandehurit, qëndrimin dhe sjelljen me punonjësit e policisë dhe formën e kryerjes së veprës penale, po ashtu faktin se i pandehuri disponon leje drejtimi të vlefshme për automjete. Si rrjedhojë, përcaktohet si masë dënimi si rrjedhojë e aplikimit të institutit të gjykimin të shkurtuar, dënimi ulet me 1/3. Në vijim, merret në shqyrtim kërkesa e të pandehurit dhe aplikohet neni 53/a në lidhje me nenin 291 paragrafi i dytë të Kodit Penal, me dakordësinë e Prokurorisë dhe vendoset zëvendësimi i dënimit me burgim me pagimin e një shume monetare në favor të shtetit. .

-Vendimi nr. 859-215, datë 25.06.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt *“Pushim i çështjes për procedimin penal nr. 253 të vitit 2019 regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”*: Vendimi gjyqësor fillimisht analizon ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuptim, interpreton nenin 186 të Kodit Penal, duke zbërthyer përmbajtjen e tij. Konkretisht analizon objektin që mbron neni 186 i Kodit Penal, si mbrojtës të marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt të personave juridikë publikë dhe privatë, si dhe të personave fizikë, të mbrojtura posaçërisht nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Në pikëpamje të anës objektive, analizohet se vepra mund të kryhet në dy forma: me falsifikim të dokumentit dhe me përdorim dokumenti të falsifikuar. Sa i takon konceptit të përdorimit, jepet kuptimi se do të thotë paraqitja e dokumentit të falsifikuar në një procedurë administrative apo gjyqësore, si provë, dokument apo akt, përmes së cilit, autori synon të arrijë një qëllim

të caktuar, të cilin mund t'a arrijë vetëm në rast se, dokumenti i falsifikuar trajtohej jo si i falsifikuar, pra si i rregullt. Po ashtu, analizohet se falsifikimi mund të kryhet me tri mënyra: I. Duke ndryshuar një dokument origjinal (të rregullt) përmes pasqyrimin të rrethanave të pavërteta; II) Përmes prodhimit nga e para të një dokumenti tërësisht të falsifikuar; III. Përmes prodhimit të një dokumenti që megjithëse formalisht është i rregullt, në përmbajtje përmban të dhëna që dihet se janë të pavërteta. Më tej, në vlerësim analizohet se kur nuk përdoret vetë akti i falsifikuar, por një akt i cili megjithëse ka buruar nga një akt i falsifikuar, në vetvete është i rregullt, nuk jemi para veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve" kryer në formën e përdorimit të dokumentit të falsifikuar, parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë i Kodit Penal. Në këtë kuptim, vijohet mendimi se përdorimi i vendimeve gjyqësore, nuk ka të njëjtin efekt si përdorimi i aktit të falsifikuar, pasi vendimet gjyqësore, edhe pse i janë referuar aktit, nuk janë në vetvete të falsifikuara. Pas kryerjes së analizës teorike të veprës penale, aplikohen rrethanat e faktit nëse bien në përcaktimet e nenit 186 të Kodit Penal. Kështu, argumentohet se në rastin konkret hera e fundit kur është përdorur akti i falsifikuar është shqyrtimi civil në Gjykatën e Lartë më datë 15.06.2012 dhe regjistrimi i pronës në ish – ZVRPP Kurbin më datë 26.12.2012, nga kjo datë kanë kaluar më shumë se 8 vite e 6 muaj, pra është parashkruar. Përdorimi i vendimeve gjyqësore në procesin gjyqësor në vitin 2018 nuk përbën përdorim akti të falsifikuar. Si rrjedhojë, zbatohet neni 66 paragrafi i parë, shkronja "ç" të Kodit Penal, lidhur me pushimin e çështjes për shkak të parashkrimit. Më tej, vendimi zbaton në mënyrë sistematike nenin 190 pika 1 shkronja "c" në lidhje me nenin 391 të K.Pr.Penale, për të vendosur deklarinimin të falsifikuar të dokumentit objekt hetimi dhe kryerjen e shënimit përkatës, duke shpjeguar qëllimin e këtij urdhërimi, për të mbrojtur të drejtat e personave të interesuar, pa u cenuar marrëdhëniet juridike të krijuara në mirëbesim, të personave të tretë, si dhe veprimtaria e rregullt gjyqësore. .

-Vendimi nr. 159-25, datë 09.02.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin (*me objekt: Gjykimin e çështjes penale me objekt Miratim marrëveshje për praninë fajësie dhe caktim dënimi ndaj të pandehurit A.L akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt" parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.*):\Vendimi gjyqësor fillimisht merr në analizë ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuadër, vendimi trajton kualifikimin ligjor të fakteve, duke cituar dhe analizuar në të katër elementët e tij (objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive) figurën e veprës penale të "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt" parashikuar në nenin 291 të Kodit Penal. Interpretimi bëhet nga pikëpamja teorike e kësaj figure të veprës penale, por dhe në harmoni me rrethanat e rastit në shqyrtim nga Gjyqtari. Duke analizuar rrethanat e rastit konkret, në vendim theksohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale në formën e drejtimit të motomjeteve pa leje drejtimi përkatëse, duke cenuar kësaj marrëdhëniet juridike të vendosura për mbrojtjen e rendit publik në fushën e qarkullimit rrugor, të lidhura me sigurinë e jetës, shëndetit dhe pronës; ka vepruar me dashje direkte dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale e nuk ka dyshime mbi përgjegjshmërinë e tij. Më pas, analizohet se i pandehuri ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm, si dhe nga ana subjektive vepra është kryer me dashje direkte. Pasi në vendim konkludohet mbi fajësinë, merret në shqyrtim marrëveshja për praninë fajësie dhe caktim dënimi, e paraqitur për t'u miratuar nga Prokurori. Kështu pra, vendimi kontrollon përmbushjen e kriterëve ligjore të parashikuara në nenin 406/dh pika 4 (pyetja shprehimisht nga gjykata e të pandehurit në

seancë gjyqësore), 406/ë pika 1 të K.Pr.Penale (pranimin e akuzës dhe ndjenjën e të penduarit, mungesa e pengesave ligjore), duke konstatuar se marrëveshja për pranim fajësie dhe caktim dënimi, lidhur mes të pandehurit dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin është në përputhje me ligjin dhe si e tillë duhet të miratohet. Në vendim, sqarohen palët për moslejimin e ankimit ndaj këtij vendimi. Më tej, aplikohet instituti i pezullimit të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënia në provë, sikurse është arritur në ujdin midis Prokurorit dhe të pandehurit në marrëveshjen për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit. Në këtë linjë, në funksion të zbatimit të ligjit, vendimi mbyllet me konstatimin e shuarjes së masës së sigurimit personal, caktuar ndaj të pandehurit në fazën e hetimeve paraprake.

-Vendimi nr. 859-215, datë 25.06.2021 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt *“Pushim i çështjes për procedimin penal nr. 253 të vitit 2019 regjistruar për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve”*:Vendimi gjyqësor fillimisht analizon ligjin e zbatueshëm. Në këtë kuptim, interpretohet neni 283 i Kodit Penal, duke u zbërthyer përmbajtja e tij. Konkretisht analizohet objekti që mbron neni 283 i Kodit Penal, si mbrojtës të marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, jetën dhe shëndetin e personit, rregullat për shitjen, marrjen, shpërndarjen, tregtimin, mbajtjen etj., e narkotikëve, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla. Në pikëpamje të anës objektive, analizohet se vepra mund të kryhet në format e parashikuara nga dispozita, ndër të cilat është edhe mbajtja në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tij, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla. Sa i përket konceptit të mbajtjes së narkotikëve në kundërshtim me ligjin, vendimi argumenton se në ligj parashikohen dy rrethana specifike: mbajtja jo për përdorim vetjak; si dhe mbajtja për përdorim vetjak jo në doza të vogla. Pasi referohet praktika unifikuese, aplikohet në rrethanat e rastit konkret. Në vendim analizohen gjithashtu dy kriteret kumulative për përjashtimin nga përgjegjësia penale sipas nenit 283 të K.Penal, mbajtja për përdorim vetjak dhe mbajtja e lëndës në doza të vogla. Pasi bëhet kjo analizë, aplikohet në rrethanat e rastit konkret dhe konkludohet se personi nën hetim është përdorues lëndësh narkotike dhe sasia është e vogël. Për të mbështetur qëndrimin, vendimi sjell raste të praktikës gjyqësore ku dozë e vogël dhe për përdorim vetjak janë konsideruar: 4.47 gram cannabis sativa, 4.839 gram cannabis sativa apo 1.995 gram heroinë.

Të gjitha vendimet penale themeli mbyllet me me caktimin dhe individualizimin e dënimit për secilën prej akuzave, bashkimin e dënimeve, uljen me një të tretën, disponimin mbi provat materiale dhe shpenzimet gjyqësore, si dhe të drejtën e ankimit. Siç konstatohet gjithashtu, gjyqtari i kushton rëndësi të veçantë analizës së rrethanave dhe fakteve konkrete të çështjes në raport me elementët ligjorë të identifikuar referuar analizës së ligjit të zbatueshëm, si dhe prapësimeve procedurale/materiale të ngritura nga pala e paditur, për të konkluduar më pas në mënyrë logjike mbi bazueshmërinë ose jo të kërimit të palëve.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar pas pjesës *rrethanat e faktit* vijon të integruara në vendim dhe *pretendimet e palëve*, duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në

përmbajtje të arsyetimit ligjor. Pretendimet e palëve gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsyetimit tërësor.

KONKLuzioni

Bazuar në sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarit në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri, mbështetet në interpretimin e ligjit të zbatueshëm si dhe pasurohet me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës që gjejnë aplikim në rastin konkret. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarit për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 392 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtarë,” Çështje penale

kundërvajtje” “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, “Seanca paraprake”, dhe “Kërkesa penale faza ekzekutimit”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se: Për vitin 2020, Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total **179 çështje** për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 65⁵³ jashtë këtij afati⁵⁴

Për vitin 2021, Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total **124 çështje** për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 39 jashtë këtij afati.

Për vitin 2022, Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total **89 çështje** për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 16 jashtë këtij afati.

Sa më sipër rezulton se gjyqtari ka gjykuar për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, në total 392 çështje për të cilat ligji ka parashikuar afate gjykimi, nga të cilat 120 jashtë këtij afati. Rrjedhimisht, Gjyqtari subjekt vlerësimi rezulton të ketë gjykuar 30.6 (tridhjetë presje gjashtë) % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se:

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Respektimi i afateve ligjore” në shkallë mbi mesataren (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “Sipas së dhënave të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, gjatë periudhës së vlerësimit, kam përfunduar 1482 çështje, nga të cilat 303 tej afatit ligjor ose tej standardit minimal kohor. Nga përlllogaritja aritmetike, konstatohet se, përqindja e çështjeve të përfunduara tej afatit është 20,45%. Ndaj, në pamje të parë do të duhet të kisha zgjedhur shkallën “Mbi mesataren”. Por, vlerësoj se, janë tri faktorë që nuk mund të lihen pa u vënë në dukje, me forcë. E para, periudha e vlerësimit përfshin edhe periudhat disamujore gjatë të cilave veprimtaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në vitin 2020, u pezullua, fillimisht për shkak të epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19, e mandej nga tërmeti i datës 26.11.2019. Gjithashtu, duhet shtuar që, periudha e vlerësimit përfshin edhe periudhën disamujore gjatë të cilës, avokatët bojkotuan pjesëmarrjen në seanca gjyqësore, e cila solli shpesh shtyrje të seancave, si dhe periudhën e tetorit 2020, ku si pasojë e një aksidenti automobilistik, kam qenë për disa javë, në raport shëndetësor, sipas ligjit. E dyta, në statistikat në lidhje me numrin e çështjeve të përfunduara, nuk janë përfshirë disa dhjetra vendime të cilat janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Konkretisht, nuk janë përfshirë vendimet në lidhje me kërkesat për zëvendësim apo caktim mase sigurimi personal, të paraqitura pasi ishte paraqitur kërkesa për dërgim të çështjes penale në gjyq, ashtu si dhe kërkimet për sigurim padie, e apo të për lëshim urdhri të menjëhershëm mbrojtje. Të gjitha këto vendimarrje, të realizuara brenda afatit ligjor, nuk janë evidentuar, për shkak të mos marrjes së një numri vendimi. Nëse do të ishin evidentuar, do të kishte ulje të përqindjes së çështjeve të

⁵³ 12 çështje janë regjistruar dhe/ose shqyrtuar në periudhën që kanë vepruar aktet nënligjore për kufizimin e veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19.

⁵⁴ Referuar tabelës nr. 10, rezulton se çështjet me nr. Rendor 11, 17, 26 me objekt “Përrjashtim gjyqtari” janë llogaritur si çështje me afat standart minimal kohor, ndërkohë sipas paragrafit të katër të nenit 22 të K.Pr.Penale “3. Gjykata, pasi merr të dhënat e nevojshme, vendos për kërkesën e përjashtimit brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës. » Për rrjedhojë, këto tri çështje do të llogariten si çështje me afat ligjor.

përfunduara tej afatit ligjor. E treta, gjatë periudhës së vlerësimit unë jam caktuar, me vendime të KLGJ-së, të shqyrtoj çështje gjyqësore edhe në plot gjashtë gjykata të tjera, konkretisht në gjykatat e rretheve gjyqësore Krujë, Lezhë, Mat, Dibër, Tiranë dhe Durrës. Përfundimi i këtyre çështjeve është kryer në afat (aktualisht kam në shqyrtim çështje në gjykatat e rretheve gjyqësore Lezhë, Dibër dhe Tiranë), fakt që nuk rezulton i pasqyruar në të dhënat e marra në shqyrtim. Nëse do të ishin evidentuar të gjitha rrethanat si më lart, padiskutim që përqindja e çështjeve të shqyrtuara tej afatit ligjor, ose tej standardit minimal kohor, do të rezultonte shumë e ulët."

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: "*Gjyqtari ka treguar aftësi për respektimin e afateve të parashikuara nga ligji brenda të cilave duhet të përfundojë gjykimi i çështjeve. Në këtë aspekt duhet të konsiderohet ngarkesa e lartë me çështje, delegimet e shumta dhe pezullimi i veprimtarisë gjyqësore, për shkak të pandemisë, tërmetit dhe bojkotimit të seancave gjyqësore nga avokatët."*

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat nga burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 120 çështjet e shqyrtuara jashtë afateve ligjore, rezulton se nga ky numër duhet të zbresim konkretisht çështjet e me poshtme për të cilat rezulton se:

- Në tabelën nr.1, çështja me nr. rendor 18, me objekt "*Kundërshtim veprimi përmbarrimor*", e cila është gjykuar në afatin 21 ditë, konsiderohet e përfunduar brënda afatit ligjor referuar nenit 610 të K.Pr.Civile në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezulton afati ligjor 20 ditë, pasi kemi tejkalim të papërfillshëm 1 ditë nga ky afat.
- Në tabelën nr. 3, çështja me nr. rendor 16⁵⁵, me objekt "*Lëshim urdhëri i menjëhershëm mbrojtje*", e cila është gjykuar në afatin 56 ditë, çështja me nr. rendor 17⁵⁶, e cila është gjykuar në afatin 46 ditë, çështja me nr. rendor 18⁵⁷, me objekt "*Lëshim urdhëri i menjëhershëm mbrojtje*", e cila është gjykuar në afatin 46 ditë, të rregjistruara përkatësisht me datë 02.03.2020; 12.03.2020; 12.03.2020 dhe kanë përfunduar me datë 28.04.2020, ndërkohë që neni 20 të Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 "*Për masat ndaj dhunës në marrëdhënie familjare*", ka parashikuar afatin ligjor 20 ditë. Duke marrë parasysh ditët e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të periudhës së pandemisë COVID 2019 me vendim të KLGJ-së nga data 10.03.2020-22.04.2020, pavarsisht se sipas aktit normativ nr. 9 datë 25.03.2020, çështjet e kësaj natyre përjashtoheshin nga pezullimi, por gjithmonë nëse gjykata vlerëson se shqyrtimi i vonuar i tyre mund të shkaktojë dëm të rëndë e të pariparueshëm për palët, e percaktuar kjo në nenin 3 pika 3 gërma b. Për shkak të kësaj gjendje siç dihet kanë qënë kushte shumë të veshtira që secili që përfshihet në këtë proces të bëjë rolin e tij në këto kushte, duke filluar që nga gjyqtari, palët ndergjyqëse dhe stafi administrativ i gjykatës, atëherë këto çështje konsiderohen të përfunduar brënda afatit ligjor të parashikuar.

⁵⁵ Çështja është regjistruar në datën 02.03.2020 dhe është marrë vendimi në datën 28.04.2020 që përkon me periudhën kur veprimtaria gjyqësore ka qënë e kufizuar për shkak të pandemisë së COVID 19.

⁵⁶ Çështja është regjistruar në datën 12.03.2020 dhe është marrë vendimi në datën 28.04.2020 që përkon me periudhën kur veprimtaria gjyqësore ka qënë e kufizuar për shkak të pandemisë së COVID 19.

⁵⁷ Çështja është regjistruar në datën 12.03.2020 dhe është marrë vendimi në datën 28.04.2020 që përkon me periudhën kur veprimtaria gjyqësore ka qënë e kufizuar për shkak të pandemisë së COVID 19.

- Në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 4, 34, me objekt “*Caktim mase sigurimi*”, e cila është gjykuar në afatin 3 ditë, ndërkohë që referuar nenit 244 e vijues të K.Pr.Penale në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezulton afati ligjor 48 orë. Kjo çështje është regjistruar me datë 07.02.2020, është shortuar pranë gjyqtarit me datë 10.02.2020 dhe ka perfunduar me datë 11.02.2020 duke përlloritur kohëzgjatjen e shqyrtimit të kësaj çështje nga data e shortimit tek gjyqtari dhe deri në datën e përfundimit rezulton se çështja është shqyrtuar brenda 24 orëve pra brenda afatit ligjor të parashikuar, gjithashtu i njëjti arsyetim si më sipër është dhe për çështjen me nr. rendor 34 e cila gjithashtu rezulton e shqyrtuar brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni nenit 244 e vijues të K.Pr.Penale në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezulton afati ligjor 48 orë.
- Në tabelën nr. 10 çështja me nr. rendor 54, 55, me objekt “*Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit*”, te cilat janë gjykuar brenda nje afati prej 1 muaj e 4 ditë, ndërkohë që neni 291 i Kodit ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë. Duke qene se nga afati ligjor i parashikuar është me tejkalim nga 4 ditë, një tejkalim i papërfillshëm, duke konsideruar të përfunduara brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji
- Në tabelën me nr. 11, çështja me nr. rendor 4, 6, 7, 8 me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, te cilat janë gjykuar përkatësisht secila në afatin 1 muaj e 2 ditë, dhe çështja me nr. rendor 7 e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 5 ditë (nëse zbresim ditet nga data e rregjistrimit deri në datën e shortimit të çështjes pranë gjyqtarit, 7 ditë) nr. rendor 60, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 4 ditë, çështja me nr. rendor 61, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 4 ditë, çështja me nr. rendor 65, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 2 ditë, çështja me nr. rendor 71, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 2 ditë, çështja me nr. rendor 118, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 3 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë. Duke qënë se afati ligjor i parashikuar është me tejkalim nga 2 deri në 5 ditë, një tejkalim i papërfillshëm, duke konsideruar të përfunduara brenda afatit të parashikuar nga ligji.
- Në tabelën nr. 11 çështja me nr. rendor 12, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 8 ditë, çështja me nr. rendor 13, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 8 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë. Nëse nga kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjeve te sipercituara do zbresim periudhën e mbartjes se dosjeve në fundvit (gjithsej 6 ditë), atëherë këto çështje kanë përfunduar brenda afatit ligjor të parashikuar me tejkalim të papërfillshëm prej 2 ditësh.
- Në tabelën nr. 11 çështja me nr. rendor 28⁵⁸, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 2 muaj e 12 ditë, ndërkohë që

⁵⁸ Çështja është regjistruar në datën 06.03.2020 dhe është marrë vendimi në datën 28.05.2020 që përkon me periudhën kur veprimtaria gjyqësore ka qenë e kufizuar për shkak të pandemisë së COVID 19.

paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë. Kjo çështje ka perfunduar brënda afatit ligjor të parashikuar pasi nga përlllogaritja janë zbritur, 43 ditë të pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të periudhës së pandemisë COVID 2019 me vendim të KLGJ-se nga data 10.03.2020-22.04.2020.

- Në tabelën nr. 11 çështja me nr. rendor 136⁵⁹, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 13 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë. Nëse nga përlllogaritja zbrësim 7 ditët nga momenti i regjistrimit deri në momentin e shortimit, atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda 1 muaji e 5 ditëve, e cila konsiderohet me një tejkalim të papërfillshëm prej 5 ditësh duke e konsideruar të përfunduar brënda afati ligjor të parashikuar nga paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë.
- Në tabelën nr. 12 çështja me nr. rendor 11, 17, me objekt “*Përrjashtim gjyqtari*”, të cilat janë gjykuar në afatin 3 ditë, ndërkohë që paragrafi 4 i nenit 22 i K.Pr.Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 48 orë. Duke e konsideruar në tejkalim i papërfillshëm atëherë këto dy çështje konsiderohen të përfunduara brënda afatit ligjorë.

Për vitin 2021

- Në tabelën nr. 2, çështja me nr. rendor 78, me objekt “*Kërkesë për ndihmë juridike falas*”, e cila është gjykuar në afatin 6 ditë, ndërkohë që shkronja “a” paragrafi i dytë i nenit 22 të Ligjit nr. 111/2017 “*Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti*”, ka parashikuar afatin ligjor 5 ditë. Duke e konsideruar 1 ditë një tejkalim i papërfillshëm atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatit ligjor.
- Në tabelën nr. 11, çështja me nr. 37, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 1 ditë, çështja me nr. rendor 29, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 4 ditë, çështja me nr. rendor 30, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 6 ditë, çështja me nr. rendor 32, me objekt “*Kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq*”, e cila është gjykuar në afatin 1 muaj e 1 ditë, ndërkohë që paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale, në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse ka parashikuar afatin ligjor 30 ditë. Duke konsideruar 1-6 ditë një tejkalim i papërfillshëm për këto çështje atëherë do konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor të parashikuar nga paragrafi 3 i nenit 332 i K. Pr. Penale,

Për vitin 2022

- Në tabelën nr. 10, çështja me nr. rendor 62, me objekt “*Zëvendësim mase sigurimi*”, e cila është gjykuar në afatin 6 ditë, ndërkohë që referuar paragrafit 4 të nenit 260 të K.Pr.Penale në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës përkatëse, rezulton afati ligjor 5 ditë, pra 1 ditë, një tejkalim i papërfillshëm, duke konsideruar të përfunduar brenda afatit ligjor të parashikuar nga ligji.

⁵⁹ Çështja është regjistruar në datën 06.10.2020 dhe është shortuar në datën 13.10.2020

Duke përjashtuar çështjet në të cilat afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (*1 deri në 2, 3 apo në një rast 7 ditë*), si dhe çështjet në të cilat vonesa në shqyrtim ka ardhur edhe si pasojë e arsyeve të lartpërmendura, numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit rezultojnë të jetë 93 çështje. Për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (93 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (392 çështje), rezultojnë të jetë *23.7 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor*. Kjo përqindje e çështjeve jashtë afatit ligjor, sipas Metodologjisë pikëzohet me 9 pikë.

Në Metodologji, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjitha burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: *kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit*. Në rastin konkret, rezultojnë se (i) gjyqtari ka gjykuar një numër tepër të lartë çështjesh konkretisht 1488 çështje penale dhe civile gjithsej 392 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi çka përben 26.3% të çështjeve në total gjithashtu kompleksitetit i çështjeve problematikat në lidhje me njoftimin palëve.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Duke iu referuar analizës matematikore e logjike të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të analizuar më sipër si dhe duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësohet se për këtë tregues, gjyqtari {...} duhet të pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përket përqindjes prej 22.7% të çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit dhe që në rastin konkret përkon me 9 pikë. Duhet patur parasysh edhe fakti se pikërisht viti në të cilin gjyqtari ka numrin më të madh të çështjeve për të cilat ligji parashikon afati ligjore (179) gjithashtu dhe numrin më të madh të çështjeve gjykuara jashtë afati ligjorë përkon me periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të periudhës së pandemisë COVID 2019, me vendim të KLGJ-se nga data 10.03.2020-22.04.2020. Për pikëzimin e këtij treguesi, vlerësuesi bazohet në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, përballë detyrueshmërisë ligjore që një kategori çështjesh duhet të shqyrtohen brenda afateve të përcaktuara. Duke iu referuar gjithashtu numrit të madh të çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari gjithsej 1488 çështje për gjithë periudhën e vlerësimit, numri i çështjeve të shqyrtuara tej afatit ligjor përben vetëm 6.2 % të çështjeve në total të përfunduara nga gjyqtari, vlerësohet se gjyqtari {...} duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet se është në shkallën 0-10% dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, 01.01.2020-31.12.2022, gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 1093 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat ne total 239 jashtë këtij afati. Rrjedhimisht, gjyqtari subjekt vlerësimi rezulton të ketë gjykuar 21.86% të çështjeve jashtë afatit standard minimal kohor në fuqi.

Sipas kategorive ai ka gjykuar: Për vitin 2020, ka gjykuar në total 24 çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme me palë kundërshtare”*⁶⁰, 72 çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”*, 77 çështje të kategorisë *“familjare me palë kundërshtare”*, 21 çështje të kategorisë *“familjare pa palë kundërshtare”*, 0 çështje të kategorisë *“tregtare me palë kundërshtare”*, 0 çështje të kategorisë *“tregtare pa palë kundërshtare”*, 2 çështje të kategorisë *“marrëdhënie pune”*, 57 çështje të kategorisë *“krime”*, 7 çështje të kategorisë *“kundravajtje”*, 0 çështje të kategorisë *“kërkesa penale të hetimit paraprak”*, 69 çështje të kategorisë *“seancë paraprake”*, si dhe 22 çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”*. Për vitin 2021, ka gjykuar në total 42 çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme me palë kundërshtare”*⁶¹, 112 çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”*, 102 çështje të kategorisë *“familjare me palë kundërshtare”*, 10 çështje të kategorisë *“familjare pa palë kundërshtare”*, 0 çështje të kategorisë *“tregtare me palë kundërshtare”*, 0 çështje të kategorisë *“tregtare pa palë kundërshtare”*, 5 çështje të kategorisë *“marrëdhënie pune”*, 72 çështje të kategorisë *“krime”*, 8 çështje të kategorisë *“kundravajtje”*, 1 çështje të kategorisë *“kërkesa penale të hetimit paraprak”*, 50 çështje të kategorisë *“seancë paraprake”*, si dhe 17 çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”*. Për vitin 2022, ka gjykuar në total 31 çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme me palë kundërshtare”*⁶², 51 çështje të kategorisë *“civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”*, 93 çështje të kategorisë *“familjare me palë kundërshtare”*, 13 çështje të kategorisë *“familjare pa palë kundërshtare”*, 0 çështje të kategorisë *“tregtare me palë kundërshtare”*, 0 çështje të kategorisë *“tregtare pa palë kundërshtare”*, 3 çështje të kategorisë *“marrëdhënie pune”*, 68 çështje të kategorisë *“krime”*, 6 çështje të kategorisë *“kundravajtje”*, 0 çështje të kategorisë *“kërkesa penale të hetimit paraprak”*, 50 çështje të kategorisë *“seancë paraprake”*, si dhe 8 çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”*.

Për kategoritë e mësipërme vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj për gjykimet familjare;

⁶⁰ Në këtë përlllogaritje, është mbajtur parasysh se çështjet me objekt *“Kundërshtim/pezullim veprimesh përmbartimore”* referuar nenit 610 të K. Pr. Civile, i cili ka parashikuar afatin ligjor 20 ditë, kategorizohen në çështje me afat ligjor gjykimi, pavarësisht shënimit në tabelë.

⁶¹ Në këtë përlllogaritje, është mbajtur parasysh se çështjet me objekt *“Kundërshtim/pezullim veprimesh përmbartimore”* referuar nenit 610 të K. Pr. Civile, i cili ka parashikuar afatin ligjor 20 ditë, kategorizohen në çështje me afat ligjor gjykimi, pavarësisht shënimit në tabelë.

⁶² Në këtë përlllogaritje, është mbajtur parasysh se çështjet me objekt *“Kundërshtim/pezullim veprimesh përmbartimore”* referuar nenit 610 të K. Pr. Civile, i cili ka parashikuar afatin ligjor 20 ditë, kategorizohen në çështje me afat ligjor gjykimi, pavarësisht shënimit në tabelë.

- jo më tej se 9 muaj për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit dhe të pasqyruara në raportin analitik, ka bërë prezent një sërë shkaqesh të cilat kanë ndikuar në kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve të cilat lidhen me rrethanat objektive në funksion të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor. Gjyqtari në mënyrë të detajuar se: *“Plotësimi i standardeve minimale kohore”* në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Konkretisht, subjekti i vlerësimit është shprehur si vijon: *“Sipas së dhënave të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, gjatë periudhës së vlerësimit, kam përfunduar 1482 çështje, nga të cilat 303 tej afatit ligjor ose tej standardit minimal kohor. Nga përlllogaritja aritmetike, konstatohet se, përqindja e çështjeve të përfunduara tej afatit është 20,45%. Ndaj, në pamje të parë do të duhet të kisha zgjedhur shkallën “Mbi mesataren”. Por, vlerësoj se, janë tri faktorë që nuk mund të lihen pa u vënë në dukje, me forcë. E para, periudha e vlerësimit përfshin edhe periudhat disamujore gjatë të cilave veprimtaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në vitin 2020, u pezullua, fillimisht për shkak të epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19, e mandej nga tërmeti i datës 26.11.2019. Gjithashtu, duhet shtuar që, periudha e vlerësimit përfshin edhe periudhën disamujore gjatë të cilës, avokatët bojkotuan pjesëmarrjen në seanca gjyqësore, e cila solli shpesh shtyrje të seancave, si dhe periudhën e tetorit 2020, ku si pasojë e një aksidenti automobilistik, kam qenë për disa javë, në raport shëndetësor, sipas ligjit. E dyta, në statistikat në lidhje me numrin e çështjeve të përfunduara, nuk janë përfshirë disa dhjetra vendime të cilat janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Konkretisht, nuk janë përfshirë vendimet në lidhje me kërkesat për zëvendësim apo caktim mase sigurimi personal, të paraqitura pasi ishte paraqitur kërkesa për dërgim të çështjes penale në gjyq, ashtu si dhe kërkimet për sigurim padie, e apo të për lëshim urdhri të menjëhershëm mbrojtje. Të gjitha këto vendimarrje, të realizuara brenda afatit ligjor, nuk janë evidentuar, për shkak të mos marrjes së një numri vendimi. Nëse do të ishin evidentuar, do të kishte ulje të përqindjes së çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor. E treta, gjatë periudhës së vlerësimit unë jam caktuar, me vendime të KLGJ-së, të shqyrtoj çështje gjyqësore edhe në plot gjashtë gjykata të tjera, konkretisht në gjykatat e rretheve gjyqësore Krujë, Lezhë, Mat, Dibër, Tiranë dhe Durrës. Përfundimi i këtyre çështjeve është kryer në afat (aktualisht kam në shqyrtim çështje në gjykatat e rretheve gjyqësore Lezhë, Dibër dhe Tiranë), fakt që nuk rezultoi i pasqyruar në të dhënat e marra në shqyrtim. Nëse do të ishin evidentuar të gjitha rrethanat si më lart, padiskutim që përqindja e çështjeve të shqyrtuara tej afatit ligjor, ose tej standardit minimal kohor, do të rezultonte shumë e ulët.”*

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: *“Duke patur parasysh ngarkesën shumë të lartë në punë, gjyqtari ka treguar aftësi për të respektuar afatet orientuese.”*

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 1093 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezultoi se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtari muaj gusht i vitit 2020, ka ndikuar gjithashtu edhe periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr. 127, datë 10.03.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve

gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr. 128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020.

Nëse në përlllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshiheshin periudhat e sipërcituara pushimet vjetore (35 ditë) dhe ditët e pezullimi i veprimtarisë gjyqësore (43 ditë) , festat e fundvitit dhe mbartja e dosjeve (6 ditë) atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor, konkretisht:

Për vitin 2020, Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 351 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat 104 çështje jashtë këtij afati. Nëse marrim parasysh sa më lart u citua, rezulton të jenë gjykuar brenda afatit standard minimal kohor çështjet si më poshtë vijon:

- Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 7, 8, 13, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin: 7 muaj e 15 ditë, 7 muaj e 12 ditë, 6 muaj e 18 ditë, ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj. Për keto çështje nëse zbresim periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr. 127, datë 10.03.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr. 128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020 (gjithsej 43 ditë) atëherë këto çështje do ishin gjykuar përkatësisht në afatin 182 ditë, 182 ditë, 181 ditë, 120 ditë me tejkalim të papërfillshëm prej 1-2 ditësh.
- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 26, 31, 36, 38, 39, 41, 44, 47, 48, 52, 55, 62, 63, 64, 65, 72, 78, 79 të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatet: 4 muaj e 19 ditë, 4 muaj e 17 ditë, 4 muaj e 23 ditë, 4 muaj e 27 ditë, 4 muaj e 13 ditë, 4 muaj e 15 ditë, 5 muaj e 7 ditë, 4 muaj e 28 ditë, 5 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 1 ditë, 4 muaj 11 ditë, 4 muaj e 17 ditë, 4 muaj e 18 ditë, 4 muaj e 13 ditë, 4 muaj e 7 ditë, 5 muaj e 12 ditë, 4 muaj e 7 ditë. Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Për këto çështje nëse zbresim periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr. 127, datë 10.03.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr. 128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së

shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020 (*gjithsej 43 ditë*) si dhe periudhen e pushimeve vjetore për gjyqësore (35 ditë) për disa nga çështjet e sipërcituara atëherë këto çështje do kishin përfunduar brenda afatit standard minimal 4 muaj përkatësisht, për 91 ditë, 89 ditë, 94 ditë, 99 ditë, 85 ditë, 87 ditë, 107 ditë, 100 ditë, 107 ditë, 96 ditë, 102 ditë, 103 ditë, 98 ditë, 92 ditë, 127 ditë, 90 ditë, 92 ditë.

- Në tabelën nr. 4, çështjet me nr. rendor 6, 7, 10, 17, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 4 muaj e 19 ditë, 4 muaj e 19 ditë, 4 muaj e 15 ditë, 6 muaj, 4 muaj e 13 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Për këto çështje nese zbresim periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr. 127, datë 10.03.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020 (*gjithsej 43 ditë*) si dhe periudhen e lejes vjetore 35 ditë për çështjen me nr. rendor 10, atëherë këto çështje do kishin përfunduar brenda afatit standard minimal 4 muaj përkatësisht, për 101 ditë, 101 ditë, 92 ditë, 97 ditë, 98 ditë, 102 ditë.
- Në tabelën nr. 9, çështjet me nr. rendor 4, 5 të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 5 muaj e 9 ditë, 5 muaj e 2 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Për këto çështje nese zbresim periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr. 127, datë 10.03.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020 (*gjithsej 43 ditë*) atëherë këto çështje do kishin përfunduar brenda afatit standard minimal 4 muaj përkatësisht, për 120 ditë, 117 ditë.
- Në tabelën nr. 11⁶³, çështjet me nr. rendor 30, 31, 32, 33, 34, 95⁶⁴, 97⁶⁵, 98⁶⁶, 100⁶⁷, 139, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin: 3 muaj e 4 ditë, 3 muaj e 4

⁶³ Në tabelën nr. 11 janë përcaktuar si çështje me afat ligjor, çështja me nr. Rendor 5 dhe 133 me objekt: “Pushim procedimi”, të cilat sipas Vendimit nr. 261/2 të KLD përbëjnë çështje me afat standard minimal dhe në rastin konkret janë shqyrtuar brenda afatit 2 muaj dhe si të tilla do të përllogariten në kolonën përkatëse. I njëjti rregull do të aplikohet edhe në çështjen me nr. Rendor 25. Çështjet me nr. Rendor 26, 28, 40, 41,43, 44, 45, janë çështje me afat ligjor dhe si të tilla nuk do të llogariten, sikurse janë përcaktuar në kolonën e “Standard minimal kohor”, por në çështjet me afat ligjor.

⁶⁴ Për këtë çështje është zbritur 35 ditë të lejes vjetore për gjyqësorin

⁶⁵ Për këtë çështje është zbritur 35 ditë të lejes vjetore për gjyqësorin

⁶⁶ Për këtë çështje është zbritur 35 ditë të lejes vjetore për gjyqësorin

⁶⁷ Për këtë çështje është zbritur 35 ditë të lejes vjetore për gjyqësorin

ditë, 3 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 16 ditë, 2 muaj e 16 ditë, 3 muaj e 18 ditë, 4 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 2 ditë, 3 muaj e 7 ditë, 3 muaj e 7 ditë, 2 muaj e 23 ditë, dhe 2 muaj e 5 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Për këto çështje nese zbresim periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr. 127, datë 10.03.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020 (*gjithsej 43 ditë*) atëherë këto çështje do kishin përfunduar brenda afatit standard minimal afatin standard minimal 2 muaj dhe pse ndonjëra nga çështjet me tejkalim të paperfillshem prej 2-5 ditë, përkatesisht 46 ditë, 46 ditë, 46 ditë, 28 ditë, 28 ditë, 27 ditë, 62 ditë, 62 ditë, 48 ditë, 65 ditë.

- Në tabelën nr. 12⁶⁸, çështjet me nr. rendor 4, 18, 19, të cilat janë gjykuar përkatesisht në afatin, 2 muaj e 5 ditë, 3 muaj e 24 ditë, 5 muaj e 17 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Për këtë çështje nese zbresim periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr.127, datë 10.03.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020 (*gjithsej 43 ditë*) atëherë këto çështje do të kishin përfunduar brenda afatit standard minimal afatin standard minimal 2 muaj, konkretisht për 22 ditë.

Për vitin 2021, Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 419 çështje për të cilat janë parashikuar

afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat 71 çështje jashtë këtij afati.

Nëse marrim

parasysh sa më lart u citua, rezulton të jenë gjykuar brenda afatit standard minimal kohor çështjet si

më poshtë vijon:

- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 58, 89, 94, 108, 115, të cilat janë gjykuar përkatesisht në afatet: 4 muaj e 6 ditë, 5 muaj e 2 ditë, 4 muaj e 24 ditë, 5 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 18 ditë. Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë

⁶⁸ Në tabelën nr. 12 janë përcaktuar si çështje me afat orientues standard minimal kërkesat për përjashtim gjyqtari me nr. Rendor 11, 17, 26, por sipas nenit 22 të K.Pr.Penale janë kërkesa me afat ligjor, për rrjedhojë do të përlloragiten si çështje me afat ligjor dhe do të zbriten nga kolona “Standard minimal kohor”.

14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Për këtë çështje nëse zbresim periudhaen e lejes vjetore për gjyqësorin gjithsej 35 ditë atëherë këto çështje do kishin përfunduar brënda afatit standard minimal afatin standard minimal 4 muaj, konkretisht per 126 ditë një tejkallim i papërfillshem prej 6 ditësh, 117 ditë, 109 ditë, 120 ditë, 103 ditë.

- Në tabelën nr. 4, çështjet me nr. rendor 1, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 5 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Duke qenese kjo ceshtje ka përfunduar per 125 ditë nje tejkallim i paperfillshem prej 5 ditësh atëherë konsiderohet e përfunduar brenda afatit standart prej 2 muajsh.
- Në tabelën nr. 9, çështjet me nr. rendor 3, e gjykuar në afatin 4 muaj e 6 ditë. Ndërkohë, pika 5/a e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Duke qenese kjo çështje ka përfunduar per 126 ditë, një tejkallim i papërfillshëm prej 6 ditësh atëherë konsiderohet e përfunduar brenda afatit standart prej 4 muajsh.
- Në tabelën nr. 11⁶⁹, çështjet me nr. rendor 8, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin: 2 muaj e 17 ditë, 2 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 28 ditë, 2 muaj e 24 ditë, 5 muaj e 14 ditë, 2 muaj e 22 ditë, 2 muaj e 24 ditë dhe 2 muaj e 24 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj.
- Në tabelën nr. 12⁷⁰, çështjet me nr. rendor 13, si dhe çështja me nr. rendor 80 në tabelën nr. 11, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 6 ditë, dhe 2 muaj e 19 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Duke qenese kjo çështje ka perfunduar per 126 ditë, një tejkallim i paperfillshem prej 6 ditësh atëherë konsiderohet e përfunduar brenda afatit standart prej 4 muajsh. Ndërsa për çështjen me nr. rendor 80 nese zbresim periudhen e lejes vjetore për gjyqësorin prej 35 ditesh atëherë çështja ka përfunduar per 44 ditë, brënda afatit standart të parashikuar nga pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së.

Për vitin 2022, Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 323 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal kohor, nga të cilat 64 çështje jashtë këtij afati. Nese marrim parasysh sa më lart u citua, rezulton të jenë gjykuar brënda afatit standard minimal kohor çështjet si më poshtë vijon:

- Në tabelën nr. 1, çështjet me nr. rendor 32, e gjykuar në afatin 7 muaj e 12 ditë. Ndërkohë, pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 6 muaj. Por duke zbritur lejen vjetore për gjyqësorin prej 35 ditësh atëherë kjo çështje ka përfunduar për 187 ditësh, me një tejkallim të papërfillshem 7 ditë duke e konsideruar të përfunduar brënda afatit

⁶⁹ Në tabelën nr. 11 janë përcaktuar si çështje me orientues standard minimal çështjet me nr. Rendor 19 dhe 27 me objekt "Dërgim i çështjes në gjyq", ndërkohë që këto janë çështje me afat ligjor dhe për rrjedhojë do të përlllogariten në rubrikën e duhur të Raportit analitik. Po në tabelën nr. 11, çështja me nr. Rendor 80 me objekt "Dhënie amnistie" do të përlllogaritet në tabelën nr. 12 "Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë", pasi është vendosur gabimisht në këtë tabelë.

⁷⁰ Në tabelën nr. 12 janë përcaktuar si çështje me afat orientues standard minimal kërkesat për përjashtim gjyqtari me nr. Rendor 11, 17, 26, por sipas nenit 22 të K.Pr.Penale janë kërkesa me afat ligjor, për rrjedhojë do të përlllogariten si çështje me afat ligjor dhe do të zbriten nga kolona "Standard minimal kohor".

standart te parashikuar nga pika 5/e e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së .

- Në tabelën nr. 3, çështjet me nr. rendor 1, 5, 7, 14, 15, 20, 23, 40, 45, 51, 74, 76, 78, 84, 102 të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatet: 4 muaj e 9 ditë, 4 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 11 ditë, 4 muaj e 12 ditë, 4 muaj e 10 ditë, 4 muaj e 10 ditë. 4 muaj e 5 ditë, 4 muaj e 15 ditë, 4 muaj e 3 ditë, 4 muaj e 6 ditë, 4 muaj e 7 ditë, 4 muaj e 14 ditë, 5 muaj e 7 ditë, 5 muaj e 3 ditë, 5 muaj e 8 ditë, 5 muaj e 1 ditë, dhe 5 muaj e 12 ditë. Ndërkohë, pika 5/d e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 4 muaj. Por duke zbritur 6 dite per festat e fundviti dhe mbartjes së dosjeve, si dhe lejen vjetore për gjyqësorin prej 35 ditësh për secilën prej çështjeve, atëherë këto çështje do kishin përfunduar brënda afatit standard minimal 4 muaj, përkatësisht për 123 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 3 ditësh*), 119 ditë, 125 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 5 ditësh*), 126 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 6 ditësh*), 124 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 4 ditësh*), 125 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 5 ditësh*), 124 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 4 ditësh*), 119 ditë, 123 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 3 ditësh*), 122 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 2 ditësh*), 120 ditë, 120 ditë, 121 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 1 ditë*), 99 ditë, 122 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 2 ditësh*), 120 ditë, 123 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 3 ditësh*), 116 ditë, 127 ditë (*tejkalim i paperfillshëm prej 7 ditësh*).
- Në tabelën nr. 4, çështjet me nr. rendor 12 dhe 13, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj e 16 ditë dhe 2 muaj e 15 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Duke zbritur 6 ditë (*llogaritur për festat e fundviti dhe mbartjet e dosjeve nëpër gjykata*), si dhe lejen vjetore per gjyqësorin prej 35 ditësh për secilën prej çështjeve, atëherë këto çështje do kishin përfunduar brenda afatit standard minimal 2 muaj, përkatësisht për 41 dhe 40 ditë.
- Në tabelën nr. 12, çështjet me nr. rendor 7, e gjykuar në afatin 2 muaj e 25 ditë. Ndërkohë, pika 5/j e aneksit 1 të vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së, ka parashikuar afatin standard minimal 2 muaj. Por duke zbritur lejen vjetore për gjyqësorin prej 35 ditësh atëherë kjo çështje do kishte përfunduar brënda afatit standard minimal 2 muaj, konkretisht për 50 ditë.

Nëse në përlllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, do të përjashtoheshin çështjet e analizuar më sipër, atëherë do të rezultonte se nga 1093 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 170 prej tyre ose 15.5 % janë gjykuar jashtë standardit minimal kohor në fuqi. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe analizës matematikore e logjike të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit të analizuar më sipër si dhe duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit siç kanë qënë periudha e pandemisë periudhe në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qënë e pezulluar, vlerësohet se për këtë tregues, gjyqtari duhet të pikëzohet me nivel më të lartë pikëzimi se ai që i përkon përqindjes së sipërcituar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, numrit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, në

raport me numrin total të çështjeve të gjykuara, tejkalimit të standardit minimal kohor në disa prej çështjeve të analizuara (*tejkalime nga 1, 3 ditë deri në 7 ditë*) sipas të dhënave statistikore, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari vlerësohet një shkallë më lart se 4 pikë, dhe pikëzohet në këtë mënyrë maksimalisht

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet në nivelin “Mbi 0-10%”, pikëzohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Në analizë tërësore të të dhënave statistikore për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, rezulton se gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total:

Për vitin 2020, Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 24 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”⁷¹, 72 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, 77 çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, 21 çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, 0 çështje të kategorisë “*tregtare me palë kundërshtare*”, 0 çështje të kategorisë “*tregtare pa palë kundërshtare*”, 2 çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, 57 çështje të kategorisë “*krime*”, 7 çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, 0 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, 69 çështje të kategorisë “*seancë paraprake*”, si dhe 22 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”.

Për vitin 2021, Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 42 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”⁷², 112 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, 102 çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, 10 çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, 0 çështje të kategorisë “*tregtare me palë kundërshtare*”, 0 çështje të kategorisë “*tregtare pa palë kundërshtare*”, 5 çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, 72 çështje të kategorisë “*krime*”, 8 çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, 1 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, 50 çështje të kategorisë “*seancë paraprake*”, si dhe 17 çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”.

Për vitin 2022, Gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 31 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”⁷³, 51 çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, 93 çështje të kategorisë “*familjare me palë*

⁷¹ Në këtë përlllogaritje, është mbajtur parasysh se çështjet me objekt “*Kundërshtim/pezullim veprimesh përmbartimore*” referuar nenit 610 të K. Pr. Civile, i cili ka parashikuar afatin ligjor 20 ditë, kategorizohen në çështje me afat ligjor gjykimi, pavarësisht shënimit në tabelë.

⁷² Në këtë përlllogaritje, është mbajtur parasysh se çështjet me objekt “*Kundërshtim/pezullim veprimesh përmbartimore*” referuar nenit 610 të K. Pr. Civile, i cili ka parashikuar afatin ligjor 20 ditë, kategorizohen në çështje me afat ligjor gjykimi, pavarësisht shënimit në tabelë.

⁷³ Në këtë përlllogaritje, është mbajtur parasysh se çështjet me objekt “*Kundërshtim/pezullim veprimesh përmbartimore*” referuar nenit 610 të K. Pr. Civile, i cili ka parashikuar afatin ligjor 20 ditë, kategorizohen në çështje me afat ligjor gjykimi, pavarësisht shënimit në tabelë.

kundërshtare”, 13 çështje të kategorisë *“familjare pa palë kundërshtare*”, 0 çështje të kategorisë *“tregtare me palë kundërshtare*”, 0 çështje të kategorisë *“tregtare pa palë kundërshtare*”, 3 çështje të kategorisë *“marrëdhënie pune*”, 68 çështje të kategorisë *“krime*”, 6 çështje të kategorisë *“kundravajtje*”, 0 çështje të kategorisë *“kërkesa penale të hetimit paraprak*”, 50 çështje të kategorisë *“seancë paraprake*”, si dhe 8 çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”.

Referuar raportit analitik rezultojnë si më poshtë:

1. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **220.8** ditë, **pra më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
2. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **52.7** ditë, **pra më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
3. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **101.8** ditë, **pra më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej katër muajsh.
4. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **66** ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh. Por duke qenë se ky tejkallim prej 6 ditësh është i papërfillshëm atëherë koha mesatare do të konsiderohet **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
5. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“marrëdhënie pune*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **170.8** ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej gjashtë muajsh.
6. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“krime*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **93.65** ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej nëntë dhe dymbëdhjetë muajsh.
7. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“kundravajtje*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **131.8** ditë, pra **më e gjatë se standardi** minimal kohor i miratuar prej katër muajsh.
8. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“kërkesa penale të hetimit paraprak*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **41** ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
9. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“seancë paraprake*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **50.3** ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.
10. Në lidhje me çështjet e kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezultojnë të jetë **63.2** ditë, pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh (60 ditë). Por duke qenë se ky tejkallim prej **3.2** ditësh është i papërfillshëm atëherë koha mesatare do të konsiderohet **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej dy muajsh.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: *“Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje”* në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Ky vetëvlerësim është argumentuar

si vijon: *“Pa dashur të bie në përsëritje, por shpjegimi i dhënë në dy treguesit e mësipërm, gjen zbatim, mutatis mutandis, edhe në lidhje me këtë tregues. Sipas së dhënave të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, gjatë periudhës së vlerësimit, kam përfunduar 1482 çështje, nga të cilat 303 tej afatit ligjor ose tej standardit minimal kohor. Nga përllogaritja aritmetike, konstatohet se, përqindja e çështjeve të përfunduara tej afatit është 20,45%. Ndaj, në pamje të parë do të duhet të kisha zgjedhur shkallën “Mbi mesataren”. Por, vlerësoj se, janë tri faktorë që nuk mund të lihen pa u vënë në dukje, me forcë. E para, periudha e vlerësimit përfshin edhe periudhat disamujore gjatë të cilave veprimtaria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në vitin 2020, u pezullua, fillimisht për shkak të epidemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19, e mandej nga tërmeti i datës 26.11.2019. Gjithashtu, duhet shtuar që, periudha e vlerësimit përfshin edhe periudhën disamujore gjatë të cilës, avokatët bojkotuan pjesëmarrjen në seanca gjyqësore, e cila solli shpesh shtyrje të seancave, si dhe periudhën e tetorit 2020, ku si pasojë e një aksidenti automobilistik, kam qenë për disa javë, në raport shëndetësor, sipas ligjit. E dyta, në statistikat në lidhje me numrin e çështjeve të përfunduara, nuk janë përfshirë disa dhjetra vendime të cilat janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Konkretisht, nuk janë përfshirë vendimet në lidhje me kërkesat për zëvendësim apo caktim mase sigurimi personal, të paraqitura pasi ishte paraqitur kërkesa për dërgim të çështjes penale në gjyq, ashtu si dhe kërkimet për sigurim padie, e apo të për lëshim urdhri të menjëhershëm mbrojtje. Të gjitha këto vendimarrje, të realizuara brenda afatit ligjor, nuk janë evidentuar, për shkak të mos marrjes së një numri vendimi. Nëse do të ishin evidentuar, do të kishte ulje të përqindjes së çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor. E treta, gjatë periudhës së vlerësimit unë jam caktuar, me vendime të KLGJ-së, të shqyrtoj çështje gjyqësore edhe në plot gjashtë gjykata të tjera, konkretisht në gjykatat e rretheve gjyqësore Krujë, Lezhë, Mat, Dibër, Tiranë dhe Durrës. Përfundimi i këtyre çështjeve është kryer në afat (aktualisht kam në shqyrtim çështje në gjykatat e rretheve gjyqësore Lezhë, Dibër dhe Tiranë), fakt që nuk rezulton i pasqyruar në të dhënat e marra në shqyrtim. Nëse do të ishin evidentuar të gjitha rrethanat si më lart, padiskutim që përqindja e çështjeve të shqyrtuara tej afatit ligjor, ose tej standardit minimal kohor, do të rezultonte shumë e ulët.”*

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: *"Duke patur parasysh ngarkesën në punë dhe faktorët e tjerë, gjyqtari ka treguar aftësi për të përfunduar çështjet në afat."*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar për shumicën e kategorive të çështjeve.

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit për këtë tregues parashikohet se: *“... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.* Gjyqtari ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm çështjes që sipas të dhënave statistikore në total janë shqyrtuar 1488 çështje. Ajo çfarë ka ndikuar realisht në kohën

mesatare të shqyrtimit të çështjeve ka ardhur për për shkaqe të përmendura dhe nga vetë gjyqtari në formularin vetëvlerësimit dhe të pavarura nga vetë ai, sic kanë qënë periudha e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore për shkak të COVID 19 si dhe fakti që me vendime të KLGJ-së, gjyqtari është caktuar të shqyrtojë çështje gjyqësore në gjashtë gjykata të tjera, konkretisht në gjykatat e rretheve gjyqësore Krujë, Lezhë, Mat, Dibër, Tiranë dhe Durrës gjatë periudhës së vlerësimit 2020-2022. Gjithashtu duhet patur parasysh se çështjet civile të përgjithshme me palë kundërshtare, është një kategori për të cilën koha mesatare përgjithsisht rezulton më e gjatë se standarti i parashikuar për vetë natyrën komplekse të tyre dhe problematikave që shfaqin gjatë shqyrtimit. Të gjithë këto faktor në tërësi kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve.

KONKLUZIONI

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.⁷⁴ Referuar metodologjisë, duke qënë se nga 10 (dhjetë) kategori çështjesh, vetëm për 2 (dy) prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal kohor, vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje konsiderohet më e shkurtër ose barabartë me standardin për të gjitha kategoritë të çështjeve, dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2020-31.12.2022, Gjyqtari {...}) ka përfunduar 1488 çështje gjyqësore. Ndërkohë që i janë caktuar për gjykim 1611 të tilla. Rjedhimisht, rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore referuar raportit të numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve gjyqësore që i janë caktuar brenda një viti kalendarik, për gjyqtarin subjekt vlerësimi për periudhën 01.01.2020-31.12.2022 rezulton të jetë 92.36%, përqindje e cila sipas metodologjisë pikezohet me 6 pikë.

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se subjekti ka vlerësuar treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “Në vlerësim të numrit të çështjeve që më janë caktuar të shqyrtoj, e të numrit të atyre që kam përfunduar, vlerësoj se, treguesi është mbi mesataren. Shumë pak çështje janë mbartur

⁷⁴ Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se: “...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

nga një vit kalendarik, në tjetrin. Mbartja ka ndodhur përgjithësisht, në prani të të paktën njëres prej tri rrethanave vijuese. E para, kur çështjet kanë ardhur në muajt e fundit të vitit përkatës, duke pamundësuar përfundimin brenda vitit kalendarik. E dyta, kur seancat janë shtyrë me kërkesë të bazuar të palëve, ose për shkaqe të tjera ligjore (si mos marrja djeni, apo parashikimi i nenit 135, paragrafi i dytë, të Kodit të Familjes, lidhur me detyrimin e përsëritjes dy herë të njoftimit për palën e paditur, edhe kur merr djeni personalisht, në lidhje me seancën e pajtimit). E treta, kur çështjet kanë qenë të pezulluara me vendim të ndërmjetëm, e nuk kanë rënë shkaqet e pezullimit. Sa më lart, numri i lartë i çështjeve të përfunduara brenda vitit kalendarik, është tregues i rendimentit të lartë në organizimin e punës, nga ana ime."

Gjithashtu Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: "Gjyqtari ka treguar aftësi për përfundimin e çështjeve gjyqësore dhe në këtë kontekst duhet konsideruar ngarkesa e madhe me çështje, pezullimi i gjykimeve dhe faktorë të tjerë të parashtruar nga ana e gjyqtarit, që janë të ngjashme edhe për kolegët e tjetër të gjykatës, që kanë sjellë edhe mbartjen në vitin pasardhës."

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit "...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit viti kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli. Në këtë këndvështrim rezulton se gjyqtari {...} ka përfunduar gjatë periudhës së vlerësimit në total 1488 ose 496 vendimarrje gjatë një viti kalendarik. Sipas nga Aneksi 1 pika 3 germa g, parashikohet se; "Gjyqtari i shkallës së parë që nuk është i organizuar në seksione, si relator jo më pak se 200 çështje penale (krime kundravajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrveshje mes palëve kundërshtare". Nga të dhënat statistike gjyqtari rezulton se sipas viteve ka shqyrtuar si me poshtë:

- 1- Për vitin 2020 ka shqyrtuar në total 323 çështje me palë kundërshtare, me një rendiment 161 % pra 123 çështje më shumë se minimumi i përcaktuar nga Aneksi 1 pika 3 germa g,
- 2- Për vitin 2021 ka shqyrtuar në total 328 çështje me palë kundërshtare, me një rendiment 164 % pra 128 çështje më shumë se minimumi i përcaktuar nga Aneksi 1 pika 3 germa g duke tejkaluar .
- 3- Për vitin 2022 ka shqyrtuar në total 268 çështje me palë kundërshtare, me një rendiment 134%, pra 68 çështje më shumë se minimumi i përcaktuar nga Aneksi 1 pika 3 germa g.

Sa më sipër rezulton se gjyqtari ka shqyrtuar në total 919 çështje me palë kundërshtare, pra 319 çështje më shumë sec përcaktohet nga Aneksi 1 pika 3 germa "g" , duke rezultuar me një rendiment prej 153 %. Kjo analizë justifikon pikëzimin e gjyqtarit më lart se ajo e parashikuar nga metodologjia, prandaj aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet në nivelin "+99%", dhe pikëzohet maksimalisht.

KONKLuzioni

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari {...} duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “+ 99 %”, duke e pikëzohet me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është **13.12 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është **7.38 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*familjare me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është **10.15 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*familjare pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është **10.15 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*marrëdhënie pune*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është **14.1 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308 i K. Pr. Civile.

Për çështje të kategorisë “*krime*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është **14.24 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është **9.95 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

Për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi⁷⁵, **6 ditë**,

⁷⁵ Përsa i përket kërkesave me objekt “Caktim mase sigurimi” të cilat merren në mungesë dhe janë të natyrës sekrete, nga tabelat statistikore rezultojnë se datat e depozitimit të vendimeve të arsyetuara janë ato që pasqyrohen.

pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K. Pr. Penale.

- (i) Për kërkesa me objekt zëvendësim/revokim mase sigurimi, **5.2 ditë, pra më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K. Pr. Penale.
- (ii) Për kërkesa me objekt “Marrje në pyetje e të arrestuarit”, **11 ditë, pra më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 248/2 i K. Pr. Penale.
- (iii) Për kërkesa me objekt “Shuarje mase”, **5.2 ditë, pra më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 261/3 dhe 248/2 i K. Pr. Penale.
- (iv) Për kërkesa me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, lejim kontrolli, **612 ditë, pra më e gjatë**⁷⁶ se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 dhe 202/a i K. Pr. Penale.
- (v) Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit “Deklarim i ikjes”, (neni 247 i K.Pr.Penale) **15.5 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- (vi) Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit”, (neni 291 i K.Pr.Penale) **5.26 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K.Pr.Penale.
- (vii) Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit “Sigurim i provës”, (neni 321 i K.Pr.Penale) **21 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është: Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, **12.2 ditë, pra më e gjatë** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K. Pr. Penale.⁷⁷

- (viii) Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, **10.3 ditë, pra më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridikionale me jashtë*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- (ix) Për kërkesa me objekt “*Përjashtimin e gjyqtarit*” (*pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të K. Pr. Penale me ligjin nr. 35/2017*), koha mesatare e arsyetimit është **2.66 ditë, pra më e gjatë** sesa afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni

⁷⁶ Përlllogaritja është bërë mbi bazën e të dhënave statistikore, ku si datë depozitimi vendimi është marrë data që Gjyqtari ka depozituar vendimin e arsyetuar në sekretari. Nga përmbajtja e të dhënave statistikore rezulton se shqyrtimi i kërkesave për lejim përgjimi është bërë brenda 24 orëve, por këto kërkesa kanë karakter sekret. Vetëm kërkesa me objekt lejim kontrolli me nr. Rendor 83 në tabelën nr. 10 të vitit 2020 rezulton të jetë shqyrtuar 1 muaj pas regjistrimit të kërkesës dhe vendimi është dorëzuar i arsyetuar 6 ditë pasi është shpallur.

⁷⁷ Në tabelën nr. 11 të vitit 2021, vihet re se çështja me nr. Rendor 69 është shpallur vendimi në datën 15.07.2021 dhe është dorëzuar në datën 28.09.2021 (2 muaj e 13 ditë). Po ashtu, në tabelën nr. 11 të vitit 2022 vihen re se çështjet me nr. Rendor 19, 36, 37, 78, 79 nga data e shpalljes së vendimit deri në datën e depozitimit të tij kanë kaluar respektivisht: 5 muaj e 2 ditë, 6 muaj e 29 ditë, 5 muaj e 7 ditë, 1 muaj, dhe 13 ditë.

22 i K. Pr. Penale.

- (x) Për kërkesa me objekt “*Rivendosje në afat ankimi*”, koha mesatare e arsyetimit është 7 ditë, **pra më i gjatë** se afati procedural **8.5 ditë**, i parashikuar nga neni 420/1 i K.Pr.Penale.
- (xi) Për kërkesa me objekt “*Shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të dënimit*”, koha mesatare e arsyetimit është **6 ditë**, **pra më i gjatë** se afati procedural 5 ditë, i parashikuar nga neni 476 i K.Pr.Penale.
- (xii) Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, **10.88 ditë**, **pra më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari ka vlerësuar këtë tregues në nivel *mbi mesataren*, duke argumentuar si vijon: “Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor*” në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: *e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë*). Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: “*Sa i takon arsyetimit të vendimeve, përgjithësisht kam respektuar afatet e përcaktuara nga ligji. Sidomos në çështjet e natyrës penale, arsyetimi dhe depozitimi i vendimit të arsyetuar, është bërë thujse përherë, brenda afatit ligjor. Përfundimet kanë ndodhur për shkak të volumit të madh në periudha të caktuara (si p.sh. në muajt kur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin ishim vetëm dy gjyqtarë), ose për shkak të rastit faktor (si në rastin e arsyeve shëndetësore, të dokumentuara rregullisht). Në lidhje me çështjet civile, përgjithësisht është respektuar afati i arsyetimit të vendimeve, megjithëse e pranoj që, në nivel më të ulët se, në çështjet penale. Në çdo rast, vonesat kanë qenë në nivelin e disa ditëve, e në asnjë rast, nuk kanë sjellë pasoja për palët, në kushtet kur vendimet përkatëse nuk janë ankimuar, duke marrë formë të prerë me plotësimin e afateve të ankimit sipas ligjit.*”

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: “*Gjyqtari ka treguar aftësi për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë vendimet gjyqësore.*”

Nga analiza e integruar e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, afati procedural për 10 kategorite e çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtari {...} është tejkaluar në vetëm dy nenkategoritë konkretisht :

Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

- Për kërkesa me objekt “*Marrje në pyetje e të arrestuarit*”, 11 ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar neni 248/2 i K. Pr. Penale.
- Për kërkesa me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, lejim kontrolli, 612 ditë, **pra më e gjatë**⁷⁸ se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 dhe 202/a i K. Pr. Penale.

Referuar shenimit të bërë nga nepunesja përgjegjëse e vlerësimit sa i përket kategorise se sipërcituar në të cilën koha mesatare e arsyetimit të vendimit per

⁷⁸ Përlllogaritja është bërë mbi bazën e të dhënave statistikore, ku si datë depozitimi vendimi është marrë data që Gjyqtari ka depozituar vendimin e arsyetuar në sekretari. Nga përmbajtja e të dhënave statistikore rezulton se shqyrtimi i kërkesave për lejim përgjimi është bërë brenda 24 orëve, por këto kërkesa kanë karakter sekret. Vetëm kërkesa me objekt lejim kontrolli me nr. Rendor 83 në tabelën nr. 10 të vitit 2020 rezulton të jetë shqyrtuar 1 muaj pas regjistrimit të kërkesës dhe vendimi është dorëzuar i arsyetuar 6 ditë pasi është shpallur.

kerkesat me objekt zgjatje afat përgjimi, lejim kontrolli, ka rezultuar 612 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 dhe 202/a i K. Pr. Penale, ajo çfarë vleresoj të saktësot është se këto kerkesa duke qene të një natyre sekrete normalisht vendimi i arsyetuar ne sekretari zbret bashke me dosjen pasi ky vendim të ketë humbur efektet e të qenurit sekret. Pikërisht kur në vijim të saj procedohej me masa sigurimi të ekzekutuara të cilat normalisht humbisnin efektin sekret të kërkesave te tilla me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, lejim kontrolli. Parë në këtë kendveshtrim vleresoj se kjo kategori per aq kohë sa rezulton nga të dhenat statistikore e shqyrtuar brenda afatit ligjor të parashikuar 24 orë, koha mesatare e arsyetimit të ketyre vendimeve të konsiderohet me e shkurtër se afati procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 dhe 202/a i K. Pr. Penale.

Tek të gjitha kategoritë e çështjeve të tjera për të cilat ne raportin analitik është konkluduar se koha mesatare e arsyetimit është me të gjate e afati i parashikuar nga ligji janë kategori për të cilat tejkalimi nga afati ligjor konsiderohet i papërfillshem, pasi tejkalimet janë nga 0.2 në 2.2 ditë nga afati i parashikuar nga ligji për arsyetimin e vendimeve.

Referuar metodologjisë treguesi mesatar i kohës se arsyetimit të vendimeve gjyqësore vlerësohet në rastin konkret më e shkurter se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve dhe pikëzohet me 12 pikë. Duke qenë se kemi vetëm një nënkategori (*Për kërkesa me objekt "Marrje në pyetje e të arrestuarit", 11 ditë, pra më e gjatë se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 248/2 i K. Pr. Penale*) për të cilën koha mesatare e arsyetimit të vendimit është me e gjatë gjithashtu edhe duke marrë parasysh të gjitha shkaqet parashtruara nga gjyqtari subjekt vlerësimi në formularin e vetëvlerësimit si dhe ngarkesen e tij me një numër të lartë vendimarrjesh, si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%, vleresoj se gjyqtari {...} për këtë kriter duhet të pikëzohet maksimalisht.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar vlerësohet se duhet të klasifikohet si "*Më e shkurter ose e barabarte me afati procedural për te gjitha kategorite e çështjeve*" çka bën që gjyqtari të pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se në lidhje me treguesin "Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar" të klasifikohet si "Më e shkurter ose e barabarte me afati procedural për te gjitha kategorite e çështjeve" dhe gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare të përzgjedhura me short për vlerësim, për të gjitha kategoritë e çështjeve (*përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse, në dhomë këshillimi dhe përgatitore e pajtimi*) është 2.7. Ndërsa të ndara sipas kategorive rezulton si më poshtë:

- Për çështjet e kategorisë “civile të përgjithshme me palë kundërshtare, përfshirë edhe çështjet familjare me palë kundërshtare”, numri mesatar i seancave gjyqësore është **2.2**.
- Për çështjet e kategorisë “seancë paraprake” numri mesatar i seancave gjyqësore është **2**
- Për çështjet e kategorisë “penale-krime” numri mesatar i seancave gjyqësore është **3**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë.

Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me urdhër për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse, sipas kritereve të parashikuara në K.Pr.Civile/K.Pr.Penale.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: *në kushtet e pamundësisë për arsye shëndetësore të gjyqtarit; me qëllim përsëritjen e njoftimit për palet ndërgjyqëse padites/i paditur, prokuror / i pandehur apo viktimën; në kushtet e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore për shkak të situatës së krijuar prej Covid-2019; me qëllim për t’u njohur me aktet nga përfaqësuesi i caktuar dhe i legjitimuar rishtazi, apo kërkesa më qëllim përgatitjen e diskutimeve përfundimtare me shkrim, me qëllim përsëritjen e njoftimeve, në rast se, nuk provohet se, pala ose palët kanë marrë dijeni, sipas ligjit, me qëllim paraqitjen e konkluzione përfundimtare me shkrim etj.* Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe objektive, dhe të pavarura nga veprimet e gjyqtarit së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

KONKLUZIONI

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 2.7 seanca dhe gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave dhe pikëzohet kështu sipas Metodologjisë me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive” vlerësohet se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, gjyqtari është shprehur me vendim, si për njoftimin e akteve dhe kërkesës padisë palëve të paditura konform nenit 158 të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, ashtu edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore ose pajtimi në çështjet familjare (neni 158/b i K.Pr.Civile dhe neni 132 i K. Familjes) e në vijim, pas ezaurimit të seancës përgatitore edhe për nxjerrjen e urdhrit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore (neni 158/ç i K.Pr.Civile) gjyqtari ka disponuar me vendim për përcaktimin e provave që do të administrohen në gjykim.

Gjatë gjykimit gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të paditurve, apo deklarin e mungesës për të pandehurin shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe kur është rasti, edhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa më pak se 15 minuta që janë të papërfillshme ne pjesen me te madhe te tyre. Edhe ne ato raste ku ka patur vonesë nga 21-30 min minuta nuk ka rezultuar që ato të kenë sjellë pasoja në produktivitetin e gjykimit të çështjes. Shkaku i vonesave në zhvillimin e seancave gjyqësore, sipas relativitetit të gjyqtarit lidhet me pjesëmarrjen e tij në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, janë mbajtur me regjistrim audio, si dhe janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë dhe duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjes janë të renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në rastin konkret, renditja sipas llojit të akteve procedurale, e ndërthurur edhe me veprimet procedurale të kryerja nga gjyqtari gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave*). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi. Në secilën prej tyre është përfshirë vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

KONKLUZIONI

Në tërësi, rezulton se renditja akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore

lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 5 pikë.*

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit, nga momenti i caktimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit të saj. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*kërkesa penale, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, vendimi për caktimin e çështjes gjyqësore, komunikimet shkresore me të tretët, njoftimet, procesverbalet seancave gjyqësore dhe vendimet gjyqësore përfundimtare*).

Në dosjet penale, nuk rezulton të jetë administruar kopje e “Letrës së të drejtave” e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a 79, 5880, 140 pg 181 dhe 13782 i K.Pr.P. Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të K.Pr.P subjekteve i janë garantuar duke ju bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mos administrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore dhe mospasqyrimi në këtë të fundit i komunikimit të letrës së të drejtave, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të “letrës të të drejtave” e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të

⁷⁹ Në nenin 34/a, pika 2 dhe 3 të K.Pr.P parashikohet se :” 2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar. 3. Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.”.

⁸⁰ Neni 58 pika 2 i K.Pr.P parashikon se :” 2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.”.

⁸¹ Neni 140, pg 1 i K.Pr.P parashikon se : « 1. Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij personalisht kopjen e aktit së bashku me letrën e të drejtave, sipas nenit 34/a, të këtij Kodi.... »

⁸² Neni 137, pg 1 i K.Pr.P parashikon se :” 1. Njoftimet për personin e dëmtuar nga vepra penale bëhen njëjloj si për rastet kur njoftohet për herë të parë i pandehuri i lirë....”.

përzgjedhura me short për vlerësim, vlerësohet se gjyqtarit nuk mund të vlerësohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “mbi mesatare”, dhe pikëzohet me 8 pikë.

Nivelin i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Shkresat Nr. 978/1 Prot., datë 29.04.2024; Nr. 272/1 Prot., datë 20.02.2024; Nr. 2686 Prot., datë 25.09.2023; Nr. 1393/3 Prot., datë 08.05.2023, si dhe shkresa me nr. 5634 Prot., datë 27.10.2023 depozituar nga vetë Gjyqtari subjekt vlerësimi, për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, për gjyqtarin {...} janë depozituar 11 ankesat siç vijon për të cilat Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka disponuar me vendim për arkivimin e tyre:

1. Ankues znj. Xhevahire Jakupaj, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesat e regjistruara me nr. 50 prot., datë 07.02.2020, nr. 684 prot., datë 15.05.2020, nr. 1043 prot., datë 10.06.2020, nr. 50/2 prot., datë 10.07.2020, nr. 50/3 prot., datë 30.09.2020, nr. 50/4 prot., datë 05.11.2020, nr. 1043/2 prot., datë 25.11.2020, nr. 1043/3 prot., datë 25.11.2020, nr. 50/6 prot., date 01.12.2020 dhe nr. 50/7 prot., datë 09.12.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesave, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 50/9 prot., datë 12.03.2021 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së shtetases Xhevahire Jakupaj", ka vendosur arkivimin e ankesave.
2. Ankues subjekti "Raiffeisen Bank", i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesat e regjistruara me nr. 586 prot., datë 06.04.2020 dhe nr. 586/2

- prot., datë 18.06.2020. Pas shqyrtimit fillestar të ankesave, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 586/4 prot., datë 08.02.2021 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave, së paraqitura nga Raiffeisen Bank", ka vendosur arkivimin e ankesave.
3. Ankues znj. Xhevahire Jakupaj, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 5 prot., datë 05.01.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 5/2 prot., datë 26.01.2021 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës, së paraqitur nga shtetasja znj. Xhevahire Jakupaj", ka vendosur arkivimin e ankesës.
 4. Ankues z. Dritan Babaj, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 30 prot., datë 08.01.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 30/3 prot., datë 19.05.2021 "Për verifikimin pas shqyrtimit fillestar, të ankesës së paraqitur nga av. Dritan Babaj", ka vendosur verifikimin e ankesës. Në vijim, me Shkresën Nr. 1991/2 Prot., datë 14.11.2022 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë rezulton se është Njoftuar Vendimi nr. 1991/1 Prot., datë 14.11.2022 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me anë të së cilës është vendosur ndër të tjera: *"Arkivimin pas verifikimit të ankesës të Av. Dritan BABAJ, me Nr. 30 Prot., datë 08.01.2021, ndaj veprimtarisë së magjistratit Z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin."*
 5. Ankuesit z. Edmond Selala, z. Llesh Selala, z. Ardian Selala dhe z. Gentian Selala, i janë drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 730/2 prot, datë 18.02.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 1939/1 prot., datë 12.04.2021 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të ankesës së paraqitura nga Edmond Selala, Llesh Selala, Ardian Selala, Gentian Selala", ka vendosur arkivimin e ankesës.
 6. Ankues z. Kimet Bajrami, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 790 prot., datë 05.04.2022. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 790/3 prot., datë 28.06.2022 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Kimet Bajrami", ka vendosur arkivimin e ankesës.
 7. Ankues z. Edmond Selala, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 2030 prot., datë 13.04.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2030/2 prot., datë 12.07.2021 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të ankesës së paraqitur nga shtetasi z.Edmond Selala", ka vendosur arkivimin e ankesës.
 8. Ankues znj. Xhevahire Jakupaj, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 2134 prot., datë 22.04.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. 2134/2 prot., datë 10.09.2021 "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar, të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. Xhevahire Jakupaj", ka vendosur arkivimin e ankesës.
 9. Ankuesit znj. Lule Zefi dhe Donald Zefi, i janë drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 3824 prot., datë 12.10.2021. Me Shkresën nr. 2686/1 Prot., datë 25.09.2023 të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është përcjellë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kopje e Vendimit nr. 2185/1 Prot., datë 25.07.2023 me anë të të cilit është vendosur ndër të tjera: *"1. Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga ankuesit Znj. Lulë ZEFI dhe Z. Donald ZEFI, regjistruar pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr. 3824 prot., datë 12.10.2021 lidhur me veprimtarinë...e gjyqtarit {...} pranë ish Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar."*

10. Ankues znj. Xhevahire Jakupaj, i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 613 prot., datë 15.03.2022. Gjyqtari subjekt vlerësimi, me Shkresën nr. 5634 Prot., datë 27.10.2023 ka përcjellë pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kopje të Vendimit nr.1476/2 Prot., datë 26.07.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në të cilën është vendosur: *“1. Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara me nr. 1067 Prot., datë 19.02.2021, nr. 613 Prot., datë 15.03.2022, nr. 2534 Prot., datë 19.09.2022 dhe nr. 2534/1 prot., datë 29.09.2022 të paraqitura nga shtetasja Xhevahire JAKUPAJ”*. Në këtë vendim, argumentohet ndër të tjera se në ankesë nuk përshkruhen rrethanat e faktit që pretendohet të kenë ndodhur, nuk tregohen aktet konkrete që tregojnë vendimmarrjen e magjistratëve të përmendur në ankesën e saj, nuk ka të dhëna që të konsiderohen të mjaftueshme për të vlerësuar kriterin e pranueshmërisë të lidhur me përshkrimin e faktit të ndodhur, të parashikuar për përmbajtjen e ankesës sipas pikës 1, shkronja “a” dhe pikës 2, shkronja “b”, të nenit 120, si dhe shkronjës “b”, “d” dhe “dh” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Po ashtu, në këtë vendim arsyetohet shtetasja Xhevahire Jakupaj ka paraqitur në mënyrë të përsëritur ankesa pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ndaj magjistratit {...}, për të cilat, Zyra e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë është shprehur me vendimmarrjet përkatëse të njoftuara ankueses.
11. Ankues subjekti "Shoqëria Ushina" sh.p.k i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesat e regjistruara me nr. 745 prot., datë 01.04.2022, nr. 1655 prot., datë 10.06.2022, dhe nr. 4308 prot., datë 06.12.2022. Me Vendimin Nr. 1011/1 Prot., datë 26.04.2024, “Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shoqëria “Ushina SHPK”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur: *“1. Arkivimin e ankesave të bashkuara me nr. 4308 prot., datë 06.12.2021, nr. 4308/2 prot., datë 11.01.2022; nr. 4308/3 Prot., datë 14.01.2022; nr. 4308/4 prot., datë 07.02.2022; nr. 4308/5 prot., datë 16.02.2022; nr. 745 prot., datë 01.04.2022; nr. 745/1 prot., datë 01.04.2022; nr. 1655 prot., datë 10.06.2022, të paraqitura nga shoqëria Ushina SHPK, me administrator Fatjon Ushina, ndaj magjistratëve P.Ç, R.B, dhe z. {...}, aktualisht me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.”* Në këtë vendim, ndër të tjera arsyetohet se: *“...Pretendimet e ankuesit ndaj magjistratit {...} në thelb janë pretendime që lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe vlerësimin të provave nga gjykata respektive. Shqyrtimi dhe vlerësimi i pretendimeve të palëve dhe provave gjatë një procesi gjyqësor dhe interpretimi i ligjit sipas bindjes së brendshme në gjykimin e një çështjeje është atribut i pushtetit gjyqësor.”*

Referuar vetëvlerësimit të gjyqtarit sipas formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se:

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin e etikës në punë në shkallë shumë të lartë (nga pesë nivelet: e dobët; nën mesatare; mesatare; mbi mesataren; shumë e lartë) duke shpjeguar se: *“Me bindej të plotë vlerësoj se, etika është një nga pikat më të forta të mia. Gjatë të gjithë periudhës së vlerësimit, kam shmangur në mënyrë të plotë sjelljet jo etike karshi kolegëve, avokatëve, prokurorëve, administratës gjyqësore, si dhe palëve. Kam treguar përherë përkushtim në lidhje me ushtrimin e detyrës, duke kryer në raste nevojë, seanca gjyqësore në tri gjykata brenda të njëjtës ditë. Konkretisht, kam zhvilluar seanca brenda të njëjtës ditë, në Kurbin, Krujë dhe Lezhë, ose në Kurbin, Mat dhe Lezhë, ose në Durrës, Krujë dhe Kurbin. Në lidhje me sjelljen karshi palëve dhe*

përfaqësuesve të tyre, vlerësoj se, ka qenë korrekte, duke iu kushtuar kohë dhe vëmendje, por në fund, duke vendosur në mënyrë të pavarur dhe me bindje të plotë”.

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: *"Gjyqtari ka shfaqur sjellje të kujdesshme, objektive, me vetëpërbajtje dhe maturi gjatë ushtrimit të detyrës, duke vepruar në mënyrë korrekte dhe duke shmangur sjellje që tregojnë mungesë respekti dhe sjellje, që formalisht përcaktohen si në kundërshtim me ligjin."*

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezultojnë se gjyqtari {...} ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

***Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin "Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion" është "Shumë e lartë" dhe pikëzohet me 35 pikë.*

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2020-31.12.2022 rezultojnë se ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit, me shkresat e percjella percjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Shkresat Nr. 978/1 Prot., datë 29.04.2024; Nr. 272/1 Prot., datë 20.02.2024; Nr. 2686 Prot., datë 25.09.2023; Nr. 1393/3 Prot., datë 08.05.2023, si dhe shkresa me nr. 5634 Prot., datë 27.10.2023 depozituar nga vetë Gjyqtari subjekt vlerësimi, për inspektimin e veprimtarisë së magjistratit ose të gjykatës, si dhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore të dhëna ndaj magjistratit, janë të arkivuara dhe në asnjë prej tyre nuk referohet që të mbahen në konsideratë për vlerësimin etiko- profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, nuk rezultojnë që ndaj gjyqtarit {...}, gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për gjyqtarin {...} percjellë pranë KLGJ-së me shkresën nr. shkresën nr. 1948/2 prot. datë 10.07.2023 rezultojnë se: - *Deklaratat e interesave Periodike/Vjetore 2017-2020, janë dorëzuar brenda afateve ligjore.- Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; - Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave.*

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin e integritetit në shkallë shumë të lartë duke shpjeguar se: *"Vlerësoj se, kam aftësi të larta për të respektuar, miratuar dhe mbështetur vlerat themelore të punës sime, siç janë shmangia e shfaqjes së pahijshme,*

nderi dhe dinjiteti; aftësia për t'iu përgjigjur pritshmërive të ligjshme të publikut, duke demonstruar mençuri, ndershmëri, ndjenjë humanizmi, guxim, seriozitet dhe maturi, si dhe duke vepruar me vetëdije se sjellja profesionale, jeta private dhe sjellja ime në shoqëri, kanë ndikim në imazhin e drejtësisë. Gjatë marrjes së vendimeve kam shmangur paragjykimet që mund të dëmtojnë gjykimin. Nuk kam treguar favor apo disfavor në lidhje me çështjet, me palët, ose me avokatët, në çështjet përpara gjykatës. Në aspektin praktik, gjatë tre viteve të periudhës së vlerësimit, kam shmangur në mënyrë të plotë çdo takim me avokatë apo përfaqësues të tjetër, pa praninë e të paktën një punonjësi tjetër të gjykatës, e përherë për shkaqe pune (p.sh. sqarime në lidhje me një vendim për konstatim të metash padie). Në mënyrë të plotë kam shmangur frekuentimin e restoranteve, bar-kafeve dhe mjediseve të tjera të hapura për publikun, në territorin e Bashkisë Kurbin, me përjashtim të aktiviteteve të organizuara nga vetë gjykata, në të cilën kanë marrë pjesë të gjithë gjyqtarët dhe e gjithë administrata gjyqësore. Sjellja etike, komunikimi i qartë, i edukuar, por njëherazi i prerë dhe i vendosur, vlerësoj se, janë dalluar nga çdo subjekt që është gjykuar nga unë, pavarësisht pozitës procedurale.”

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: "Gjyqtari ka demonstruar cilësitë e mësipërme, duke shmangur paragjykimet dhe nuk ka manifestuar sjellje të pahijshme.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin "Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti" është "Shumë e lartë" dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të

tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Gjyqtari lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari {...} ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se :

Për vitin 2020, janë paraqitur 4 (katër) kërkesë për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, për të katër të cilat është vendosur “Pranuar”. Gjithashtu, rezulton se edhe vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 29 (njëzet e nëntë) kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar gjithsej 29 (njëzet e nëntë).

Për vitin 2021, janë paraqitur 6 (gjashtë) kërkesë për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, për të gjashtë të cilat është vendosur “Pranuar”. Gjithashtu, rezulton se edhe vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 10 (dhjetë) kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar gjithsej 10 (dhjetë).

Për vitin 2022, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për përjashtimin e subjektit të vlerësimit. Gjithashtu, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 6 (gjashtë) kërkesa për heqje dorë.

Për të gjithë periudhën e vlerësimit 01.01.2020-31.12.2022, janë paraqitur 10 (dhjetë) kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, të cilat janë pranuar gjithsej 10 (dhjetë). Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit ka paraqitur 45 (dyzet e pesë) kërkesa për heqje dorë, të cilat janë pranuar.

Ndodhur në kushtet kur nga te dhenat statistikore ishin 10 (dhjetë) kërkesa për përjashtim të Gjyqtarit {...} të pranuar, një numër ky relativisht i lartë, iu kërkua informacion Gjykatës përmes postës elektronike, e cila me mesazhin elektronik të datës 14.05.2024 sqaroi se:

- Për vitin 2020 nuk ka patur kërkesa “Përjashtim gjyqtari” për gjyqtarin {...}.
- Për vitin 2021 ka patur 6 kërkesa penale për përjashtimin nga gjykimi të gjyqtarit {...}, për cilin është vendosur “Rrëzim kërkesë”.
- Për vitin 2022 ka patur 1 kërkesë për përjashtimin nga gjykimi të gjyqtarit {...}, për të cilën është vendosur “Rrëzim kërkesë”.

Në total për periudhën 2020-2022, për gjyqtarin {...} ka patur 7 (shtatë) kërkesa “Përrjashtim gjyqtari” për të cilat është vendosur “Rrëzim kërkesë”⁸³.

KONKLuzioni

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se në gjithë periudhën 3/vjeçare, nuk ka kërkesa të pranuar për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, vlerësohet se ky numër është “I pakonsiderueshëm”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu edhe regjistrimet e seancave në sistemin audio.

⁸³ Bashkëlidhur emailit gjenden vendimet gjyqësore me anë të të cilave janë rrëzuar kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit {...}.

Gjyqtari subjekt vlerësimi dhe Zv. Kryetari i Gjykatës këtë tregues, në nivel shumë të lartë duke shprehur se “Gjyqtari ka aftësi për të qenë transparent në komunikim dhe për t’u shprehur në mënyrë të kuptueshme, të qartë me palët ndërgjyqëse, publikun, subjektet e tjera dhe të tretët.”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari {...} në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale për të cilat gjyqtari vihet në dijeni për shkak të funksionit. Në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të ketë pasur të dhëna me karakter sensitiv apo personal. Gjithashtu, nga burimet e tjera të vlerësimit nuk ka asnjë të dhënë apo indicje për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” në shkallë të lartë si dhe Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: “Gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit, dhe në këtë aspekt nuk është konstatuar asnjë problematikë.”

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, presumohet se gjyqtari {...}, ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “I lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të tij me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” në shkallë shumë të lartë ”

Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: "Gjyqtari ka treguar aftësi dhe disponibilitet për të bashkëpunuar me kolegët."

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë, duke parashtruar se gjyqtari ka komunikim etik, korrekt dhe mirëkuptues me administratën gjyqësore.

Referuar të dhënave përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Shkresat Nr. 978/1 Prot., datë 29.04.2024; Nr. 272/1 Prot., datë 20.02.2024; Nr. 2686 Prot., datë 25.09.2023; Nr. 1393/3 Prot., datë 08.05.2023, si dhe shkresa me nr. 5634 Prot., datë 27.10.2023 depozituar nga vetë Gjyqtari subjekt vlerësimi rezulton se: *Për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, për gjyqtarin {...} janë depozituar ankesat të cilat janë të arkivuara dhe në asnjë prej tyre nuk referohet që të mbahen në konsideratë për vlerësimin etiko – profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.*

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore*” në shkallë shumë të lartë gjithashtu dhe Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: *“Gjyqtari është përpjekur në vazhdimësi të ofrojë motivim, orientim, udhëzim, duke ruajtur marrëdhënie shumë të mira me personelin e gjykatës.”*

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. 301/6 prot., datë 02.05.2023 dhe nr. 301/18, datë 02.06.2023, rezulton se: *Për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, gjyqtari {...} gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2020-31.12.2022, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në 14 aktivitete trajnuese të cilat kanë zgjatur për 20 ditë kalendarike.*

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 14 aktivitete të zhvilluara për 20 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime është nga 15-120 ditë, dhe pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se ne dosjes personale të subjektit të vlerësimit nuk evidentohen të dhëna në lidhje me këto kriter. Në bazë të informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. 301/6 prot., datë 02.05.2023 dhe shkresën nr. 301/18 prot., datë 02.06.2023, rezulton se: *Për periudhën 01.01.2020-31.12.2022, Gjyqtari {...} nuk ka marrë pjesë në cilësinë e ekspertit/lehtësuesit në asnjë aktivitet trajnues.*

Subjekti i vlerësimit në formularin e integruar të vlerësimit, është shprehur se: “Në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” është shprehur se: “Që në vitin 2020, e mandej edhe në vitet 2021 dhe 2022, kam shfaqur gadishmërisë për t’u përfshirë si lehtësues në programin e trajnimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës. Siç e përmenda më lart, në vitin akademik 2022 - 2023 (megjithëse nuk është plotësisht brenda periudhës së vlerësimit) jam përzgjedhur nga Shkolla e Magjistraturës, si lehtësues, në programin e trajnimit vazhdues.”

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues pranë Shkollës së Magjistraturës apo të ketë pasur mundësi të udhëheqë kandidatët për magjistratë gjatë stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtarit dhe për pasojë, pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se ka të dhëna për anagazhimin e gjyqtarit veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Në formularin e formularit të integruar të vlerësimit të gjyqtarit, rezulton se: Subjekti i vlerësimit, në lidhje me treguesin “Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, është shprehur se: “Tej veprimtarisë si gjyqtar, në mënyrë aktive jam angazhuar në veprimtari të tjera në fushën e drejtësisë. Këto mund t’i kategorizoj në tri grupe: ato të zhvilluara në kuadër të gjykatës; ato të zhvilluara në bashkëpunim me organizatat që veprojnë në fushën e drejtësisë; si dhe ato të zhvilluara në kuadër të promovimit të shkrimeve të mia juridike. 1) Në lidhje me grupin e parë, kam qenë ideatori, organizatori dhe realizuesi i tre trajnimeve (seminareve) të hapura, në mjediset e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe të administratës së kësaj gjykatë, të avokatëve dhe asistent avokatëve të dhomës vendore të avokatisë, si dhe të prokurorëve të prokurorisë përkatëse. Më 26.05.2021 u zhvillua për herë të parë, një trajnim/seminar në lidhje me ndryshimet ligjore që do të hynin në fuqi së shpejti. Konkretisht, prezantova dhe shpjegova para kolegëve gjyqtarë, administratës së gjykatës, prokurorëve të prokurorisë përkatëse dhe avokatëve të dhomës vendore të avokatisë, ndryshimet në K.P.Penale, lidhur me gjykimin në shkallë të parë, që do të hynin në fuqi më 30.05.2021. Më 19.10.2021, në mjediset e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin u zhvillua seminari i dytë me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, administratës së gjykatës, prokurorëve të prokurorisë përkatëse dhe avokatëve të dhomës vendore të avokatisë. Në këtë aktivitet prezantova dhe u diskutuan disa prej zhvillimeve të fundit në lidhje me legjislacionin dhe jurisprudencën, në fushat e së drejtës procedurale penale dhe së drejtës penale (materiale). Më 16.12.2022, në mjediset e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin u zhvillua seminari i tretë me pjesëmarrjen e gjyqtarëve, administratës së gjykatës dhe avokatëve dhe asistent-avokatëve të dhomës vendore të avokatisë. Në këtë aktivitet prezantova dhe u diskutuan disa prej zhvillimeve të fundit në lidhje me legjislacionin dhe jurisprudencën, në fushën e së drejtës procedurale civile. Konkretisht, diskutimi u përqëndrua te padia, tek kërkesa për vërtetimin gjyqësor të fakteve dhe te ligji nr. 169/2020. U trajtuan elementet dalluese të dy mjeteve në fjalë, kompetenca lëndore në shqyrtimin e tyre, si dhe provat e kërkuara, për pranimin eventual të tyre. 2) Në lidhje me grupin e dytë, më 04.12.2021, kam marrë pjesë në “Konferencën e 8-të për drejtësinë penale”, të organizuar në Tiranë, nga “Shoqata e Avokatëve Penalistë”, në të cilën referova temën “Gjykimi i shkurtuar si procedurë e posaçme gjyqësore penale, në kuadër të ndryshimeve legjislative të viteve 2017 dhe 2021”. 3) Në lidhje me grupin e tretë, më 29 mars 2022, në bibliotekën “Musine Kokalari”, në Tiranë (pranë ndërtesës së Dhomës Civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), u zhvillua prezantimi i librit tim “Manuali i së drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë”, me ELSA Albania. Më 5 prill 2022, në Departamentin e Drejtësisë pranë Kolegjit Universitar “Bedër”, u organizua promovimi i veprës sime “Manuali i së drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë”. Gjatë takimit prezantova evolucionin e legjislacionit të së drejtës ndërkombëtare private në Republikën e Shqipërisë dhe diskutova metodologjinë e përdorur për të analizuar

jurisprudencën e Gjykatën e Lartë. Gjithashtu, fola për rëndësinë e ushtrimit të profesionit të gjyqtarit, ku theksova rëndësinë e specializimit në të drejtën ndërkombëtare private, si fushë me shumë potencial për vitet në vijim. Më 12 prill 2022, në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit “Luarasi”, u zhvillua prezantimi i veprës sime “Manuali i së drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë”. Gjatë takimit, bëra prezantim e librit, duke referuar në evolucionin e legjislacionit të së drejtës ndërkombëtare private në Shqipëri dhe të jurisprudencës në këtë fushë. Gjatë prezantimit, iu përgjigja pyetjeve të studentëve dhe stafit akademik, në një diskutim miqësor, duke synuar të përcjell mesazhe të rëndësishme, për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit dhe forcimin e tiparit të studiuesit të së drejtës, që i jep vlerë të shtuar çdo juristi. Më 26 prill 2022, në Kolegjin Universitar “Ëisdrom”, u zhvillua prezantimi i radhës, i veprës sime “Manuali i së drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë”, në prani të studentëve dhe stafit pedagogjik. Gjatë prezantimit, paraqita rëndësinë e së drejtës ndërkombëtare private, si degë e së drejtës, si dhe strukturën dhe përmbajtjen e Manualit, me qëllim sqarimin sa më të plotë të kësaj dege. Më 18 maj 2022, në "Universitetin e Nju-Jorkut" në Tiranë, u zhvillua leksioni i hapur në fushën e së drejtës ndërkombëtare private, gjatë së cilit u zhvillua edhe prezantimi i radhës, i veprës sime “Manuali i së drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë”, në prani të studentëve dhe stafit pedagogjik. Gjatë prezantimit, trajtova raste konkrete të së drejtës ndërkombëtare private shqiptare, por duke i lidhur edhe me degë të tjera të së drejtës. Ideja që kam është që, gjykata nuk mund të forcohet dhe të bëhet e besueshme, nëse rri e mbyllur dhe e izoluar me veten. Hapja me komunitetin përkatës, si dhe bisedimet dhe takimet me njerëzit, e forcojnë. Është e pritshme që, në parim, çdo qëndrim që mban gjykata, do të mërzisë të paktën një palë apo subjekt procedural. Por, transparenca dhe ndërveprimi me komunitetin, sipas ligjit, ndihmon që të mos shihet gjykata si një ishull ku nuk dihet çfarë ndodh dhe pse ndodh, por si një lidhëse e fortë sociale dhe kushtetuese. Siç e përsëris shpesh, nuk ka gjë më të mirë për gjyqtarin, kur askush nuk guxon t’i hyjë në zyrë, por kushdo dëshiron t’i vijë në sallë, apo t’i lexojë vendimet. <https://ëëë.gjykata.gov.al/rrethi-kurbin/gjykata-e-rrethit-kurbin/multimedia/>. Lidhur me këtë tregues, Zv. Kryetari i Gjykatës ka vlerësuar se: “Jam në dijeni për angazhime të gjyqtarit në veprimtaritë e mësipërme dhe në disa prej tyre, në kuadër të Gjykatës si dhe në aktivitetin promovues 5 prill 2022, në Departamentin e Drejtësisë pranë Kolegjit Universitar "Bedër", ku u organizua promovimi i veprës sime “Manuali i së drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë” kam qenë pjesëmarrës”.

Sipas metodologjise e cila percakton se: “...Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike...”

Sa më sipër duke qenë se nga burimet e vlerësimit, rezultojnë të dhëna për pjesëmarrjen dhe impenjimin e gjyqtarit në aktivitete të tjera ndër-institucionale dhe në veprimtari për

marrëdhëniet me publikun në gjykata, për të dhënë kontributin e tij në përmirësimin e drejtësisë, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.*

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, rezulton se gjyqtari {...} ka relatuuar disa shkrime dhe botime në fushën e drejtësisë:

1) “Njëzetë e dy vjet Kushtetutë e Republikës së Shqipërisë” (artikull). Botuar nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, në revistën “Avokatia” nr. 35, korrik 2020. Autor. ISSN 2304-6392.

2) “Gjykata e Lartë dhe e drejta ndërkombëtare private” (punim shkencor). Botuar nga Shkolla e Magjistraturës, në revistën “Magjistrati” nr. 12, nëntor 2020. Autor. ISSN 2415-539X.

3) “Kontratat “e humbura” nga Kodi Civil i vitit 1929” (artikull). Botuar nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, në revistën “Avokatia” nr. 38, prill 2021. Autor. ISSN 2304-6392.

4) “Kompetenca lëndore për gjykimin e mosmarrëveshjeve të marrëdhënive të punës, që kanë rregullim të posaçëm” (artikull). Botuar nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë, në revistën “Avokatia” nr. 41, janar 2022. Bashkautor. ISSN 2304-6392.

5) “Manuali i së drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë – Teoria, legjislacioni, marrëveshjet ndërkombëtare dhe jurisprudenca” (libër). Shtëpia botuese “Kumi”. Mars 2022. Autor. ISBN 978-9928-340-41-2.

6) “Përlllogaritja e pensionit të parakohshëm të ushtarakëve për vjetërsi shërbimi, sipas legjislacionit të periudhës 1991 – 2010” (studim). Botuar nga Shkolla e Magjistraturës, në revistën “Jeta Juridike” nr. 2/2021. Bashkautor. ISSN 2291-4134.

7) “Gjykimi i shkurtuar si procedurë e posaçme gjyqësore penale, në kuadër të ndryshimeve legjislative të viteve 2017 dhe 2021” (artikull). Prezantuar në “Konferencën e 8-të për drejtësinë penale”, organizuar në Tiranë, nga “Shoqata e Avokatëve Penalistë”, më 04.12.2021.

Gjithashtu ne faqen EMFILES ai ka nje pjese e te cilave i perkasin periudhes se vleresimit:

Komentari i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Vëllimi i parë, Shtëpia botuese “Onufri”, 2011.

Komentari i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Vëllimi i dytë, Shtëpia botuese “Onufri”, 2011.

Manuali i së drejtës ndërkombëtare private të Republikës së Shqipërisë, “Botimet Kumi”, mars 2022.

“Kompetencat lëndore të gjykatave administrative” botuar në Revista “Jeta juridike” Shkolla e Magjistraturës, 2017.

“Legjislacioni dhe jurisprudenca shqiptare lidhur me ekstradimin, vështrim i përgjithshëm dhe zhvillimet e fundit”, botuar në Revista “Jeta juridike”, Shkolla e Magjistraturës, 2018.

“Përlllogaritja e pensionit të parakohshëm të ushtarakëve për vjetërsi shërbimi sipas legjislacionit të periudhës 1991-2010”, botuar “Jeta juridike” Tiranë, 2021.

“Njëzet e dy vjet Kushtetutë e Republikës së Shqipërisë”, botuar në revistën “Avokatia”, 2020.

“Kontratat e Humbura nga Kodi Civil i vitit 1929”, botuar në revistën “Avokatia”, 2021.

“Kompetenca lëndore për gjykimin e mosmarrëveshjeve të marrëdhënieve të punës, që kanë rregullim të posaçëm”, botuar në revistën “Avokatia”, 2022.

“Gjykata e Lartë dhe e drejta ndërkombëtare private”, botuar në Revistën “Magjistrati 12”, Shkolla e Magjistraturës, 2020.

KONKLuzioni

Sa më sipër referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultojnë që gjyqtari ka realizuar publikime ligjore akademike gjatë periudhës së vlerësimit 2020-2022 dhe për pasojë, duhet të pikëzohet maksimalisht.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në lidhje me treguesin “Publikime ligjore akademike” rezultojnë publikime të gjyqtarit, dhe pikëzohet me 5 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit

1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	98	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	396	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR